

# GJERGJ VLASHI

## roman

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

81H-31

V 79.

# BISTE ZGALEMIA




814-511C-889-98  
VTP

GJERGJ VLASHI

# BIJT E ZGALEMIT

— roman —



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Ata kishin lënë takim në fund të rrugës kryesore, që zbriste te bregu, përballë hyrjes së portit. Që andej dukej deti dhe aty piqeshin kur shkonin në Currilat.

I pari erdhë Korabi. Pas tij zbriti rrugën e kodrës gatit me vrap Çerri. Ishte skuqur në ftyrë.

— Nuk kanë ardhur të tjerët? — pyeti ai duke e shikuar si i drojtur Korabin, që rrinte mbështetur pas trungut të pemës.

— Jo, — tha tjetri shkurt dhe as që e shikoi fare.

Cerri u mat ta pyeste sa ishte ora, por nuk foli. Ai e dinte se Korabi, që ishte më i madhi i grupit, nuk e përfillte, madje edhe nuk donte që ai të rrinte me ta.

Pas disa çastesh ia behën Minai dhe Tuti. Ecnin me hapa të shpejtë, duke biseduar gjallërisht njëri me tjetrin.

Pse u vonuat? — tha Korabi i mërzitur dhe ho-  
dhi në tokë një fije bari, që kishte futur në mës të tij  
zëve.

E ka fajin Tuti, — tha Minai dhe i shkeli syrin Çerrit tē vogēl.

— Mezi e shita sallatën që më dha babai, — tha Tuti dhe ngriti pantallonat e vjetra, që i mbante pa rrip.

Korabi u nis i pari. Të tjerët shikuan njëri-tjetrin dhe i shkuan pas. Minai iu afroa Çerrit, i vuri dorën në

sup dhe të dy zunë të ecnin së bashku. Çerri trupvogël bënte përpjekje të mbante një hap me shokun e tij më të rritur.

Duke kaluar para hotelit «*Dei Doxhi*», ata panë një grup civilësh italianë, që po bënин disa fotografi te dy tytat e gjata e të zeza të topave, që ishin para hyrjes së hotelit. Një grua e ngjallur mbante në prehër një qen leshatak, që nuk i bindej dhe lëvizte pareshtur andej-këtej për t'u shkëputur prej saj.

— Po bëkan fotografi pipinot, — tha Tuti dhe, si vuri duart para gojës, lehu si qen.

Befas në grupin e italianëve u bë një zallahi. Qeni që mbante italianka në prehër, lehu i zemëruar dhe u shkëput prej saj. Të tjerët thirrën, zërat e tyre u përzien. Më shumë thërriste gruaja që mbante qenin. Fotografi, një italian i gjatë, me mustaqe të holla, ktheu kokën për të parë ku ishte qeni i dytë. Fëmijët ecën drejt, pa kthyer kokat. Porsa kaluan hotelin, ia plasën së qeshurës. Çerri i vogël zuri të përqeshte gruan me qen. Të qeshurat u shtuan. Edhe Korabi, që ishte zakonisht i ngrysur, vu ri buzën në gaz.

Ecën disa minuta pa folur. Lëviznin këmbët dhe kokat i kthenin nga deti, që atë mëngjes qershori lëshonte vezullime të praruara, që ndërronin orë e çast dhe mërmëriste në bregun e mbushur me leshtërikë; herë shikonin kodrat e bleruara të qytetit, që valë-valë largoheshin nga Porto-Romano.

Duke kaluar në këmbë të kodrës së vogël, ku ngrihen drejt qiparisët e ngrysur dhe kryqet e bardha ndernin krahët, Tuti ktheu kokën nga Çerri dhe e pyeti:

— A e sheh babanë prej këtej, o Çerr?

Djalin e habitit kjo pyetje.

— A e sheh babanë, po të pyes?

Çerri vuri buzën në gaz dhe u përgjigj:

— Jo.

— Do të jetë duke hapur ndonjë varr, — tha Tuti dhe zuri të queshte me zë të ulët.

— Lëre rehat Çerrin, — ndërhyri Minai dhe ia bëri me shenjë djalit të vogël që mos t'ia vinte re.

— Ore, vërtet, kam dashur të të pyes, — tha pas pak Tuti, që nuk mund të rrinte pa folur, — si nuk keni frikë që flini në varrezat, pranë të vdekurve.

— Pse të kemi frikë? — tha Çerri dhe ngriti supet e ngushta.

Asnjeri nuk tha gjë. Korabi ktheu kokën, u mat të fliste, pastaj lëvizi fijen e barit nga një cep i gojës në tjetrin dhe vazhdoi të ecte në heshtje.

Kur arritën në fund të rrugës së drejtë, para se të merrnin kthesën e Currilave, panë një njeri, të zhytur në ujë deri në brez, që ecte duke tërhequr diçka.

brez, që ecte duke tërhequr diçka.

— Pashani po têrhiqka tratën, — tha Minai.

Sikur ta kishin bërë me fjalë, të katër qëndruan në vend. Shikuan trupin e lidhur e shpatuk të peshkatarit të moçëm, lëvizjen e krahëve të tij të fuqishëm.

— Llullën nuk e heq nga goja, — tha Tuti.

— Unë nuk mbaj mend ta kem parë ndonjëherë pa të, — tha Çerri.

Peshkatari lëvizte ngadalë, duke tërhequr rrjetën; trupit i jepte përpara, krahët me muskuj i kishte lidhur pas supit të djathëtë dhe ata shtrëngonin fijet e rrjetës së madhe.

— Punë e bukur, megjithëse e vështirë, — tha Minai.

— Nuk është dhe aq e vështirë, — foli Korabi.

— Mos e shih tani në verë, — tha prapë Minai, — po

mendo se ç'heqin peshkatarët në dimër, kur egërsohet deti. Ore, ç'i do fjalët, ata punojnë me kokë në torbë.

— Selmos punët e tjera janë të lehta, — ndërhyri Tuti; — edhe puna e bahcevanit është e vështirë. Sa kujdes duan bimët! Duhën mbjellë, ujitur, herë duan shi, herë duan diell...

— Puna më e vështirë është ajo e hamallit në skelë, — foli Korabi me një ton, që nuk linte shteg për diskutim.

— Të shihni kur kthehet babai në darkë, për nder, mezi qëndron në këmbë. I këputet beli duke mbajtur tërë ditën thasë, arka... Apo nuk punojnë! Nga dhjetë-dymbëdhjetë orë në ditë! Jo, jo, nuk ka punë më të vështirë e më të rëndë se ajo e hamallit.

U bë heshtje. Pastaj foli Minai dhe tha se edhe puna e teneqexhiut nuk ishte e lehtë dhe ai e dinte sa lodhej i ati.

Vetëm Çerri nuk foli. Ai u mat të thoshte se puna e rojtarit të varreve ishte e rëndë si gjithë të tjerat, por **nuk e hapi gojën, duke menduar se nuk do ta besonin**; ata shpesht i kishin thënë se babai i tij kishte punë të lehtë. Por ai e dinte sa lodhej babai i tij, si grindej me priftërinjtë, që nuk ishin të kënaqur nga shërbimi.

Duke biseduar me gjallëri për profesionet e ndryshme, grupi i fëmijëve kishte arritur qendrën e Currilave.

Aty ishin dy-tri baraka të vogla, ndonjë çadër dhe asgjë tjetër. Disa njerëz shullëheshin në diell në atë orë të mëngjesit. Dy fëmijë të vegjël rrinin në breg dhe hapnin gropat në rërën e lagur. Katër ushtarë italianë ishin ulur mbi një sukë të ulët dhe diç bisetonin me zë të lartë dhe qeshnin.

Grupi i fëmijëve shikoi njerëzit që rrinin aty dhe, pa u ndalur, vazhdoi rrugën më tej,

— A do edhe shumë që të arrijmë? — pyeti Tuti.

— Jo, — u përgjigj Minai, — ajo gjendet pas atyre shkëmbinje atje.

Dhe ai tregoi me dorë disa shkëmbinj, që ishin në breg të detit, pas një gjiri të vogël dhe një boke me dhe të kuqërremtë, që zbriste në det.

— Unë me Minain e pamë atë ditë që po zbrisnim nga Dymbëdhjetë Shkallët, — tha Çerri téré gëzim. — Uhë e pashë i pari, apo jo, Mina?

— Ti e pe, — tha Minai, — por më the se është ndonjë peshk i madh.

— Ashtu m'u duk, — tha Çerri me zë të ulët. Ata kaluan gjirin e vogël e të qetë, i erdhën rrrotull bokës me dhe të kuqërremtë dhe përpara syve u doli një copë bregu me zaje të bardha dhe pak rrëre. Fëmijët hetuan bregun.

— Ja tek është, — tha Minai dhe eci përpara të tjerëve.

Ai qëndroi në mes të atij bregut të vogël, Të tjerët shpejtuan hapat. U mblohhën rrëth tij. Në breg, e kredhur përgjysmë në ujë, ishte një barkë e dëmtuar ngjyrë jeshile. Brenda ishte plot me ujë. Rinte e januar. Fundin e kishte të çarë, Edhe parmakët ishin të ngrënë në dy tri vende.

— Kjo është, — tha Minai.

— Nuk qenka aq e keqe, — tha Tuti.

— Është e dëmtuar, — foli Korabi dhe puliti sytë. Në ballin e gjërë iu formua një rrudhë e thellë, që i bëhej sa herë mendohesh.

— E kujt do të jetë kjo barkë? — pyeti Tuti. U bë heshtje. Fëmijët ia kishin ngulur sytë barkës së vjetër dhe nuk dinin ç'të thoshin. Ajo pyetje i bënte të mendoheshin, pasi ndoshta mund t'u dilte i zoti dhe atëherë...

— Mua më duket se ajo nuk ka zot... — tha Minai.

— Mirë thotë, — përkrahu Çerri, — kjo është lënë këtu dhe nuk ka zot.

— Megjithatë, sikur të pyesnim... — tha Tuti.

— Unë mendoj, — zuri të fliste Korabi. U bë një heshtje dhe të gjithë mbajtën vesh për të dëgjuar atë që ishte më i madh ndër ta. — Unë mendoj që të pyesim një herë, para se të nisim punën për ta rregulluar.

Kjo gjë sikur ua ftohu entuziazmin fëmijëve. Kjo donte të thoshte që ata nuk ishin të sigurtë për barkën. Minai u ul, mori një gur petashuk dhe e flakëriu mbi sipërfaqen e detit. U dëgjua vrumullisja e ajrit, pastaj fësh-fërima që lëshoi guri duke rrëshqitur mbi sipërfaqen e lëmuar dhe të qetë të detit. Të gjithë e ndoqën këtë gjë me sy. Çerri e nguli vështrimin te një shkëmb i rrumbullakët, që ishte ndonja njëqind metra përtej bregut, e që të gjithë e quanin «Tryeza» nga forma që kishte.

— Ta çojmë barkën atje te tryeza dhe ta rregullojmë. Aty nuk do ta vërë re njéri.

Të gjithëve u pëlqeu ky mendim, pasi atje do të ishin larg bregut dhe do të punonin të qetë, pa u rënë në sy milicëve ose ndonjë agjenti të italianëve.

— Atje, pas Tryezës, është një gur i madh më i ulët, që do na fshehë fare nga bregu.

— E dimë, — tha Korabi.

— Nuk thotë keq Çerri, — e miratoi propozimin Minai, — vetëm si do ta çojmë deri atje.

— Si do ta çojmë? — përsëriti Tuti dhe iu afrua barkës. E zuri me duar dhe u përpinq ta lëvizë.

— Nuk lëviz, jo, — tha Korabi dhe prapë u krodh në mendime.

— Vetëm njëri, dihet, nuk e lëviz, — tha Minai. — Po ne jemi katër.

Pa folur, tē gjithë iu afroan barkës dhe e kapën nē anë tē ndryshme.

— Ooooo... — thirri Minai dhe tē katër u përpqën ta lëviznin nga vendi. Mundimi u shkoi kot. Minai thirri edhe një herë, ata prapë bashkuan forcat, barka u lë-kund djathtas e majtas, por nuk lëvizi përsëri nga vendi.

— Unë them se mund ta lëvizim, — tha Tuti, — por më parë duhet hequr rëra që ka brenda.

— Kjo është e drejtë, — tha Minai. — Sikur tē kishim ndonjë kovë,

— Edhe me duar mund ta heqim, — tha Korabi dhe me këmbët e tij tē gjata hyri brenda nē barkë.

— Mos tē nxitohemi, — tha Minai, — tē punojmë me mend. Korabi dhe Tuti tē nxjerrin rërën. Unë me Çerrin po shkojmë se mos gjejmë ndonjë copë teneqe ose diçka tjeter që tē bëjë punën e lopatës.

— Këput edhe disa fije gjimeshtrë që t'i lidhim e t'i bëjmë si litar për ta térhequr, — tha Tuti.

— Mirë, — tha Minai dhe u largua me Çerrin.

Të katër fëmijët ishin vënë nē lëvizje.

Brenda varkës Korabi me Tutin punonin papushuar. Ata kishin ngritur pantallonat sipër gjunjëve dhe ashtu nxirrin rërën nga barka, duke e hedhur nē breg.

— Nuk paska edhe aq rërë, — tha Korabi.

— Kjo tregon se nuk ka shumë kohë që është lënë këtu, — shtoi Tuti.

— E kujt do tē jetë kjo? — tha prapë Korabi dhe e ndërpren punën.

— Ku ta dish... Po mos u bëj merak, o Korab. Atë e kanë hedhur dhe ne kemi tē drejtë ta marrim. Mua më vjen keq se mos jetë e ndonjë peshkatari tē varfër. Se, po që e ndonjë italiani ose e ndonjë tē pasuri, do ta marrim që ç'ke me tē.

— Nuk bëjmë mirë të vjedhim gjënë e tjetrit, — tha Korabi i menduar.

— Po të jetë e italianëve ose e tregtarëve, nuk më vjen fare keq, se edhe ata të vjedhur e kanë. Kupton, apo jo? Mos e vrit mendjen, po hajt të punojmë!

Çerri u kthye shpejt: mbante ndër duar një teneqe katrore, të shpuar në mes dhe një shuk me litar kashte.

— Nuk u ktheve duarbosh, — i tha Minai që kishte shkulur disa fije gjineshtrë.

— Kërkova për ndonjë kovë, por nuk kishte... — tha Çerri.

— Nuk është kollaj ta gjesh, — u përgjigj Minai. U afroan te barka. Dy djemtë punonin pareshtur dhe rrith barkës ishte bërë një shuk i madh rëre.

— A ju bën punë kjo teneqeja? — pyeti Çerri dhe ua zgjati atë që mbante ndër duar.

Korabi e shikoi, tundi kokën dhe tha:  
— Qenka e shpuar, Më mirë punoj me duar.  
— Megjithatë, diçka mund të bëhet me të, — foli Tuti dhe ia mori teneqenë Çerrit.

Ata vazhduan të nxirrin rërën. Minai u fut në ujë bashkë me Çerrin dhe nisen të lëshnin litarin prej kashte dhe të bashkonin fijet e gjineshtrës.

— A ka edhe shumë rërë? — pyeti Minai.  
— Kemi punë edhe gjysmë ore, — tha Korabi.  
— Jo, jo, — ndërhyri Tuti, — për dhjetë minuta i jepim fund.

Çerri vuri buëen në gaz dhe ngriti kokën. Shikimi tij u ndesh me atë të Korabit. I vogli uli kokën dhe vazhdoi të lidhte litarin prej kashte te bashi i barkës së vjetër.

Pas pak, andej nga ndodheshin barakat e plazhit të vogël, u dukën disa njerëz. Fëmijët nuk i vunë re. Ishin

tre burra, njëri prej të cilëve kishte në kokë një kapele kashte. Ata si panë fëmijët. — Çfarë po bëni, o çuna? — pyeti ai që mbante kapelen prej kashte. Fëmijët shtangën në vend. Minai ktheu kokën nga ata, i hetoi një çast pa folur, pastaj u tha i qetë:

— Asgjë, po luajmë... —

Ata seç folën në mes tyre, njëri qeshi, pastaj u larguan duke biseduar.

Djemtë lëvizën duart më shpejt, pasi kalimi i të rriturve u solli ndër mend që mund t'i shikonin, të bëheshin kureshtarë për punën e tyre dhe t'i pengonin, ose ajo që ishte më e keqe, edhe t'u merrnin barkën fare. Ata u druheshin sidomos italianëve, që fishin me shumicë dhe i fushin hundët kudo.

— Rëra mbaroi; — thirri Tuti.

— Ka edhe pak këtu, e ftohu entuziazmin e tij Korabi.

— E mor ti, mbaroi... — tha prapë Tuti dhe kërceu jashtë barkës. — Po ju, si dukeni me litarët?

— Me pak vështirësi arritëm t'i lidhim te trupi i barkës, — tha Minai.

— Kam frikë se litari i kashtës nuk do të mbajë, — tha Cerri dhe tundi kokën me flokët kaçurrela.

Të katër qëndronin rrëth barkës dhe e shikonin atë. Rërën e kishin nxjerrë, litarët ishin lidhur, tanë vinte më e vështira: ta tërhoqnin nëpër ujë dhe ta conin pas «Tryezës».

— A fillojmë? — tha Tuti.

— Prit një herë, — foli Minai; — duhet bërë plani mirë, nuk është aq e lehtë sa duket...

Të tjerët nuk folën. Minai, megjithëse më i vogël se Korabi, ishte, si të thuash, komandanti i tyre. Atij ia

dëgjonin fjälën më shumë. Nuk e kishte caktuar njeri të parë, as ai vetë nuk e mbante veten për të tillë; megjithatë, të tjerët i bindeshin. Edhe Korabi që, si më i madh, do të kishte dashur të ishte i parë, në heshtje pranonte që Minai ishte i dashur me shökët, i matur dhe i vendosur.

— Si mendon, Mina? — e pyeti Çerri.

Minai, pa folur, u fut në ujë, pasi hoqi këmishën dhe pantallonat e i la në breg. Me hapa të ngadaltë shkoi para barkës, zuri litarin me duar, pastaj u kthyte nga ata dhe tha:

— Ti, Tuti, eja këtu me mua. Ne do të tërheqim litarët. Korabi me Çerrin ta shtyjnë barkën nga prapa. Ka shumë rëndësi që, kur ta lëvizim nga vendi dhe të nisim të ecim, mos të qëndrojmë fare, se barka do të na shkojë në fund, do të prekë tokën dhe eja nxirre pastaj. Gjithë puna është të bashkojmë forcat dhe mos të qëndrojmë.

Çerri ktheu kokën anash dhe tha me zë të lartë, gati sikur po pëshpëriste:

— Po vijnë prapë ata burrat.

Të katër u larguan nga barka dhe zunë vende të ndryshme, duke u përpjekur të qëndronin të shkujdesur. Bile Tuti nisi të fishkëllente.

Burrat kaluan pranë tyre dhe as që kthyen kokat fare, se diç bisedonin me gjallëri.

— Gati! — tha Minai, pasi i pa që ata humbën pas një kthese.

Të katër u kthyen në vendet e mëparshme. Minai dha komandën dhe të gjithë, me nerva të tendosura, zunë të shtynin barkën: në fillim ajo nuk lëvizi, Minai thirri edhe një herë, ata shtuan forcat dhe barka u shkul nga toka.

— Vazhdoni, — thirri Minai duke marrë frymë me vështirësi.

Në fillim çdo gjë u shkoi mbarë dhe gjysmën e rrugës e kaluan mirë. Barka rrëshqiste mbi ujë, pa iu nxjerrë asnjë telash, por pastaj uji nisi të mbulonte trupat e tyre. Çerrit i arriti deri afér fytit, Minai me Tutin tērhiqnin me mundim, ndërsa Korabi nuk shqetësohej shumë, pasi ai ishte më i gjatë sejtë tjerët dhe uji vetëm sa i kishte kaluar barkun.

Ata shikonin parështur shkëmbin që ishte afér brengut: tanë ai nuk ishte më larg se tridhjetë metra, por atyre u dukej sikur ishte shumë larg.

Minai vuri re se barka zuri të lëvizte më ngadalë; kjo e shqetësoi, se e dinte që nuk ishte shenjë e mirë. Po t'u fundosej, do të ishte e pamundur ta nxirrin më në sipërfaqe.

— Forca, se edhe për pak arritëm, — u dha zemër ai duke shtyrë barkën.

Bënë edhe disa metra, por prapë shkëmbi dukej larg.

Çerri e ndjeu se uji iu afrua te goja. Kokën e mbante lart dhe ndiente se krahët i dhembnin nga tendosja.

Më shumë nga të gjithë shtynte Korabi. Me trupin e tij të fuqishëm ai bënte punë sa për dy.

— Si je, Çerr? — thirri Minai.

— Mirë, — tha djali i vogël, por atë çast një shkulm uji iu fut në gojë. Ai e piu pa bërë zë, vetëm rrudhi ftyrën.

— Të bëftë mirë, — i tha Tuti, që kishte kthyer kokën prapa dhe e pa Çerrin.

Të tjerët e kuptuan dhe zunë të qeshnin. Kjo gjë u bëri mirë dhe vazduan ta shtynin barkën, megjiithëse thellësia ishte shtuar.

Para se të arrinin te shkëmbi, Tutit iu këput litari.

— Mos! — thirri Minai.

Korabi e kuptoi dhe i tha Tutit:

→ Mbaje me shpinë, derisa të vij unë dhe ndërrojmë vendet.

Qenë çaste të vështira. Të gjithë u trembën se mos barka do t'u ikte nga duart e do të fundosej aty pranë «Tryezës».

Por ajo nuk u fundos. Të gjithë vunë tërë forcat e tyre që ajo të mbetej në sipërfaqe. Edhe Çerri ndihmonte më sa mundte; ai zhytej në ujë duke mbajtur fryshtë, dhe shtynte barkën. Shpina e Tutit doli më e fortë nga ç'e pандеhте Korabi. Ajo e mbajti barkën. Afër shkëmbit ishte një cektinë. I pari shkeli aty Minai, pas tij Tuti. Ata shpejtuan veprimet e tyre dhe, të ndihmuari nga Korabi me Çerrin, barka u ndodh pranë shkëmbit.

— Unë po hip i lart që ta tërheq! — tha Minai dhe, pa e zgjatur, u ngjit mbi shkëmbin e rrumbullakët.

— Po barkën do ta çojmë atje prapa, — tha Korabi — E di, — u përgjigj Minai; — e hipim këtu, pastaj e tërheqim më kollaj dhe e çojmë atje prapa.


Ngjitja e barkës mbi shkëmb nuk që punë e lehtë. U deshën disa minuta derisa bashi e pastaj trupi i dëmtuar u ngjitën mbi sipërfaqen e shkëmbit.

Korabi e shtyu me të gjitha forcat. Edhe të tjerët nuk u kursyen. Të gjithë merrnin fryshtë me vështirësi. Më shumë nga të gjithë dukej i lodhur Çerri: fytyra i ishte skuqur dhe ai merrte fryshtë me gojë të hapur. Kraharori i vogël i ngrihej dhe i ulej pareshtur.

— Tani mund të çlodhemi pak, — tha Tuti duke fërkuar supet dhe zverkun, ku barka kishte lënë një vazhdë të kuqe.

— Më mirë ta çojmë atje prapa Tryezës, ku nuk duket, — tha Korabi.

— Nuk prish punë, — tha Minai, që me bisht të syrit shikoi Çerrin.



U ulën tē gjithë mbi sipërfaqen e shkëmbit, që ishtë e ngrohtë. Vetëm Korabi u përkul përmbyss, futi duart në ujë dhe lagu fytyrën.

— Këtë punë e kryem me faqe tē bardhë, — tha Minnai; — tani ta çojmë pas Tryezës dhe tē mendojmë si tē nisim për ta rregulluar.

— Kryesorja është tē gjejmë materialet që duhen për ta bërë prapë tē re, — tha Tuti.

— Mirë thotë, — foli Korabi dhe u ngrit shesh mbi shkëmbin bojëhiri.

— Do të na duhen dërrasa, zift, bojë... — tha Minai i menduar, me krahët e lidhur rrëth gjunjëve.

— Zift ka te rruga e Vilës, — tha Çerri. — Atë po e shtrojnë dhe ka plot të derdhur përtokë.

— Me dërrasat do të jetë më e vështirë, — foli Minai.

— Edhe ato do t'i gjejmë, — tha Tuti me besim.

— Dëgjo, Tut, do t'i gjejmë, por nuk do t'i marrim në ndonjë vend pa leje. Do të marrim vetëm dërrasa të hedhura. Kuptove?

Tutit i dogjën këto fjalë, se e ndjeu që Minai ia tha pikërisht atij. Edhe disa herë të tjera kishte bërë fjalë me Minain pér këtë gjë.

Korabi tha:

— Në port ka copa dërrasa që i hedhin kot. Më ka thënë babai.

— Ato po, — tha Minai. — Shko atje, Korab, dhe shiko të marrësh ndonjë.

— Edhe unë do të marr zift, — foli Çerri.

— Mirë, tha prapë Minai. — Përveç kësaj, Çerr, shiko mos gjesh edhe disa gozhda.

Ata vazhduan të flisnin, duke bërë planin pér gjetjen e materialeve dhe si do të fillonin punën pér ta ndrequr barkën.

— Nesër në mëngjes do të nisim nga puna, — tha Minai dhe u ngrit më këmbë, — Do të takohemi këtu që në orën tetë. Ç'të gjeni, e sillni me vete. Edhe një gjë tjetër: nuk do t'i thoni njeriu pér këtë punë. Le të mbetet në mes tonë. Nuk është mirë ta marrin vesh se çfarë kemi nisur të bëjmë.

— Mirë thotë Minai, — tha me zjarr Tuti, — Ky ësh-

të sekret, që nuk duhet ta marrë veshasnjeri. Të beto-hemi se nuk do të flasim.

— Nuk është nevoja, — tha Minai.

— Ne jemi burra dhe, po e thamë fjalën, e mbajmë pa nevojën e betimit, — tha Korabi.

— Unë jam në një mendje me ato që i thotë Korabi,

— foli Çerri.

Tani ata ishin çlodhur dhe nisën të flisnin me gjallëri, duke ia marrë fjalën nga goja shoku-shokut. Vazhduan të flisnin për barkën, për ndreqjen e saj dhësi të zinin peshk me të pér të indihmuar familjet e tyre, që ishin të këputura dhe me vështirësi siguronin kafshatën e gojës.

— Po pér veglat e peshkimit, si do t'ia bëjmë? — tha Tuti.

Kjo pyetje i zuri në befasi të gjithë: pér to nuk kishin menduar. Vërtet, mirë se barkën do ta rregullonin, po si do të zinin peshk? Me duar?

— Në fillim mund të nisim me grepa, — tha Minai.

— Edhe me parangalla, — shtoi Çerri.

— Po, dhe me parangalla, — miratoi Minai; — pastaj do të përpinqemi të gjejmë ndonjë tratë të vogël, pastaj...

— Mund t'ia marrim hua Pashanit, — propozoi Tuti.


— Atij i duhen pér vete, — tha Korabi. — Unë kam një xhaxha që ka qenë peshkatar; tani ai është ulok në shtëpi dhe do t'i them të më japë një tratë.

Gjithnjë duke biseduar me zjarr, ata u ngritën në këmbë.

Në fund Minai tha:

— Tani, o burra ta shtyjmë barkën dhe ta çojmë pas Tryezës, se atje është më ulët dhe nuk do ta shikojë njeri.

Të gjithë i vunë duart barkës dhe ajo rrëshqiti me



vështirësi nëpërsipërfaqen e shkëmbit, që ishte plotigurë dhe të cara.

— Me kujdes se mos e dëmtojmë edhe më, — porositi Minai.

Kur e çuan në vend, Çerri u ngrit i pari dhe tha:

— Si do t'ia vëmë emrin barkës sonë?

Për këtë ata nuk kishin menduar fare. Tuti tha pas pak:

— Unë them ta quajmë.

— Më mirë e lëmë për nesër, — e ndërpreni Minai;

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

— lë të mendojë secili dhe të thotë nesër,

Minai shtyu derën me kujdes. Ishte errur që kur dhe  
ai e dinte se babait nuk i pëlqente që ai të vonohej.

Hyri brenda dhe hodhi sytë përreth. Në dhomën e zjarrit ishte vetëm e ëma, Urania.

— Ku je, mor djalë? — e pyeti ajo me zërin e saj të dobët, ku, megjithatë, ndihej një qërtim i heshtur.

— Ndenja pak me shokët, Ishim në cirkun që kanë sjellë italianët. ... Ku është babai?

— Ka shkuar te xha Kosti, atij. . . Sa për cirkun, ke bërë gabim. Nuk duhet të shkoje. Ke uri, Mina?

— Kam, — tha djali i qetësuar, që mungonte i ati. Iu afroa nënës dhe e shikoi buzagaz. Edhe ajo ngriti kokin dhe e vështroi. Minai vuri re një tufë flokësh të bardhë, që i kishin dalë jashtë shamisë së kokës. Afroi dorën dhe ia preku.

— Ulu tē hash, mor bir, — i tha e ēma, duke marrē një pjatë, ku vuri pak gjizë, dy qepë tē njoma dhe një copë bukë.

Minai u ul'dhe zuri të hajë me oreks të madh. Iu duk shumë e shijshme gjithçka që kishte përnara

— Jo, mor dialë — ia ktheu ajo dhe ai yuri re nje

Sotiri, vellai i tii i madh, punonte në oficinën e një

italiani, që kishte hapur në Shkozet. Më parë ai punonte në shoqërijet italiane të transportit «Truki», po aty ishte zënë me grushta me një kryepunëtor dhe e kishin dëbuar; pasi ndenji disa kohë hamall në mullirin e madh, që ishte në hyrje të qytetit, tani e kishin marrë në oficinë, se ishte teknik i zoti dhe ia kishin nevojën. Ai dilte nga shtëpia në mëngjes që pa gdhirë dhe kthehej natën vonë. Minai kishte kohë që e kishte kuptuar se i vëllai merrej me ca «punë», që nuk donte t'ia merrte vesh njeri. Kishte plot prova për këtë. E kishte parë sa herë që mblidhej në dhomën e vogël, ku flinin bashkë, me dy shokë të tjera dhe diç bisedonin me zë të ulët. Disa herë Minai e kishte parë që mbante të fshehura disa letra. Madje një natë vuri re që hoqi nga brezi një revolver dhe e vuri poshtë dyshekut. Nja dy herë e kishte pyetur për këtë gjë, por Sotiri i kishte thënë: «Nuk të duhet gjë ty, je akoma i vogël». Minai ishte prekur, por ai i kishte shpupurishur flokët dhe i kishte shkelur syrin; pastaj kishte dalë nga dhoma duke fishkëlluar. Shpesh rrinte ditë pa e parë të vëllanë, sepse ky kthehej kur Minain e kishte zënë gjumi, dhe dilte nga shtëpia pa zbardhur mirë dita.

«Sonte do ta pres dhe do ta pyes përsëri», — vendosi me vete djali duke u përtypur.

Në oborrin e vogël u dëgjuat zëri i babait. Minai hengri kafshatën e fundit dhe e largoi pjatën.

— Paske ardhur ti? — i tha i ati duke hyrë. U kollit disa herë dhe, pa folur, u ul në një cep të dhomës së zjarrit. Vuri duart mbi gjunjë dhe vështrimin e mbante drejt përpara, pa i lëvizur sytë.

«Diçka ka sonte», — mendoi Minai dhe nuk dinte ç'të bënte. U mat të dilte nga dhoma, po ku të shkonte, ç'të bënte? Me babanë nuk mund të bisedonte. Minai kishte kuptuar se, kur të rriturit kanë halle, nuk duhen trazuar.

Në dhomë hyri nëna.

— Ishte mérzitur Kosti? — e pyeti ajo të shoqin.

— Helm ishte bërë, helm... — tha ai dhe prapë u kollit.

— Kur ia kishin arrestuar djalin, mbrëmë? — pyeti prapë nëna dhe i shkoi pranë.

— Po, mbrëmë natën, nga mesnata. Kishin hyrë në shtëpi gjithë ata milicë. Ia kishin bërë shtëpinë çorap duke kërkuar. Pastaj kishin marrë Jorgjin dhe më sy të tyre i kishin vënë hekurat.

— Epo mirë, mor burrë, a i kishin gjetur gjë?

— Nuk e pyeta Kostin... Po nga muhabeti mora vesh se diçka i kishin gjetur...

Në dhomë ra heshtje. Minai dëgjonte me vëmendje. Ndjeu një shtrëngim në zemër. Ai e njinte Jorgjin, se ishte shok i Sotirit. Banonte edhe ai në lagjen Stan si ata, dhe, sa herë që e takonte rrugës, e përshëndeste, i fliste; madje, para një javë, ai e futi në një dyqan dhe e gostiti me një akullore, se kishte marrë rrogën.

— Te burgu, këtu pranë nesh ta kenë futur? — pyeti nëna pas një heshtjeje të shkurtër.

— Ku ta dish ku i dërgojnë ata djaj italianë, — tha Vasili dhe tundi dorën që mbante mbi gjurin e djathtë.

— Në fillim i mbajnë nëpër qeli, pas gjyqit i sjellin këtu ose i degdisin përtëj detit, në ata ishujt e tyre të mallëkuar.

Minai mbante vesh. Rrallë e kishte dëgjuar të atin të fliste pa drojtje para tij. Zakonisht ai ishte më i matur, se, siç thoshte vetë, janë kohë të vështira dhe për llafe goje humb pa nam e pa nishan. Tani Minai dëgjonte zërin e tij të thellë, të shoqëruar me një fishkëllimë, që ia shkaktonte astma bronkiale, të cilën e kishte prej zanatit të tij. Minai shikonte fytyrën e t'et, të thatë si një eshkë, mustaqet e tij të shkurtra e të rralla, sytë e rrumbullakët e të gjata.

llë, që të vështronin thellë, dhe ato dy hulli rrudhash, që i zbrisnin nga poshtë syve dhe i çanin dy mollëzat deri te cepat e gojës me buzë të holla.

Minai dëgjoi prapë t'ëmën që tha me zë të ulët: «E shkreta, Aspasi!» dhe iu kujtua ftyra e qeshur e Jorgjit, flokët e tij të zinj e të shpupurishur, që i binin mbi ballin e gjerë!

— Sotiri nuk ka ardhur? — pyeti Vasili duke dredhur me gishtërinjtë e tij të trashë një cigare.

— Jo, — iu përgjigj e shoqja dhe shtoi. — Pse po vonohet sonte djali?

— Kushedi, ka pasur punë. Mos u bëj merak. Kështu vonohet ai, — tha Vasili dhe ndezi cigaren. Në mes të një reje të kaltër tymi u dëgjua kolla e tij, që ushtoi në dhomën e zjarrit.

— Lëre atë duhan, se të mori shpirtin kolla, — tha gruaja duke e shikuar me qërtim.

Babai nuk foli, por u ngrit nga vendi. Bëri disa hapa nëpër dhomë, pastaj shkoi nga dera. Aty qëndroi, u kthyç dhe, duke e shikuar Minain në sy, i tha:

— Edhe ti mos hajde më vonë, dëgjove? Nuk e shikon ç'po ndodh? Ku ishe sonte?

Minai u përtyp, megjithëse e kuptoi se i ati nuk i foli si zakonisht kur vonohej.

— Hiç... isha me disa shokë,,, pastaj shkuam te cirku sa për të parë... .

— Atje mos të të shoh më, dëgjon? Ai është vend i mallëkuar, që e kanë sjellë italianët për t'i prishur mendjen rinisë, dëgjon, apo jo? Helm shpérndan ai vend. Kanë sjellë edhe disa vajza të përdala dhe bëjnë muzikë, lojëra e turli marifetesh për t'uua marrë mendjen njerëzve. Po ftyra e vërtetë e Italisë për ne nuk është cirku me drita e muzikë, por janë milicët e karabinierët, që shty-

pin popullin dhe futin nëpër burgje Jorgjin me shokë.

Ai qëndroi dhe mori frymë me vështirësi, pasi një gulçimë astme e mundoi disa çaste. Prapë u mat të dilte, pastaj u kthye, bëri disa hapa nëpër dhomën e vogël, shkoi pranë Minait dhe u ul në minderin e ulët.

Thithi disa herë cigaren dhe i menduar tha:

— Dëgjo, mor djalë, në atë birucën time prej teneqexhiu unë nuk kam punë dhe më shumë bëj gjëra pa ndonjë përfitim, sepse nuk më rrinë duart rehat. Edhe Sotiri pak merr. Nuk e di, por mendoj që këta muajt e verës do të bëje mirë të hyje në ndonjë punë. Si thua?

Minait i erdhën të papritura këto fjalë. E dinte se shumë shokë të tij, sidomos të Stanit, punonin për të ndihmuar sadopak familjet e tyre të këputura, po për vete nuk i kishte shkuar mendja se mund të futej në ndonjë punë.

— Si të duash, baba... — tha me zë të ulët.

— Po djalin e kemi të vogël, mor Vasil, — tha nënë Urania, që ktheu kokën dhe vështroi Minain.

— Ka edhe më të vegjël se ky që punojnë, — u përgjigj Vasili dhe e shikoi të shoqen me qërtim. Pastaj ne na shtyn nevoja që ta futim në punë. Nga shkolla nuk dua ta heq. Le ta mbarojë filloren që të mos jetë i verbër si unë e ti, po të paktën këta muajt e verës duhet të ndihmojë pak familjen. Unë, mor djalë, — iu kthye Minait dhe zëri i tij u bë i butë e përkëdhelës, — e kam nisur punën që shtatë vjeç. Im atë më futi çirak te një teneqexhi, që ishte në pazar. Aty nisa të mësoj zanat. Ustai im — Mançe e quanin — ishte si div, i zoti në zanat, por i egër sa nuk kishte shokun. Kërkonte punë. Dhjetë orë e më shumë nuk më linte të ngrija kokën. Puna nuk është shaka, thoshte, puna duhet nderuar dhe, sa futesh në dyqan, mos mendo për asgjë tjetër, veç punës. Eh, sa shuplaka

kam ngrënë nga ustai im. Kështu, mor djalë. Nejse, do të kemi rast dhe do të të tregoj më gjatë për ustain tim.

Vasili u zhyt në kujtimet e tij dhe fytyra i shkëlqente.

— E ku ke ndër mend ta futësh djalin? — e pyeti nënë Urania,

— Të them të drejtën, do të kisha qejf që ai të mëson-  
te ndonjë zanat, si për shembull zanatin e teneqexhiut,  
se zanati nuk të lë pa bukë, por unë nuk kam punë për  
vete. Tani për tanin unë them që Minai të punojë disa kohë  
në fabrikën e cigareve «Stamles». Fola mbrëmë me një  
mikun tim, ai ndërmjetësoi te kryepunëtori dhe Minai  
mund të nisë punën që nesër. Atje do të mbajë arka me  
duhan.

— Do të mbajë arka? — tha nëna. — Nuk kishte ndo-  
një punë tjetër, mor Vasil?

— E ku ka, moj Urani? Punët e mira i kanë zënë  
njerëzit e pasanikëve. Si i thonë asaj fjalë, ku të lë laroja  
të hajë baloja. Kështu, mor djalë, — dhe iu drejtua të bi-  
rit, — nesër në mëngjes do të shkosh në fabrikën «Stam-  
les» dhe do të kërkosh atje Fadil Gjormin. E mban mend?

— Po.  
— Thuaji se je djali im dhe ai do të të mësojë ç'do  
të bësh.

Si tha këto fjalë, Vasili u ngrit, shoi cigaren dhe iu  
drejtua Uranisë, që rrinte gjithnjë në mes të dhomës me  
duart e mbledhura nën përpërësen e zezë.

— Hajt, moj grua, na shtro të hamë bukë.  
Minai u ngrit dhe u nis nga dera.

— Ku shkon? — dëgjoi pas vetes zërin e t'et.  
— Po dal në oborr, — tha Minai.


Në oborr ishte freskët dhe djali ndjeu puhizën e na-  
tës që i përkëdheli fytyrën. Dritat e qytetit ishin të nde-

zura dhe nga kodra ku ndodhej lagjja Stan, ato dukeshin bukur. Madje që atje shihej edhe rruga automobilistike, me dritat e lëvizshme të makinave, që vinin ose largohe-shin nga qyteti. Në një anë të qytetit, nga e djathta, ai dalloi dritat e forta të cirkut dhe në veshët e tij jehuan tingujt e një muzike me ritme të shpejta.

Minai zuri vend në një trung peme, që ishte aty prej vitesh, dhe ktheu kokën nga kodra. Shtëpizat e vogla të lagjes së tij kishin aty-këtu drita. Ai i njihte thuaqse të gjithë banorët e lagjes. Zuri shtëpitë me radhë. Pas dritares së vogël katrore të shtëpisë përdhese të Kristos pa një hije që lëvizte pareshtur. Muratori i vjetër, që s'e kishte krahun e djathtë, me siguri bënte ecejaket e tij të pandërprerá, duke shfryrë me vete kundër jetës që bënte dhe kundër të birit, që ishte martuar në Tiranë dhe e kish-te lënë fillikat. Usta Kristoja jetonte me lëmoshat që i jepnin banorët e Stanit. Pak më tutje, pas tij, ishte një kolibe gati në të rënë. Aty rrinin dy pleq pa fëmijë. Të dy, burrë e grua, punonin në fabrikën e cigareve, megjithëse ishin shumë të moshuar dhe mezi lëviznin këmbët. Gjithnjë i shikoje bashkë tek shkonin dhe vinin nga puna; ata ecnin ngadalë, të heshtur e të menduar.

Në të djathtë të shtëpisë së tyre banonte familja e një shoferi, që kishte katër vajza. Pranë shtëpisë së tyre përdhese banonte nënë Athinaja, një vejushë trupmadhe, që rriste pesë jetimë me punën e krahëve të saj, që tërë ditën ndanin fletët e duhanit në fabrikë. Atë e shikoje pareshtur me cigaren në cep të buzëve.

Minai e hodhi vështrimin e tij në pika të ndryshme të kodrës së Stanit, të mbushur me ato shtëpiza e kolibe, ku banonin punëtorë e zanatçinj të ndryshëm, të gjithë njerëz të varfér, por të ndershëm dhe trima. Djemtë e Stanit ose stanorët, si i thërrisin zakonisht në qytet, ishin



të njojur si njerëz kokëshkretë, por të drejtë dhe të nder-shëm, që nuk ta bënин të gjatë kur ishte puna për t'u zënë me grushta, për të mbrojtur ndonjë shokun e tyre ose për të dënuar ndonjë keqbëres ose maskara, që e kishte mbushur kupën. Në të gjitha lagjet e tjera të qytetit, stenorët gjëzonin respekt të madh dhe nuk guxonte kush t'u dilte përballë.

Ato shtëpi të vogla, të vjetra, të ndërtuara me copa teneqesh e dërrasa arkash ose me qerpiç, rriniñ të ngje-shura pranë njëra-tjetrës në faqen e kodrës; shpesh muri i njëres ishte edhe muri i tjetrës. Të dukëj sikur ashtu ato mbanin shoqja-shoqen.

Me sy Minai u përpoq të shquante shtëpizën e Kostit, por kjo ishte pas dy-tri pemëve të mëdha dhe nuk dallohej mirë. Ai zuri të merrte me mend ç'bënte plaku me të shoqen në atë çast. Me siguri ata nuk flinin, madje as do të kishin vënë gjë në gojë; po rrinin e mendonin për djalin e tyre të burgosur. Po si ata ishin edhe familje të tjera në Stan, pasi shumë djem e vajza të asaj lagjeje ishin burgosur e internuar nga italianët, se luf-tonin kundër tyre.

Duke qëndruar në një vend, Minait iu përqeth trupi nga fresku i natës. Lëvizi nga vendi dhe u shpi. Bëri disa hapa dhe shkoi afër gërdhit të ulët, të bërë me copa teneqesh. Aty zgjati kokën dhe hëdhi sytë nga e djathta. Shikoi ndërtesën e zezë të burgut të qytetit, që ishte pranë lagjes Stan, edhe ajo në një kodër të vogël. E vështroi gjatë, duke mënduar për njerëzit që ishin të imbyllur aty brenda. Burgu ishte një ndërtesë e ulët, njëkatëshe, në formë gati katrore, me një oborr të vogël përpëra. Aty kishte drita më shumë se në çdo vend tjeter të lagjes. Edhe drif-taret me hekura ishin të ndriçuara dhe në tokën përreth binin drita të copëzuara. Ndodhë shpesh që darkave të

burgosurit të këndonin këngë patriotike dhe të Luftës Nacionalçlirimtare. Banorët e Stanit dilnin nga shtëpitë dhe dëgjonin këngët e tyre. Ndonjëri përpiquej që në atë kor të shquante zërin e djalit të vet të mbyllur aty benda. Kjo nuk zgjaste shumë, se rojet ndërhyrjen dhe jepnien urdhër që ata ta pushonin këngën. Por ata nuk u bindeshin dhe nganjëherë ndodhnin përlleshje. Banorët e Stanit dëgjonin me zemër të ngrirë se ç'ndodhët në burgun që ishte pranë lagjes së tyre.

U hap dera e shtëpisë.

— Çfarë bën aty, mor djalë? — e pyeti nëna.

— Asgjë, po rri.

— Eja brenda. Këtu bën freskët.

— Jo, mjoq mënë, çfarë freskët. Jemi në verë.

— E di, por ne jemi në kodër dhe këtu fryn mjaft.

Në rrugë u dëgjuan hapa. Pas pak një zë i trashë burri thirri:

— Si u ngryse, Üra?

Gruaja kapsalliti sytë. E njohu zërin dhe iu përgjigj:

— Mirë, usta Sinan, ti si u ngryse?

Ai ishte një gjellbërës që punonte në gjelltoren afër portit. Shtëpinë e kishte në majë të kodrës.

— Eja brenda, — i tha pas pak nëna Minait; — nesër do të zgjohesh shpejt...

— Nuk kam gjumë, — tha Minai.

— Eja, eja, nuk ke ç'bën këtu. — Heshti një çast, pastaj tha me zë të ulët. — Sa po vonohet ky Sotiri sonte!

Ai edhe herë të tjera ishte vonuar, por atë natë nëna ishte e shqetësuar për shkak të arrestimit të Jorgjit. Minai ndenji një çast më mëdyshje. Si t'ia bënte? «Më mirë po hyj dhe po e pres Sotirin në dhomë», — mendoi ai dhe, pa folur, hyri në shtëpi.

Në dhomën e zjarrit ishte shuar drita. I ati ishte shtri-

rë, po me siguri nuk flinte. Duke kaluar në majë të gish-térinjve nëpër dhomën e errët, Minai dëgjoi frymëmarr-jen e rëndë të t'et.

Pasi i uroi nënës natën e mirë, hapi ngadalë derën e kthinës së vogël ku flinte me të vëllanë. «Ajo nuk do të mbyllë sy pa u kthyer Sotiri, — tha me vete Minai. — Kështu bën gjithnjë kur vonohet ai.»

U shtri në shtratin e fortë pa u zhveshur. Nga jashtë hynte një dritë e dobët. Pas pak iu mësuani sytë dhe nisi të dallonte konturet e sendeve që ishin aty brenda.

Vuri duart pas zverkut dhe me sytë në tavanin e ulët filloj të mendohej. Jashtë ishte qetësi. Dëgjohej vetëm kënga e drojtur dhe monotone e bulktheve.

Minai sillte ndër mend barkën që kishin çuar atë ditë te «Tryze». E kishin menduar mirë atë punë. Do ta rregullonin atë dhe pastaj do të dilnin në det, do të zinin peshk, do të fitonin ndonjë lëk për të ndihmuar fa-miljet e tyre. Veç kësaj, edhe do të kënaqeshin me të duke vozitur nëpër det. Mund të shkonin nga currilat deri te plazhi. Pse jo? Edhe atje mund të shkonin.

Atë çast iu kujtua se nesër do të niste punën. Kjo gjë e mërziti, sepse kishte lënë fjalë me shokët që në mën-gjes të takoheshin për të vazhduar punën. Ata duhe-shin njoftuar që mos ta prisnin. Do t'u thoshte që ta pris-nin pasdite. Po, po, do të mbaronte punën në fabrikë dhe do të shkonte menjëherë te barka për të punuar me shokët.

«E lamë që nesër të mendojmë për emrin e barkës sonë. Si t'ia vëmë? Të mendohem pak...»

Por atë çast gjumi ia mbylli qepallat e rënduara.

## K R E U I T R E T É

Si nëpër gjumë, Çerri dëgjonte zhurmë hapash dhe një trokitje të largët. Iu duk se dikush po i binte derës së dhomës ku flinte. Ai hapi sytë dhe qëndroi pa lëvizur.

Hodhi sytë nga dera. Atë çast kuptoi se ishin të goditurat e sëpaqës së babait që çante dru në oborr.

Në dhomë nuk kishte njeri. Motra e vogël po flinte me grushtat e mbledhur. Flokët kaçurrela i binin në faqe.

Çerri u ngrit shesh në dyshekun e fortë, që ishte shtruar përdhe. «Mos të jetë vonë», — mendoi ai dhe mendja i vajti te barka e tyre. Sa gjë e bukur! Atë natë e kishte parë edhe në ëndërr. I ishte dukur sikur kishte veshur një palë rroba kapiteni marine dhe drejtonte barkën nëpër detin me furtunë. Barka kishte qenë duke u mbytur. Të gjithë shokët i ishin lутur Çerrit t'i shpëtonte. Madje edhe Korabi. Dhe ai me guxim e kishte drejtuar barkën dhe i kishte nxjerrë të gjithë shëndoshë e mirë në breg.

Atë ëndërr nuk do t'ua tregonte shokëve. Ata me siguri do të qeshnin. Sidomos Tuti, që shakanë e kishte në majë të gjuhës.

U ngrit dhe veshi pantallonat. U shtriq dhe nxori kokën në dritare. Moti ishte i mirë. Edhe ai copë det që shihej që andej ishte i kaltër dhe i qetë.

Duke veshur këmishën, hapi derën dhe doli jashtë.

Hodhi sytë pérreth. Nëna nuk dukej. Ndoshfa kishte shkuar pér tē mbushur ujë nē çesmë. Vetëm babai ishte nē oborr duke çarë dru.

— Sa është ora, baba? — tha Çerri duke ngritur kokën pér tē parë diellin.

— Nuk e di mirë, po besoj shtatë, — tha Spiroja me atë zërin e tij tē hollë e tē pafuqishëm. — Pse pyet, Serafin?

— Kot, — tha djali dhe vuri re se dielli po i afrohej mesit tē qiparisit tē madh, që ishte nē hyrje tē varrezave aty nē kodër.

Djalit i dukej çudi kur e thërrisin me emrin e tij, se ishte mësuar që tē gjithë nē qytet ta quanin Çerr pér shkak tē trupit tē vogël, që e bënte t'i gjasonte zogut tē ferreve. Prindërve nuk u pëlgente kjo, madje u vinte inat që atë e quanin Çerr, kurse ai e kishte emrin Serafin.

Çerri pa babanë që fshiu me kurrisin e dorës së majtë djersët nga balli. Me hap tē shpejtë iu afrua dhe i tha:

— Më lër mua, baba, tē çaj dru.

Spiroja nuk kundërshtoi. Ai ishte shëndetlig dhe ajo punë e mundonte shumë. Ai nuk ishte më shumë se dyzet e pesë vjeç, por me atë fytyrë tē rrudhur dhe me qime aty-këtu, me ata sytë si tē shuar dhe me flokët e përhimë dukej sikur ishte gjeshtëdhjetë vjeç. Ishte martuar vonë dhe Çerri ishte fëmija e parë. Spiroja ishte rritur jetim dhe tërë jetën, që kur ishte i ri, kishte punuar si rojtar i vareve tē qytetit. Kishte ndenjur gjithmonë i vëtmuar, pa miq e shokë dhe ashtu shëndetlig dhe i mënjanuar nga bota i kishte kaluar vitet. Me shumë vështirësi ishte bindur tē martohej dhe kishte marrë një vajzë tē shëndetshme nga fshati Shënavlash, nē afërsi tē Durrësit. Gruaja e tij, Lefti, kishte sjellë një përbysje nē jetën e tij. Çdo gjë kishte ndryshuar pér tē. Ata kishin ngritur

shtëpi, Lefti kishte lindur dy fëmijë të bukur. Ajo punonte tërë ditën dhe shtëpizën ia mbante dritë. Jetonin varfërisht, por ishin të ndershëm dhe shumë të dashur.

— A hëngre mëngjes? — e pyeti i ati Çerrin.

— Jo, — u përgjigj ai dhe i mëshoi sëpatës. Ndjeu se ato lëvizje i bënin mirë. Papritmas iu kujtua puna e barkës, e ndërpreu punën dhe e pyeti të atin, që ishte ulur te një copë shtyllë në cep të oborrit: — O baba, ku mund të gjej pak zift?

— Zift? — pyeti i habitur Spiroja. — Ç'të duhet?

Çerri mendoi t'i thoshte të vërtetë, por iu duk sikur i ati nuk do ta kuptonte, iu kujtua gjithashtu porosia e Minait që ta mbanin të fshehtë punën e barkës. Tha vetëm kaq:

— Kot, më duhet për një punë.

— Zift kanë punëtorët që shtrojnë rrugën e Vilës.

— A mund t'i kërkosh ndonjërit të të japë një kovë?

— Mirë, mirë...

Ai vijoi të priste drutë, ndërsa Spiroja rrinte gjithnjë i ulur te shtylla, duke shikuar para vetes me sytë e tij si të shuar. Ballin e rrudhur ia mbulonin flokët e përhimë. Nga rruga u ndje një uturimë.

— Po vjen cilindri që shtyp gurët, — tha Spiroja dhe Çerri pohoi me kokë.

U dëgjua një zë që thirri:

— O Çerr!

Djali ktheu kokën: ishte Minai. Ai ia bëri me dorë që të shkonte te ai.

Çerri la sëpatën. Babai e dëgjoi thirrjen, e pa djalin duke u larguar, por nuk tha gjë.

— Do të shkojmë te barka? — tha Çerri, pa iu afruar mirë shokut.



— Jo, më ka ndodhur diçka, — tha Minai dhe hodhi sytë anash. Çerrit i ngriu gjaku.

— Si është puna? — e pyeti.

— Mos u bëj merak. Nuk ka lidhje me barkën. Mua prindërët më kanë futur në punë. Sot do të shkoj në Stambollë.

— Po barkës si do t'ia bëjmë,

Minai nuk foli. Pa e kuptuar, dy djemtë zunë të ecnin. Në rrugë katër-pesë punëtorë merreshin me shtrimin e saj. Diku aty pranë dihaste rëndë cilindri i madh, që dukej si ndonjë kafshë parahistorike.

— Barkën do të vazhdojmë ta rregullojmë, — tha Minai pas pak, — por do të punojmë pasdite dhe jo në mëngjes. Ose, më mirë të them, unë do të vij pasdite, pasi të dal nga puna.

— Si? — tha Çerri dhe qëndroi në vend. — Do të punojmë pa ty?

— Po, po, — u përgjigj Minai. — Ju do të punoni paradite, kurse unë do të vij pasdite. Dëgjo, unë tani duhet të shkoj në punë. Madje jam vonuar. Fishë e fabrikës ka rënë qëkur. Meqenëse sot është dita e parë, ndoshta do më pranojnë. Të thirra që të shkosh t'u thuash shokëve se unë nuk do të vij.

— Mirë, — tha Çerri me qejf të prishur, pasi ai e donte shumë Minain dhe e dinte se, kur ishte ai, e ndiente veten më të qetë.

— Edhe një gjë tjetër, — tha Minai duke vazhduar rrugën drejt fabrikës së cigareve: — a gjete ndonjë gjë për barkën?

— Fola me babanë, — tha Çerri, — do t'u kërkojmë punëtorëve që shtrojnë rrugën një kovë zift.

— Mrekulli. Edhe unë do të shoh atje në fabrikë se mos ka ndonjë gjë të hedhur, që mund të na hyjë në punë

Ata vazhdonin të zbrisnin rrugën e kodrës. Flisnin me zë të lartë dhe shikonin pasqyrën e kaltër të detit, që shtrihej nën-këmbët e tyre. Reflekset e argjendta të diellit lëviznin orë e çast mbi sipërfaqen e qetë. Diku larg lundronte një barkë e vogël peshkimi, që dukej si një pikë e zezë atje larg. Në port kishin hedhur spirancën tre vaporë italianë dhe një luftanije, që nxirrte një tym të dendur të zi.

— Çfarë pune do të bësh në fabrikë? — e pyeti Çerri shokun e tij pasi ecën disa çaste të heshtur.

— Nuk e di. Babai më tha se do të mbaj arka, — tha Minai me një ton të qetë. Ai nuk i kishte mbushur ende të katërmbehjetë vjetët, megjithatë, në qëndrimin e tij, në mënyrën si fliste e si arsyetonte kishte diçka prej të rrituri, që i habiste shokët dhe i bënte që ta nderonin.

Te dera e fabrikës ishte një tabelë e shkruar me shkronja të mëdha: «Stamles». Në oborr kishte lëvizje dhe një grumbull arkash e mbeturinash të hedhura andej-këtej. Nga brenda vinte një zukatje e pandërprerë motorash.

Dy djemtë qëndruan para hyrjes. Të dy nuk flisnin. Vështronin oborrin, ndërtësën ngjyrëhiri, dëgjonin zhurmën e motorave dhe mendonin. Minai shikonte më me vëmendje dhe për herë të parë në jetën e tij provonte një ndjenjë të çuditshme. Ai njihte shumë burra dhe gra që punonin në atë fabrikë. Ata banonin në Stan dhe i kishte parë me vite që dilnin nga shtëpitë në mëngjes, pa zbardhur mirë dita, dhe që kthehej pasditeve vonë, të dërrmuar, të zbetë në fytyrë, duke ngjitur me vështirësi kodrën e Stanit. Në mëngjes, në tërë qytetin përhapeshin tingujt e çjerrë të fishës së fabrikës, që çanin ajrin dhe prishnin gjumin dhe ëndrrat e njerëzve.

Që sot këto gjëra Minai do t'i ndiente vetë. Si do të

ishte puna? A do të kishte mundësi aï që, pas punës së rëndë që do të bënte aty, të ishte në gjendje të shkonte pasditeve te Currilat për t'u marrë me barkën? Po pasi ta rregullonin, ç'do të bënte ai me të? Nuk do të kishte mundësi të dilte në det të hapët dhe të zinte peshk, siç e kishte menduar.

Do të hysh? — e pyeti Çerri me zë të ulët. As ai vetë nuk e kuptoi pse e bëri atë pyetje në atë mënyrë.

— Po, — tha Minai dhe ktheu kokën e shikoi shokun e tij më të vogël.

— Te dera ka roje, — tha Çerri duke bërë me kokë nga hyrja.

— E shikoj, — tha Minai, pastaj iu kujtua emri i njeriut që i kishte thënë i ati të kërkonte aty. Shkoi te hyrja dhe aty diç i foli rojës, një plak i shkurtër me syze dhe me shkop në duar.

— O Hysen, kërko pak Fadil Gjormën dhe i thuaj të vijë këtu, se e do ky djali.

Pas disa minutash nga brenda fabrikës doli një burrë i gjatë, me një kasketë në kokë dhe mustaqe të dendura. Ai eci me çape të mëdha drejt portës.

— Kush më kérkon?

Ky i tregoi Minain.

— Unë jam djali i Vasilit, — tha Minai dhe ngriti kokën. Pa një palë sy të vëmendshëm që e shikonin ngultas.

— A, e more vesh, — tha Fadili, pastaj se ç'i foli rojës, u kthyte nga Minai dhe i bëri shenjë që t'i shkonte pas.

Çerri e ndoqi me sy shokun që po largohej nëpër oborrin e fabrikës. Te dera, Minai ktheu kokën. Çerri e përshëndeti me dorë.

Minai kaloi pragun dhe hyri brenda.

Çerri ecte rrugës i mërzitur. Mungesa e Minait ia kishte prishur qejfin. Gëzimi i barkës i ishte zbehur. Rruga për në Currilat iu duk e gjatë, shumë e gjatë. Ai nuk kishte ngrënë mëngjes, megjithatë nuk i hahej edhe pse barkun e ndiente të zbrazët. E merrete me mend se edhe të tjetër do të mërziteshin kur të shikonin se mungonte Minai.

Rrugës së gjatë, plot pluhur, ai nuk ndeshi njeri. Vëtëm një karrocë e mbushur me gra dhe dy burra që thërrisin, kaloi me zhurmë pranë tij. Ai pa kamzhikun e karrocierit që vërtitej në ajër dhe i nxiste kuajt të ecnin shpejt.

Kur zuri të ecte në rrugën e gjatë që të conte në Currilat, në bregun plot lështerik ai pa një burrë të veshur me rroba të leckosura, që mbante në krah një thes të madh dhe i hidhte hapat me sytë përtokë. E njoihu: ishte Lapi, një ish-hamall i papunë, që tërë ditën nuk bënte tjetër veç endej gjatë bregut duke mbledhur shkarpa, copa dërrasash, kuti boshe e çfarë sillte deti. Me to mbushte thesin dhe i shiste për të nxjerrë një kafshatë bukë.

— E, Lapo, a ke gjetur gjë? — e pyeti Çerri.

Burri me thes në krah ngriti kokën dhe pa djalin që i foli, dhe tha:

— Pak, shumë pak. Edhe deti është bërë koprac...

Çerri vazhdoi rrugën, megjithëse kishte dëshirë të fliste me Lapin, pasi e dinte se ishte i zgjuar dhe thoshte gjëra me kripë që të kënaqnin, por ai druhej se mos vonohej dhe e prisnin shokët.

Kur mbërriti te bregu përballë «Tryezës», hodhi sytë përreth deri te shkëmbi, por nuk pa njeri.

— Mos kam ardhur shpejt? — tha me vete.

Nuk dinte ç'të bënte. Hoqi këpucët dhe u ul në breg. Futi këmbët në ujë dhe vuri re se ai ishte ende i ftohtë.

Ai po llapashiste këmbët në ujin e detit, kur dëgjoi pas vetes zërin e Tutit:

— Vetëm qenke, o Çerr?

Çerri u ngrit në këmbë dhe, porsa pa shokun e tij, vuri buzën në gaz. Pastaj i tha:

— Minai nuk do të vijë.

— Pse?

— Sot nisi punën në Stamles.

Tuti fishkëlleu, u mendua një çast dhe tha:

— Mos more! Na u prish plani,

— Jo, jo, — foli Çerri, — ai do të vijë pasdite, sa të mbarojë punën.

Tuti shikoi një guralec që ishte pranë bregut, iu afroa dhe e goditi me shqelm, duke e flakur tej, në det.

— Edhe mua më caktoi babai me punë, — tha pas pak ai; — më përositi njëqind herë të qëndroj në shtëpi e të merrem me zarzavatet e bahçes, por unë u hodha disa kova ujë atyre dhe ia mbatha pa u ndier. E di që në darkë do të ha disa shuplaka, por s'ke ç'i bën... shuplakat për kalamajtë janë, thotë xhaxhai im.

Çerri vuri buzën në gaz. Atij i pëlqenin fjalët me kripë që thoshte Tuti, megjithëse nganjëherë, kur e ngacmonte ai, i vinte pak thartë. E dinte se shoku i tij ishte i mirë, paçka se nganjëherë nuk mendohej shumë dhe vepronte në tym. E kishte dëgjuar disa herë Minain që e qërtonte.

— Një gjë nuk po marr vesh: pse nuk ka ardhur ende Korabi, ç'do t'i ketë ndodhur Shtyllës?

— Nuk e di, — tha Çerri, — mbasë ka ngatërruar orën.

— Jo, nuk besoj; Shtylla nuk është gjumash.

Kur mungonte Korabi, Tuti e quante me nofkën, «Shtylla», për shkak të trupit të tij të gjatë.

— Dje e nisëm shumë mirë punën, — tha Çerri me keqardhje dhe hodhi sytë andej nga shkëmbi.

— Po, shumë mirë, — ia ktheu Tuti, — po ç'e do se nuk po e vazhdojmë dot. Unë solla edhe disa letra të trasha katramat.

— Ku i ke? — pyeti Çerri, që u gjallërua menjëherë.

— Ja, këtu, — tha Tuti dhe bëri me shenjë nga bregu.

Çerri pa një tufë lettrash të hëdhura mbi rërë. Ato nxinin aty të mbledhura shuk.

— Ku i more?

— I gjeta në rrugë, mu para shtëpisë sime. Duket kishin rënë prej ndonjë kamioni, se janë të papërdorura. I gjeta, për nder të familjes, mos më shiko ashtu, Çerr.

Çerri nuk e dinte se përsë do t'u hynin në punë ato letra të trasha të lyera me zift; ndoshta mund të shtronin pjesën e brendshme. Deshi të pyeste Tutin, por ndërroi mendim dhe heshti. Shikoi detin.

— Çfarë të bëjmë? — pyeti Tuti i mërzitur.

— Nuk e di... Po sikur të shkojmë atje te Tryzea dhe...

— Çfarë të bëjmë? Vetëm nuk punojmë dot.

— Pse jo? Mund të bëjmë ndonjë gjë.

Tuti iu afrua Çerrit dhe tha:

— Nuk kemi asnjë vegël. Me çfarë do të punojmë, me duar? Minai dhe Korabi thanë se do të sillnin ndonjë çekiç, darë, një sëpatë të vogël dhe atëherë mund të bënim gjë. Po kështu si jemi ne...

Tuti kishte të drejtë. Ishte vërtet e kotë të shkonin te shkëmbi, pasi nuk mund ta zinin barkën me dorë.

— Fundi i fundit shkojmë e shohim një herë mos e ka ngarë njeri barkën, — tha Çerri i gjallëruar nga ai mendim. — Mund të çojmë atje dhe letrat katramat. Si thua?

Tuti nuk u përgjigj, po nisi të zhvishej pa folur. Lëvizjet e tij ishin të ngadalëta, të qeta. Edhe Çerri u zhvesh, po më shpejt se shoku i tij.

Notuan drejt shkëmbit ngadalë, duke mbajtur në një dorë plaçkat. U ngjitën lart dhe gjëja e parë që bënë, shkuan të shihnin barkën. Ajo ishte aty ku e kishin lënë dje. E shikuani me vëmendje. Për çudi, atë mëngjes atyre iu duk më e dëmtuar sesa ditën e parë. Kishte mjaft punë për ta prurë në atë gjendje që të voziste në det.

Tuti hyri brenda dhe zuri të prekte dërrasat e fundit dhe ato anësoret. Disa ashkla i mbetën ndër duar.

— Duket që është e kalbur, — tha Çerri.

— Po të ishte e re, nuk e braktisnin aty, — tha Tuti dhe zuri të trokiste me çokun e gishtit në pjesë të ndryshme.

— Letrat katramat mund ti shtrojmë këtu, — tha duke treguar me dorë fundin.

— Tani? — pyeti Çerri.

— Jo, mor Çerr, jo, kjo mund të bëhet kur të kenë mbaruar punët e tjera. Sipas kësaj radakes sime, puna kryesore është të gjejmë dërrasa dhe të zëvendësojmë pjesët e prishura ose ato që mungojnë fare. Të tjerat janë më pak të rëndësishme.

Çerri dëgjonte me vëmendje. Atij i dukej se Tuti fliste mirë, megjithatë do të duhej të dëgjonte edhe mendimet e Minait, pasi e dinte që ai merrte vesh më shumë se të tjerët nga ato punë. Atë çast Çerri mendoi: Ç'do të jetë duke bërë Minai? Apo lodhet atje në fabrikë? Ai i kishte parë punëtorët kur dilnin nga fabrika: ata mezi çapiteshin nga lodhja dhe mundi i madh, ishin të verdhë në fytyrë dhe nuk flisnin, por vetëm shikonin me sytë e tyre të menduar.

— Shtylla e prishi fare punën sot, — tha Tuti. — Si nuk erdhi ai?

Çerri u shkëput nga mendimet dhe hodhi sytë nga brengu. Ky ishte i shkretë. Asnjeri nuk kalonte. Ndjeu se bar-kun e kishte bosh dhe po e grinte uria. I ra ndër mend se nuk kishte vënë gjë në gojë. Le të tjerat, por i ati me t'ëmën me siguri do të ishin bërë merak, pasi ai ishte larguar pa ngrënë dhe pa i lajmëruar ku po shkonte.

— Po sikur të shkojmë e të shohim si është puna e Korabit? — tha Çerri, duke menduar që t'i binin rrugës së kodrës dhe të kishte mundësi të kthehej në shtëpi sa të merrte një kafshatë në dorë dhe t'u hiqte merakun pri-ndërve.

— Edhe kështu mund të bëjmë, — tha Tuti. — Po nuk ka lezet të shkojmë e t'i marrim të tjerët nëpër shtëpi. E lamë që të takohemi këtu dhe duhet të jemi të rregullt.

— Mirë thua, — miratoi Çerri, — po ku ta dish se si e ka pasur punën Korabi. Nuk besoj që ai të mungojë kot.

— Ndoshta është ashtu si thua ti, — tha Tuti, — edhe mund të ketë pasur ndonjë hall, se hallet pér njerëzit janë, thotë xhaxhai im. Mirë, eja të shkojmë. Ne, a nuk do të bëjmë gjë bashkë?

Duke ecur rrugës, Çerri i tregoi se babai i kishte dhë-në fjalën pér ziftin dhe do të bënин mirë të shkonin nga kodra, që ai të kthehej një çast në shtëpi.

Ngjitën kodrën me hapa të shpejtë. Donin të arri-nin sa më parë në qytet dhe të merrnin vesh si e kishte punën Korabi.

Te gardhi i shtëpisë Çerri pa nënën që rrinte aty me Katin në krahë. «Mua më kërkon», — mendoi Çerri dhe i erdhi keq që ishte larguar pa u thënë gjë prindërve.

— Po ku je, mor djalë? — tha nëna dhe sytë i ndritë, megjithëse ajo ishte përgjithësisht grua e qetë, Kati zgjati duart, e qeshur, drejt të vëllait.

— Ja, këtu... isha me Tutin, — tha Çerri duke i zënë doçkat së motrës.

— Po si ikën pa thënë asnjë gjysmë fjale? Ke ngrënë? Jo, e dija. Shko, se e ke gati.

Çerri vrapi po drejt shtëpisë. Tuti u afrua dhe shkëmbeu disa fjalë me nënën e shokut. Ai kishte qenë edhe disa herë aty dhe ajo e njihet. I pëlqenin shokët me të cilët shoqërohej i biri, megjithëse ishin më të mëdhenj se ai. Me Minain njihet më mirë, pasi i shoqi me babanë e tij ishin miq prej vjetësh dhe kjo kishte ndihmuar që të lidhej miqësia në mes të dy fëmijëve.

Duke dalë nga shtëpia, Çerri ktheu kokën dhe pa babanë që ishte në mes të varrezave me një lopatë në dorë. Edhe ai e pa.

— Baba, mos harro ziftin, — i thirri Çerri dhe shkoi te Tuti, që e priste aty jashtë. Duke ecur, kafshonte me oreks të madh copën e bukës së zezë, të mbuluar me një shtresë të hollë gjize.

— A do të vonohesh? — i tha e ëma, kur e pa që u nis bashkë me Tutin poshtë kodrës.

— Jo, — tha Çerri me gojën e mbushur plot.

Te dera e fabrikës të dy djemtë qëndruan se mos ndoshta shikonin Minain. Panë dy-tre fëmijë që kaluan nëpër oborr duke mbajtur mbi shpinat e tyre të njoma arka të ngarkuara, por asnjeri prej tyre nuk ishte Minai.

— Ama punë! — tha Çerri.

— Lëre, lëre!... u përgjigj Tuti duke tundur kokën. Duke ecur nëpër një rrugicë të ngushtë, Tuti tha:

— Aty në fabrikë, Minai do të fillojë të pijë cigare.

— Kush ta tha?

— Ja, po e them unë. Njoh një djalë që punon aty dhe e pi. Mërzitesh, lodhesh shumë, shikon dhe të tjerët që pinë dhe thua me vete: hajt se po e ndez edhe unë një.

Rrugët e qytetit ishin me njerëz dhe aty-këtu gu-mëzhinin kamiona të ushtrisë italiane, që lëvizin pare-shtur nëpër rrugët e qytetit. Në kafene e dyqane kishte plot ushtarë të huaj që hynin e dilnin duke folur me zë të lartë. Te tregu i fshatarëve ata panë shumë kafshë, gomarë dhe kuaj, që ecnin ngadalë, të tërhequr prej kapistalli dhe të ngarkuar me kosha të mëdhenj.

— Sikur të kishim kohë, do të bënim qejf me gomarët, — tha Tuti.

— Nuk të kuptoj, — vërejti Çerri.

— Nuk e di ti? Fshatarët shkarkojnë koshat dhe kafshët i çojnë te hani i Ali Bidulit. Unë vij shpesh këtu dhe, kur shikoj që ata shkarkojnë, u them: ma jep mua gomarin ta çoj te hani. Fshatarët ma japin. Unë i hipi dhe kënaqem duke ecur deri te hani. Nuk ke hipur ndonjëherë mbi gomar ti, Çerr?

— Jo.

— Do të të marr ndonjëherë dhe do të vijmë këtu. Ke për të parë sa qejf do të bëjmë. Shëtitje pa para. Një ditë më takoi një gomar zevzek, donte të më hidhte në tokë; mos të isha mbajtur mirë, do të më kishte fluturuar.

Duke folur, ata iu afroan shtëpisë së Korabit. Kjo ishte një barakë gati në të rënë, në fundin e një rrugice qorre.

— A thua ta gjemë në shtëpi? — pyeti Çerri.

— Nuk e di. Sidoqoftë, ata do na thonë ku ndodhet Shtylla.

Iu afroan barakës së vjetër. Atë çast dolën dy gra duke folur njëra me tjetrën dhe duke tundur kokat e tyre të mbështjella me shall të zi.

— Prit këtu, se po futem unë brenda, — tha Tuti dhe eci drejt derës.

Sa u mat të trokiste, dëgjoi disa zëra që flisnin ngadalë. Në mes tyre i zuri veshi një zë gruaje. Ishte një zë, që diç thoshte duke përsëritur fjalën «i shkreti».

Tuti shtyu derën. Nga errësira që ishte brenda, në fillim nuk dalloi asgjë. Dëgjoi vetëm një frymëmarrje të rendë. Pak nga pak vuri re një njeri të shtrirë në tokë.

— Kush është? — pyeti një zë gruaje. Ai e njohu: ishte zëri që kishte dëgjuar para se të hynte brenda.

— Desha pak Korabin, jam një shoku tij.

— Kush është? — tha një zë burri.

— Jam Tuti, — u përgjigj djali dhe nuk dinte ç'të bënte.

— Është një shok i Korabit, — tha gruaja duke iu drejtuar burrit, që qëndronte në një cep të dhomës.

— Ku është Korabi? — tha prapë Tuti dhe vuri re që burri (të cilin e njohu që ishte babai i shokut) rrinte shtrirë, i mbuluar me një jorgan që i rrinte deri te fyti.

— Çfarë hallesh kemi ne, çfarë thotë ky! — foli gruaja.

Tuti nuk dinte as ç'të thoshte, as ç'të bënte. E kuptoi se në atë shtëpi diçka kishte ngjarë dhe, siç dukej, ishte fjala për babanë e shokut të tij. E dinte se hamalli i portit kollitej gjithnjë dhe kishte dëgjuar se vuante nga mushkëritë.

— A do të vijë Korabi? — tha Tuti duke e ulur zërin.

Gruaja psherëtiu, kurse babai i Korabit u kollit. Kolla e tij nuk ishte e thellë, por tepër e thatë, e shkurtër.

Tuti nuk e zgjati. Pa bërë zhurmë mbylli derën dhe u largua.

— Pse u vonove? — e pyeti Çerri dhe u mundua të hetojë në fytyrën e shokut.

Tuti nuk foli. Ecën pak në heshtje. Çerrin e brente dëshira të merrte vesh si ishte puna.

— Korabi nuk ishte, — tha Tuti.

Pas një gardhi të bërë me kallama, një djalë me prenka në fytyrë i pa dhe u tha:

— Korabi ka shkuar të marrë mjekun, se ka babanë shumë të sëmurë.

Dy djemtë qëndruan. Djali pas gardhit shtoi:

— Ka shkuar qëkur; babanë e tij e sollën dy shokë për krahësh, se i kishte rënë të fikët në punë.

— Sa kohë ka? — pyeti Tuti.

— Ku ta di unë, — u përgjigj djali dhe, pasi u mundua pak, tha: — mund të ketë nja dy orë. Po sikur vjen kollaj mjeku! Me çfarë do ta paguajnë?

Dy djemtë ndenjën ca kohë të menduar. Parashikimi i Tudit ishte vërtetuar. Nuk dinin ç'të thoshin dhe vazhduan të ecin. Pasi u larguan disa metra, Tuti ktheu kokën dhe i thirri djalit me prenka:

— I thuaj Korabit që pasdite e presim te ai vendi që e di ai.

— Po ai ka babanë të sëmurë! — tha Çerri.

— Mirë thua, — foli Tuti dhe i thirri prapë atij djalit. — Të vijë në qoftë se i bëhet babai më mirë. Kuptove?

Të dy djemtë vazhduan rrugën të menduar dhe të mërzitur.

— Sa ters nisi kjo ditë! — tha Tuti.

— Lëre, lëre! — tha Çerri duke përsëritur fjalët që tha Tuti, kur u larguan nga dera e fabrikës së cigareve.

Papritmas, në ajrin e pasdites u përhap piska ma e mprehtë e fishës së fabrikës. Tuti me Çerrin nuk e prisnin dhe kërcyen përpjetë të trembur. Madje Çerri zuri veshët. Ata dëgjonin çdo ditë fishën e vetme të qytetit, por kurrë nuk kishin qëlluar kaq afër. Ajo kishte një zë të lemerishëm. Tuti tregonte se kishte dëgjuar nga babai që, kur ishte vënë për herë të parë ajo fishë, gjyshja e tij thoshte se zëri i saj ishte zëri i një përbindshi, që kishte ardhur që prej detit për t'i munduar e për t'u thithur gjakun njerëzve.

Te hyrja nisën të dukeshin turma njerëzish, që dilnin nga barku i madh i fabrikës. Ishin njerëz të lodhur, të verdhë në fytyrë, të veshur keq. Disa mezi i hiqnin këmbët, të tjerët ishin si të trullosur. Gratë ecnин me hapa të shkurtër dhe të gjithë thuajse ishin veshur me të zeza. Në mes tyre kishte edhe fëmijë me trupa të hollë, me sy të mëdhenj që shkëlqenin, me supe të ngushta dhe qafa të gjata.

Dy djemtë i shikonin të heshtur dhe mendonin se gjyshja e Tudit kishte pasur të drejtë, se ajo fabrikë vërtet ishte një përbindsh, që u thithë gjakun njerëzve dhe i mundonte së tepërmë.



— Mua po më prisni? — dëgjuan ata zërin e shokut tyre, që u doli përpëra befasisht.

— Minai! — thirrën djemtë gati me një zë dhe u qeshi fytyra.

— Nuk të pamë fare, — tha Tuti.

Heshtën. Shikuan njëri-tjetrin. Minai dukej sikur kishte ndryshuar atë paradite. Rrobat e vjetra i kishte të mbuluara me pluhur të verdhë duhani. Mbane një erë të rëndë. Fytyrën e kishte të lodhur, flokët i kishte të shpupurishur dhe duart plot vraga të kuqe.

— Po Korabi ku është? — pyeti Minai.



Tuti i tregoi shkurt si qëndronte puna. Minai u mërit zit dhe ata zunë të ecnin të menduar në drejtim të kodrës.

— Unë mora këto dërrasa të hedhura në oborr, — tha Minai dhe ngriti duart për t'ua treguar shokëve. — Barkën do ta mbarojmë, apo jo? Po ju çfarë keni sjeillë?

Duke folur, ata ngjitnin rrugën e kodrës. Minai nuk e cte si zakonisht dhe dy shokët e vunë re. Ai ishte i lodhur. Pa bërë fjalë, ata çapiteshin ngadalë. Madje edhe dërrasat e një çekiç që ia kishte huajtur usta Mitit, ia morën për t'ia mbajtur ata.

Kur arriten pranë shtëpisë, Çerri ia krisi vrapi dëshirat dhe u kthye me një kovë të vjetër mbushur me zift.

— Babait ia kishin dhënë punëtorët e rrugës, — tha ai duke ngritur lart kovën e mbushur.

Tuti i tregoi Minait edhe për letrat katramat, që kishte lënë atje te «Tryeza».

Sa nisen të zbrisnin kodrën, Tuti ngriti kokën dhe vuri re një parullë të madhe prej bezeje, që italianët kishin vënë poshtë Vilës, në faqen e kodrës.

— C'është kjo? — pyeti ai.

— Është një parullë që e kanë vënë fashistët, — tha Çerri.

— Aty shkruan Vinçeremo, — foli Minai; — kjo do të thotë do të fitojmë. Është një parullë fashiste për të thënë se gjoja ata do ta fitojnë luftën.

— Do të fitojnë dardhat e shëndreut, siç thotë xha-xhai im, — tha Tuti duke i rënë bërrylit.

Fjalëve të tij u bënë jehonë të dy shokët dhe, ashtu duke folur e duke qeshur, ata arriten te Currilat. Atë pasdite plazhi i vogël dukej me më shumë njerëz se herët e tjera. Bënte vapë dhe në breg kishte njerëz, që rrinin në diell dhe të tjerë që laheshin në det.

— Thonë se atje te Gurët ka peshkaqen! — tha Çerri duke bërë me kokë nga deti.

Gurët quheshin mbeturina muresh, që ishin brenda detit nja dyqind metra larg bregut.

— Nuk besoj, — tha Tuti; kam dëgjuar edhe unë, po nuk më mbushet mendja.

Minai u mendua një çast, pastaj tha:

— Te gurët e parë nuk ka, por ndoshta te gurët e dytë afrohen ndonjëherë.

Te bregu, atje para shkëmbit të tyre, ishin një djalë dhe një vajzë, që bisedonin diçka me gjallëri. Fëmijët ngadalësuan hapat.

— Do shkojmë atje? — pyeti Tuti.

— Presim pak, — tha Minai.

Fëmijët iu afruan çiftit dhe bënë sikur kërkonin në breg guaca deti.

Djali ktheu kokën, i shikoi. Vajza ia bëri me shenjë. Pa fôlur, ata vazhduan të ecnin gjatë bregut, tutje tyre.

Djemtë u zhveshën me shpejtësi dhe me not shkuant te «Tryeza».

— Na thuaj çfarë duhet të bëjmë, — tha Tuti, duke iu drejtuar Minait.

— Mirë thotë, miratoi Çerri.

— Unë vërtet jam lodhur në punë, — foli Minai, — por edhe këtu do të punoj. Barka është e të gjithëve dhe të gjithë duhet të punojmë. Tani të shikojmë ç'do të bëjmë me këto që kemi sjellë.

Ata qëndruan para barkës dhe ia nisën punës.

## K R E U I K A T È R T

Tuti ngriti kokën dhe shikoi diellin. Ai ishte ngjitur nja dy hostenë në kupën e kaltër të qillit. U munda të merrte me mend sa ishte ora.

— Do të ketë shkuar nëntë, — tha me zë.

I ati, që po prashiste aty pranë e dëgjoi dhe tha:

— Ç'farë the?

— Jo, jo, asgjë.

— Hajt, ule kokën dhe vazhdo punën. Luaj duart, mor çun, se të qan puna në dorë, mor i shkretë...

— Mua? Kam që në mëngjes që ujit.

Pa mbaruar fjalët, Tuti mori kovat dhe shkoi prapë te pusi, që gjendej para hyrjes së shtëpisë.

— A u lodhe, Tuti? — e pyeti e éma, që nxori kokën në dritaren pa xhamë të kthinës ku gatuante.

— Pak, — tha ai dhe lëshoi kovën në pus. E dëgjoi *që ajo zbriti poshtë duke u përplasur nëpër faqet e brendshme të pusit. Litari rrëshqiti me shpejtësi, duke u shpërdredhur para syve të tij. Në fund u dëgjua një zhurmë e mbetur, kova ishte zhytur në ujë.*

Duke têrhequr kovën plot me ujë, ndjeu se krahët i dhembnin. Ishte lodhur; që në mëngjes nuk kishte bërë asnjë pushim. Megjithatë, babai nuk ishte i kënaqur dhe i thoshte se atij i qante puna në dorë. Gjene mirë, sepse xhaxhai i thoshte: «Ty nuk të qan, por të ulërin puna...»

Dhe ia plasi gazit me atë zërin e tij të kumbueshëm. I tillë ishte xhaxhai i tij: sa herë që vinte në shtëpi, ata e ndienin që në krye të rrugës nga e qeshura e tij. Ai, Muharemi, ishte shofer i një kamionni të shoqërisë italiane «Truki» dhe bënte rrugë të gjata e lodhej mjaft. Tuti e donte shumë dhe i pëlqente humorë i tij, gjallëria e tij. Muhamremi i kishte premtuar atij se ndonjë ditë do ta merrte në makinë për të shkuar deri në Korçë. Tuti e priste me padurim këtë ditë.

Babai i tij, Sula, ndryshonte shumë prej të vëllait: ishte vërtet trupmadh dhe i fuqishëm, pak gjaknxehtë, megjithëse aty nxehet, aty ftohet. «Ti je si marsi, — i thoshte riëna me shaka, — që aty bie shi, aty del dielli». Ndoshta edhe babai kishte dëshirë të ishte po aq gazzmor, sa i vëllai beqar, por ai kishte pesë fëmijë të vegjël, që duheshin ushqyer me atë copë bahçe që kishte me qira.

— O Tut, eja, se të zuri darka, — dëgjoi zërin e babait, që e thirri nga kopshti.

Djali mbushi dy kovat e vogla, futi stabin në mes dhe i vuri në sup.

Ktheu kokën nga babai e vuri re se ai ishte djersitur dhe merrte frymë me vështirësi. Kishte nisur punën pa lindur dielli. Nga këmisha e hapur ai pa kraharonin e tij leshatak.

— Hajt, luaj duart, Tut, mbaroje ujitjen!

— Atë po bëj, baba, — tha Tuti. — Pastaj dua të dal, se kam punë.

— Posi, posi, të mbytën punët ty! — ia priti i ati duke vënë buzën në gaz.

Mori kovën dhe zuri të ecte në mes të vijave të mbjellë. Uji rridhte ngadalë, pasi babai e kishte porositur që t'ia hidhte me kujdes. Duke punuar, nisi të mendojë për barkën. Ishin bërë më se dy javë që punonin gati çdo ditë atje,

dhe tani ajo kishte ndryshuar shumë. Me lëndët e gjetura andej-këtej kishin zëvendësuar shumë pjesë të kalbura e të dëmtuara dhe i kishin vënë të reja. Nga jashtë e kishin lyer me zift që të mos fuste ujë. Brenda kishin shtruar letrat katramat dhe tani po kërkonin dy dërrasa të gjata që të bënin lopatat. Pastaj do të gjenin edhe bojë për ta lyer. Tudit i kishte dhënë fjalën një kushëriri i tij, që punonte në një oficinë, se do t'i gjente pak bojë. Sot e kishin lënë që të vinte ta merrte Çerri dhe bashkë të shkonin te Maksuti (kështu quhej ai punëtori i oficinës). Tani vetëm ata të dy merreshin paraditeve me barkën, Minai punonte gjithnjë në fabrikë; edhe Korabi, pasi babai i ishte sëmurur rëndë, kishte hyrë në punë dhe tërë ditën mbarte pësha të rënda në port. Pështive takoheshin te shkëmbi, në Currilat, dhe vazhdonin punën.

Tek po mendonte se çfarë boje t'i jepnin varkës, dëgjoi babanë që thirri me të madhe:

— Prapë ti, moj e mallëkuar! Prit, se ta rregulloj unë kurrizin.

Pa kthyer kokën, Tuti e kuptoi se babai i kishte thirru dhisë së fqinjtit të tyre, Veselit, e cila futej në kopshtin e tyre dhe bënte dëme.

Kur shikoi nga babai, e pa atë me hapa të mëdhenj iu sul dhisë me shatën në dorë. Sa u mat ta qëllonte, përtej gardhit u duk koka e madhe, me flokë të shkurtër e të përhimë, e Veselit që thirri:

— Mos e prek!

Sulës i mbeti shata e ngritur lart.

Dy burrat u grindën një copë herë, megjithatë Sula nuk e preku dhinë. Vetëm e shtyu dhe ajo u largua duke kapërcyer gardhin me të shpejtë.

— Shiko, Vesel, kësaj here e fala, por, po e gjeta edhe një herë tjetër, bëj gati kazanin që t'ia ziesh mishin.

— Mirë, mirë, veç mos e bëj të madhe, o Sulë, se kafshë është ajo dhe s'ka mend si robi.

— Po s'pat mend, jepi nga tuat.

— Turp të kesh që flet kështu! — tha Veseli dhe mori ndër duar kokën e dhisë. Ai e përkëdhelte si një foshnjë dhe e donte fort.

Sula u largua dhe i ktheu shpinën fqinjit. Diçka mërmëriste me vete. Kur arriti në vendin e mëparshëm, u kthye dhe tha:

— Të thashë edhe një herë, o Vesel, të jetë hera e fundit. E di që me të ushqen fëmijët, po edhe unë me këtë copë kopsht mbaj të mitë; edhe ata duan të hanë si të tutë, prandaj lidhe, të shkretën, se nuk ka lezet të grinde mi.

— Ke të drejtë, o Sulë. Herë tjetër do ta lidh më mirë që mos të futet në bahçen tënde. Si dukesh me punë?

— Çka, o Vesel, me zor e nxjerim kafshatën. Në pazar zarzavatet shiten shumë pak. Pastaj janë edhe buqit italianë të EIAS, që sjellin prodhime, se kanë tokë me tul ata dhe e zënë tërë tregun.

— E di, — tha Veseli i menduar dhe prapë përkëdheli kokën e dhisë.

U bë heshtje. Dy burrat shkëmbyen edhe disa fjalë me zë të qetë, pastaj Veseli e ftoi Sulën të pinin një kafe në shtëpinë e tij. Babai u mendua një copë herë, se donte të vazhdonte punën, pastaj la shatën dhe shkoi në oborrin e fqinjit.

Tuti shikoi bahçen; kishin mbetur pa ujitur edhe katër vija. Ai shpejtoi duart, shkoi edhe një herë të mbushë ujë në pus, pastaj la kovat, hodhi sytë nga shtëpia e Veselit dhe doli me hap të shpejtë. E ëma i thirri diçka nga prapa, por ai nuk u kthye: eci përpara duke menduar ta priste Çerrin në krye të rrugës,

«E di që babai do të bëhet nevrik që lashë dy vija pa ujitur, por s'kam ç' bëj, do të nxehet dhe do të ftohet!» mendoi djali dhe vuri buzën në gaz.

Në rrugë kaloi një kamion, duke lëshuar një uturimë të rëndë. Ishte krejt si kamioni ku punonte Muharemi. Hodhi sytë në kabinë. Pa një fytyrë me mustaqe të mëdha dhe me kasketë të rrasur deri te vetullat.

Nga fundi i rrugës dalloi Çerrin duke ecur me hap të shpejtë. «Tamam si çerr është», — mendoi Tuti dhe vuri buzën në gaz. Shtëpia e tyre e vogël ndodhej në periferi, pranë kodrave, andej nga Spitala, dhe ai shihte shpesh zogj e shpend të ndryshëm. Çerrat i njihte mirë dhe, sa herë i shihte, i kukohej shoku i tyre i shkurtër.

— Erdha, Tut, — tha Çerri. Ishte skuqur më fytyrë dhe këmbët i kishte tërë pluhur. — Ama pluhur që ka këtej nga ju, — shtoi ai.

— Ne jemi si në fshat, or Çerr, — tha Tuti dhe zunë të ecnin tok.

Deri te oficina ku punonte Maksuti, ishte një copë rrugë. Ata shkuau drejt atje. Tuti futi kokën pas një dere të madhe, pa katër-pesë punëtorë, që punonin rreth një makine të vjetër. Dëgjohej zhurmë dhe goditje çekani. Në një cep, një djalë i ri punonte me saldatriçen, duke shpërndarë përreth një shi shkëndijash.

Tuti shikoi punëtorët me radhë.

— Koza vuoi?<sup>1)</sup> — thirri një burrë me mustaqe të holla, që mbante në duar një fletore shënimesh.

— A është Maksuti këtu? — pyeti Tuti dhe prapë shikoi përreth.

Atë çast djali që quhej Maksut, ktheu kokën, la pu-

---

1) — Çfarë do?

nën dhe, duke fshirë duart me një tufë leckash, shkoi drejt tij.

— E, Tuti, erdhe?

Ata dolën jashtë. Çerri po priste disa metra më tutje. Punëtori i ri ishte i gjatë, me një fytyrë katrore, menofulla pak të dala. Krahët i kishte plot muskuj, që tendoseshin pas lëkurës së tij të zeshkët.

— Ti erdhe për bojën, apo jo, — tha Maksuti.

Tuti pohoi me kokë.

— Nuk më the, për çfarë të duhet boja?

Tuti u zu ngushtë. I vinte keq mos t'i tregonte Maksutit, por kujtoi porosinë e Minait.

— E mora vesh, e keni sekret, — tha Maksuti dhe me kurrizin e dorës së madhe fshiu ballin, — po të paktën më thuaj çfarë do të lyesh, metal, dërrasë, karton, apo...

— Dërrasë, — tha Tuti shkurt.

Maksuti e pa me vëmendje.

— Më prit këtu, — i tha pastaj shkurt.

Italiani me mustaqe të holla nxori kokën te dera.

— *Va a lavorare!*<sup>1)</sup> — tha dhe tundi kokën.

— *Vado, vado,*<sup>2)</sup> — ia ktheu Maksuti dhe eci drejt.

Tuti shikoi Çerrin dhe i shkeli syrin.

Çerri fërkoi duart me gjëzim dhe gati sa nuk fishkelleu nga qejfi.

Maksuti u vonua. Djemtë shikonin të shqetësuar derën e ofiqinës. Më në fund ajo u hap paksa dhe një dorë nxori një kuti të kaltër teneqeje dhe e la aty.

Tuti e kuptoi dhe, i lehtë e pa zhurmë si një mace, shkoi te dera, mori kutinë e kaltër dhe të dy me Çerrin u larguan me hapa të shpejtë.

— A thua do të jetë bojë e mirë? — e pyeti Çerri.

1) — Shko të punosh.

2) — Do shkoj, do shkoj.

— Speciale fare, — u përgjigj Tuti, megjithëse ende nuk e kishte parë.

Ecnin thua jse me vrap. Nganjëherë Tuti kthente kokën prapa për të parë se mos po i ndiqte italiani me mustaqe të holla; nga mënyra se si Maksuti e kishte nxjerrë kutinë, Tuti kishte kuptuar se ai e kishte bërë atë punë pa lejen e të huajit, që, siç dukej, ishte pronari i oficinës.

Sa zunë të zbrisnin bulevardit që të conte te porti, të dy djemtë panë se drejt tyre po vinin dy italianë. Ishin dy ushtarë të veshur me ato rrobat e tyre ngjyrë bari. Njëri, i trashë e faqekuq, e shikoi ngultas Tutin me ca sy që i ndritnin. Djali e kuptoi menjëherë se ai ishte çakërrqejf. Italiani qëndroi dhe e pyeti.

— Koza ç'e dentro? Vino?<sup>1)</sup>

Tuti ngriu në vend. U drojt se mos po ia merrte kutinë me bojë.

— No, no ... — tha ai dhe u mundua të largohej.

Ushtari u shkëput dhe zgjati duart për t'ia marrë kutinë. Tuti e térhoqi; nga vrulli e anoi dhe boja u derdh në tokë.

— Porko dio<sup>2)</sup>. . . — gjëmoi ushtari dhe u mat ta qëllonte me shqelm, por shoku tij e mbajti që mos të rrëzohej, se këmbët i lëkundeshin.

Italiani vazhdoi të shante, kurse shoku tij, një ushtari me fytyrë të qetë dhe të verdhë si një maskë dylli, e térhoqi prapa dhe e uli në një karrige të kafenesë «Lupo», që kishte nxjerrë tryezat në trotuar. Ai u lëshua në karrige i rëndë, duke mërmëritur diçka nëpër dhëmbë.

— Po ky ç'pati... — zuri të fliste Tuti, që ishte

1) — Çfarë ka brenda? Verë?

2) — Djalli e mori...

skuqur në fytyrë nga inati. — Breshkaxhiu i dreqit! Më derdhi bojën.

— Mos u mërzit, — i tha Çerri duke u munduar ta qetësonë; — pak është derdhur. Kutia është plot përsëri.

Tuti nuk foli. Nga millefi i dridhej buza e poshtme. Shikonte bojën e derdhur në trotuar dhe shante me dhëmbë të shtrënguar.

— Eja të ikim, — tha Çerri i trembur se mos Tuti bënte ndonjë të pabërë. Ai nuk e kishte parë kurrë shokun aq të inatosur.

— Mbaje kutinë, — tha Tuti dhe futi dorën në xhep.

— C'do të bësh? — tha Çerri dhe mori kutinë.

— Hiç, hiç . . . Ti shko më prit atje në fund të rrugës. Unë kam pak punë me këtë derrin veshur me rroba ushtari.

— Dëgjo, Tut, më mirë . . .


— Ik or po të them. Ec, teru!

**Çerri bëri disa hapa të drojtur. Ktheu kokën. Pa Tuttin që nxori diçka nga xhepi. Ishte një monedhë bakri që fekste. Dukej tamam si një flori. Në një cep monedha kallpe ishte e shpuar dhe te ajo vrima e vogël ishte një pe i bardhë, i gjatë.**

Tuti shpërdrodhi fijen dhe iu afrua kafenesë. Italiani i trashë, fytyrëkuq rrinte në një karrige në cep të kafenesë. Tuti u afrua, u fsheh pas një tryeze, madje u struk shumë, dhe me kujdes e hodhi monedhën kallpe afër italianit të ngallur.

Priti. Italiani dëgjoi një zhurmë, por në fillim nuk e vuri re monedhën. Pas disa çaste ai ktheu kokën dhe e pa atë. Nuk i tha gjë shokut, por zgjati këmbën që ta afronte pranë vetes dhe mos t'i binte kujt në sy.

Kur këmbla e tij iu afrua monedhës, Tuti tërhoqi perin e bardhë. Monedha u largua. Italiani pandehu se e



kishte zënë me këmbë. Uli sytë përtokë. Pa që monedha ishte larg. Bëri sikur u shtri dhe e zgjati këmbën. Shoku tij e vuri re dhe diçka i tha. Ai u përgjigj se nuk kishte gjë, po zgjatej që të rrinte më rehat.

Qëndroi disa çaste ashtu, pastaj prapë e zgjati këmbën. Porsa kjo u gjend afër monedhës kallpe, Tuti e tërroqi perin dhe e largoi më shumë monedhën.

Italiani, që kësaj here pandehu se ia kishte arritur qëllimit, uli prapë sytë dhe nuk i besoi asaj që pa: monedha ishte larg.

Një kamerier kaloi pranë tryezës ku rrinte i fshehur Tuti. Ky u struk edhe më shumë dhe ai nuk e vuri re.

Nga brenda lokalit vinte një zë i çjerrë gruaje që kendonte. Në rrugë u dëgjua uturima e një kamioni, pas kësaj troku i një kali, që tërhiqte një karrocë të zezë.

Tuti rrinte gjithnjë aty dhe kënaqej me lojën që po i punone italianit të ngjallur e faqekuq.

Ushtari i huaj shfryu dhe u orvat edhe një herë të kapte monedhën.

Edhe kësaj here përsëri të njëjtin marifet. Italiani, duke dashur të shtrihej edhe më, humbi drejtpeshimin dhe ra në tokë sa gjatë gjërë.

Shoku tij u tremb dhe u ngrit në këmbë. I rrëzuari zgjati duart nga monedha. Tuti tërroqi perin. Italiani zuri të ecte këmbadorës që ta kapte. Djali e tërhiqte vazhdimisht. Më në fund e mblohti perin me shpejtësi, u ngrit dhe ia mbathi më të katra drejt vendit ku e priste Çerri. Dëgjoi prapa zérin si të përgjumur të italianit që shante.

— Erdhe? — tha Çerri i shqetësuar, dhe u çudit kur e pa Tutin që vinte drejt tij fytyrëqeshur.

— Lëre si vajti, — tha Tuti dhe qeshi.

— Pash nderin, çfarë i bëre? — iu lut Çerri.

— Ia mora hakun njëqind fish, — tha Tuti. — Mua tē ma punonte breshka e dreqit!?

Dhe zuri t'ia tregonte ngjarjen Çerrit fill e pér pe. Tē dy qeshën me tē madhe dhe gazi i tyre ushtonte deri larg.

— Do tē shkojmë te barka tani? — pyeti Çerri.

— Po. Prandaj e morëm edhe bojën.

— Mirë, — tha i vogli dhe qëndroi; — po ne nuk kemi furçë. Me çfarë do ta lyejmë?

Edhe Tuti qëndroi. Ngriti pantallonat, që i mbante tē lidhura me një spango, dhe tha:

— Mirë e ke ti. Dëgjo, Çerr, pa mendohu një herë mos ke ndonjë copë furçë në shtëpi.

Çerri heshti dhe pas pak tha duke e ngritur zërin:

— Më duket se është një furçë e vjetër, që e kanë lënë pér tē lyer varret me gëlqere. Po nuk e din a bën, mor Tut!

— Do tē bëjë patjetër. Eja tē shkojmë ta marrim.

U kthyen nga rruga. Ngjitën kodrën. Bënte vapë dhe nga deti frynte një afsh i ngrohtë. Gjethet e pemëve nuk lëviznin fare. Dëgjoheshin gjinkallat që këndonin pareshtur, tē fshehura diku në mes tē barit tē kodrës.

— Po tē pres këtu, — tha Tuti, kur arritën te shtëpia e Çerrit.

Ky u fut brenda. Atë çast, e ëma po dilte me një govatë në dorë. Ajo diçka i foli djalit. Çerri qëndroi pak, pastaj eci prapë me hap tē shpejtë.

— Çfarë bëni, mor djem? — i tha ajo Tudit.

— Si je, nëna e Çerrit? — tha djali dhe doli përpara që tē fshihte kutinë e bojës.

— Çfarë bëni kështu? Djali hyn e del dhe asgjë nuk na thotë.

— Kot, moj nënë, kot, për nder të familjes. Hiç fare, luajmë dhe asgjë tjetër.

— Mirë, mirë, luan, po mos bëni gjë me zarar.

— Rri e qetë ti. Ne vetëm luajmë. Lojërat për fëmi-jët janë, thotë xhaxhai im.

Gruaja u largua me govatën në dorë. Ajo zbriti nëpër një shteg të ngushtë, që të conte te çesma.

Çerri u kthyte me një furçë të vjetër, të gjerë e të gjatë në dorë.

— Kjo është, — tha ai duke ia treguar shokut. — Si thua, bën, apo jo?

— E re nuk qenka, megjithatë diçka do të bëjmë me të.

Duke zbritur nëpër rrugën e pjerrët që të conte në Currilat, Çerri tha:

— Ditën e parë patëm vendosur që të mendonim për emrin e barkës. Tani ajo gati po mbaron dhe ne nuk i kemi vënë ende emrin.

— Mirë e ke ti, Çerr. Unë them t'ia vëmë Shigjeta. Si të duket?

— Çka. Nuk është dhe aq i keq, por duhet një emër më i fortë. Po sikur ta quajmë Rrufeja?

Tuti e përsëriti atë emër dhe ngriti supet.

— Nejse, të dëgjojmë çfarë do të thonë edhe të tjerrët.


Mu në hyrje të Currilave ata takuan Lapin, që me thesin në 'krah mbledhur gjë, apo jo? — e pyeti Tuti.

Dy djemtë iu afroan.

— Si je, o Lap? Ke mbledhur gjë, apo jo? — e pyeti Tuti.

Burri i shikoi një çast, tundi kokën dhe tha:

— Pak, shumë pak. Deti është i pasur, po nuk të



jep gjë. Kjo dihet, edhe njeriu sa më i pasur të jetë, aq më koprac është.

Djemtë miratuan përgjigjen e Lapit dhe vunë buzët në gaz.

— Po ju ç'bëni këtej? — i pyeti Lapi dhe picërroi sytë.

— Kot, po shkojmë të lahem, — tha Tuti.

— Sot bën shumë vapë, — shtoi Çerri.

— Mirë bëni, — tha Lapi. — Fundi i fundit të lallesh është nga të paktat gjëra që nuk kushton para.

Si tha këto fjalë Lapi u përkul dhe mori dy dërrasa të shtrembra të tkurrura nga qëndrimi i gjatë në ujë.

— Këto dërrasa mund të jenë të ndonjë anijeje italiane të fundosur.

Dy fëmijët e dëgjuan me dëshirë. U bënte përshtypje ai burrë pa shkollë, që dinte të fliste aq me kripë. Thoshin se kishte një barrë fëmijë dhe mezi i ushqente. Kur nuk kishte qëndruar në ndonjë punë; sillej andej-këtej, herë e merrnin në punë, pastaj e largonin, se ai tallej dhe përqeshte pronarin ose njerëzit e tij. Tani kishte më se dy vjet që nuk e pranonin askund. Ai endej bregut të detit që nga Currilat e deri në plazh, mblidhët mbeturinat dhe pastaj i shiste ose i shkëmbente ato me ndonjë copë bukë. Drutë e dërrasat ia çonte një furretari të lagjes së tij dhe ky i jepte ndonjë bukë sa për të mbajtur fëmijët gjallë.

— A të bien në qafë italianët? — pyeti Çerri.

— Edhe më bien, mor çun, — ia ktheu Lapi dhe kroi xhepat prej nga nxori pak pluhur duhani, që e mbështolli me një copë gazetë. — Ata atë punë kanë. Mua më tra zojnë, por ka të tjerë që po u punojnë atyre qindin.

Thithi me vështirësi cigaren, që e mbante në mes të gishtërinjve të trashë.

— Më vjen i hidhur duhani, — tha, — se e kam dre-  
dhur me gazetën Tomori. Po, me këtë gazetë e dredh,  
dhe të gjitha fjalët e «bukura» të fashistëve, gjithë premtimet e tyre, gjithë të ashtuquajturat fitore bëhen tym  
dhe i merr era...

Dy djemtë kishin dëshirë të rrinin më gjatë me Lapin, por vunë re se ai donte të vazhdonte punën; po edhe atyre nuk u durohej sa të provonin bojën te barka e tyre.

— Ikëm, Lap. Hapt, mirupafshim, — tha Tuti dhe mori kutinë e bojës, që e kishte lënë mbi rërën e bardhë të bregut.

— Shkoni, mor çuna, dhe lahuni, lahuni, se, si ju thashë, është një gjë që nuk kushton para. A dini not?

— Si nuk dimë? — tha Çerri.

— E mirë, duhet të dini not, se ndryshe mbyteni. Një ditë pashë një bej nga Elbasani që po rrinte në breg. «Pse nuk futesh thellë?» — e pyeta. «Nuk di not», — tha ai. «Futu, — i thashë unë, — shko thellë, se nuk mbytesh. Deti gjërat e lehta dhe boshe i mban në sipërfaqe». Hapt, mirë vofshi!

Para shkëmbit të tyre, Tuti e Çerri panë një djalë të ri, rreth nja shtatëmbëdhjetë vjeç, që rrinte ulur në breg me një libër në duar. Dy djemtë u shikuan në sy dhe ngadalësuan hapat.

— Si jeni, mor djema? — tha djaloshi.

Tutit iu duk se diku e kishte parë atë fytyrë. Ishte një djalë me trup të bëshëm, me shpatulla të gjera katrore. Sytë e rrumbullakët e si të bardhë vështroninë ëmbël. Flökët e shkurtër e të verdhë i kishte të butë dhe era luante me ta.

— Nuk më njihni? Po ne bashkë jemi parë, — iu drejtua ai Tuti. Jam Iljazi, kushëriti i Korabit. Më njeh tani?

— Po, — tha Tuti dhe iu kujtua çdo gjë.

— Erdhët te barka juaj? — tha djaloshi duke hedhur sytë nga deti.

Ata nuk folën. U erdhi inat që Korabi i kishte treguar atij të fshehtën e tyre, kurse kishin vendosur që mos t'i thoshin askujt.

Iljazi sikur e kuptoi mendimin e tyre dhe tha:

— Isha te Tryeza dhe e pashë. Është barkë e mirë. Do të dalë gjë e bukur. Vetëm hapni sytë mos t'jua vjedhi kush. Unë jam nxënës në qytetëse dhe tanë që kam pushimet e verës, vij shpesh e lahem këtu. Duke notuar e pashë barkën tuaj. Tanë shkova e ndenja pak te shkëmbi dhe e vura re mirë.

Ai fliste me një zë të qetë dhe kishte një difekt të lehtë, që mezi vihej re: shkronjën «th» e shqiptonte me fyt, por ky difekt sikur i jepte më lezet të folurit të tij.

Djemtë, që në fillim sikur u prenë se u ishte zbuluar e fshehta, tanë u qetësan, se Iljazi dukej njeri i mirë dhe kishte vetinë që menjëherë zgjonte besim dhe përhapte një drithë të butë dashamirësie, që të bënte përvete.

— Sot gjetëm edhe bojë, — tha Çerri.

— Shumë mirë, — tha Iljazi; — barka duhet lyer. Atje do të shkoni tanë? — shtoi ai duke bërë me kokë nga shkëmbi.

— Po, — tha Tuti dhe zuri të zhvishej.

— Hajt se po vij edhe unë; apo nuk doni.

Dy djemtë e ndien vetën ngushtë. Pastaj Tuti tha:

— Hajde, po të duash. Po ne do punojmë.

— Kemi gjetur këtë furçë, — tha Çerri dhe ngriti dorën.

Pa folur, ata u futën në det. Zunë të notonin. Dy djemtë vunë re se Iljazi notonte shumë bukur dhe trupi i

tij rrëshqiste në ujë me lehtësi. Krahët e fuqishëm e çanin ujin dhe e tërhiqnin trupin përparrë.

Iljazi u ngjit i pari në shkëmb. I priti dy djemtë dhe u mori nga dorë kutinë dhe furçën. Paski gjetur bojë blu. Është e përshtatshme përbarkën tuaj.

Dy fëmijët shkuan menjëherë te barka. Ajo tashmë kishte marrë pamjen e saj të vërtetë.

— E çdo të bëni me këtë? — pyeti Iljazi.

— Do të shëtitim, — tha Çerri.

— Jo, jo, do të zëmë peshk. Kështu mund të ndihmojmë pak familjet tonë. Ne jemi katër shokë, por dy prej nesh punojnë dhe vijnë këtu vetëm pasditeve.

— E di, — tha Iljazi, — Korabi dhe Minai, apo jo?

— E njeh Minain? — pyeti Çerri.

— Si nuk e njoh? Kam folur disa herë me të. Është djalë i mirë dhe i zgjuar. Tani punon në fabrikë. Lodhet, se është i vogël, por do të mësojë shumë gjëra atje.

Djemtë e dëgjonin dhe i jepnin të drejtë. Edhe ata kishin vënë re ndryshime te Minai. Ai tani sikur ishte rritur, fliste më qetë dhe dukej i menduar. Atyre u bënte përshtypje sidomos mënyra se si ai i kuptonte disa gjëra, që ata vetë nuk i rroknin dot me mend, se si i shpjegonte disa ndodhi ose rrethana të jetës. Atyre u dukej se edhe gjuhën e kishte ndërruar dhe fliste ndryshe nga ata.

— Po babai i Korabit si u bë? — pyeti Tuti duke fërkuar me dorë furçën e vjetër.

— Keq, — tha Iljazi dhe tundi kokën. — Është i sëmurë rëndë. Nuk ka të holla të mjekohet as të ushqehet mirë. Kam dëgjuar të thonë se tuberkulozi është sëmundje për pasanikët, se duhet të hash mirë e të ushqehesh për ta mundur sëmundjen. Pastaj duhet edhe klimë e mirë, ajër

i pastër. Po ku t'i gjejë këto babai i Korabit? Ai është i varfér dhe të varférít vuajnë.

Dy djemtë dëgjonin me vëmendje dhe fjalët e thjeshta të Iljazit gjenin jehonë në zemërat e tyre të njoma. Nisën të punonin të heshtur. Furça nuk lyente mirë, me gjithatë ata përpinqeshin që ngjyra blu të përhapej mbi trupin e barkës.

Po tani armiqtë e të varférve dhe të të gjithë shqiptarëve të ndershëm nuk janë vetëm të pasurit, por edhe fashistët. Ata kanë pshtuar vendin dhe na kanë rrëmbyer lirinë. Por populli lufton. Ju keni dëgjuar për partizanët, apo jo?

— Posi, — tha Tuti dhe e ndërpren një çast punën.

— Daja im është partizan, — tha me mburrje Çerri.

— Kush është daja yt? — e pyeti Iljazi.

Çerri ia tregoi: ishte një fshatar nga Shënavlashi, që kishte shkuar në çetën e Pezës.

— Nuk luftohet vetëm në mal, po edhe në qytet; këtu luftojnë të gjithë, edhe të vegjlit.

Çerri tha:


— Sot Tuti ia punoi një ushtari italian, që na derdhi bojën.

Dhe zuri t'i tregonte ngjarjen e asaj paraditeje. Herë pas here, ndërhynte vetë Tuti, që e plotësonë ose shtonë diçka.

Iljazi qeshi me zë të lartë. Kishte një të qeshur të ciltër.

Në fund ai tha:

— Nuk është puna vetëm të tallimi më ta, por sidomos t'i luftojmë dhe t'i dëmtojmë, kuptoni? Ju vërtet jeni të vegjël, po edhe ju mund t'i luftoni fashistët. Çfarë mund të bëni? Po ja, t'u shponi gomat makinave, të këputni telat e telefonave, të ngjitni trakter dhe plot gjëra të tjera.



Dy fëmijët dëgjonin Iljazin gojëhapur. Atyre nuk u kishte shkuar kurrë mendja për këto gjëra.

— Me një fjalë, or djema, duhet bërë një luftë e organizuar. Kjo luftë sot zhvillohet anekënd Shqipërisë dhe atë e udhëheq Partia Komuniste Shqiptare. Keni dëgjuar ndonjëherë për Partinë?

Dhe, pa pritur përgjigjen, ai nisi t'u fliste atyre për Partinë.

Ata dëgjonin me dëshirë të zjarrtë dhe para syve sikur u hapeshin hapësira të gjera, si ato të detit pa kufi.

Pastaj Iljazi tha:

— Për këto do të flasim edhe më hollësish. Do të mblidhem i dhe do të bisedojmë. Do të vijnë edhe Minai, Korabi e plot moshatarë tuaj. Si thoni?

Dy djemtë pranuan me gjithë zemër.

— Dhe tani t'i përvishemi punës dhe të shohim çfarë mund të bëjmë me barkën tuaj.

Ai ia mori furçen Tutit dhe zuri të lyente faqet e bar-kës, duke bërë lëvizje të gjera me duart e tij.

## KREU I PESTË

— O Mina, sill koshin me duhan! — thirri usta Miti nga fundi i sallës së madhe. Zëri i tij i fuqishëm u ngrit mbi zukatjen e pandërprerë të makinave që grinin duhanin.

— Erdha, usta! — u përgjigj djali dhe mori koshin e madh, e vuri në shpinë dhe zuri të ekte nëpër sallën ku ndihej kundërmimi i rëndë dhe i ngrohtë i duhanit.

Teksa ekte, Minai ndjeu se i dhembnin supet. Kishte më se tri orë që mbante kosha të mëdhej me duhan dhe i conte te makina, e cila e grinte duhanin dhe e përtyponte me nofullat e saj të hekurta. Rrugës u takua me Fatin, një djalë hollak, me sy të mëdhenj, që po vinte përballë me koshin e zbrazur. Ai ishte më i gjatë se Minai, megjithëse me moshë mund të ishte një vit më i vogël. Fati ishte jetim dhe pa njeri. Jetonte fillikat në një barakë të vogël si stelë qeni, buzë kënetës. Minai vinte re ftyrën e tij të verdhë dhe barkun e madh, të dalë. «Vuan nga mala-rrja», i pati thënë usta Miti një ditë.

Minai i buzëqeshi Fatit dhe kaloi përtej.

— Derdhe në makinë, — tha plaku dhe shkundi nga rrobat e dalëboje pluhurin e verdhë të duhanit.

— Sa është ora, usta? — pyeti djali.

— Nëntë e gjysmë. Pse pyet, u lodhe?

— Pak.

Plaku nxori një cigare dhe e futi në gojë, nën mustaqet e tij të thinjura.

— Mirë, bëj pak pushim, shko atje në cep dhe rri. Vëtëm ruaju mos të të shohë Sabriu.

Në cepin e sallës së madhe ai gjeti të ulur nënë Mahmudijen, një grua e moshuar kjo, me trup të vogël, këmbë të shkurtra, me flokët e mbledhur kular, me sy të ashpër e gojë të shtrembër, që vazhdimisht lëvizte.

— Edhe ti erdhe këtu? — tha ajo duke u përtypur.

— Do rri pak, sa të marr frymë. Më dhembin supet.

Plaka nuk foli, vazhdoi të përtypej dhe e shikoi me sytë e saj të ashpër, që thellëruanin një shkëndijë mirësie, që i gjallëronte. Në fillim, Minai ishte trembur prej saj, por më vonë kishte kuptuar se ajo ishte grua e mirë, ishte e veja e një muratori, që kishte rënë nga skela e kishte vdekur në vend. Tani rriste fëmijët, që i kishte ende të vegjël, se ishte martuar vonë. Punonte shumë dhe fliste shumë pak.

— Po përtyp duhan? — e pyeti Minai.

— Farmak po përtyp, or djalë, farmak.

Megjithëse kishte gati një muaj që punonte aty, Minai ende nuk ishte mësuar me erën e rëndë të duhanit. Kur imbaronte punën, ai dilte me vrap jashtë dhe merrte frymë lirisht, me tërë mushkëritë. Sa herë kishte menduar: Po këta njerëz që kanë më shumë se pesëmbëdhjetë vjet që punojnë këtu, si e durojnë këtë erë dhe si janë në gjendje të bëjnë atë punë të rëndë, që atij ia merrte frymën dhjetë-dymbëdhjetë orë çdo ditë.

Në sallë u dëgjuan disa zëra grash. Njëra diçka tha dhe dy të tjera iu përgjigjën gati njëkohësisht. Pastaj buçiti zëri i fuqishëm i usta Mitit.

— Po çohesh? — tha Minai duke parë që plaka u

ngrit në këmbë duke shkundur përparësen e grisur në mes.

— Po shkoj në punë, — tha ajo duke u përtypur, — se mos vijë ai kukudhi...

Gruaja e moshuar u largua ngadalë, duke ecur me këmbët e saj të shkurtra. Ekte duke u përkundur lehtë dhe gjithnjë përtypje copën e duhanit në mes të dhëmbëve të verdhë e të rrallë.

Minai mbylli për një çast sytë. Mendoi për barkën. Tani e kishin lyer. U kishte mbetur vetëm të bënin dy lopata dhe pastaj çdo gjë do të ishte gati për lundrim. Ndoshtha këtë javë do të arrinin t'i kishin lopatat, me gjithëse nuk ishte punë e lehtë.

Në sallë ushtuan disa hapa të rëndë. Me zhurmën e hapave u përzien disa zëra burrash që flisnin njëherësh. Minai hapi sytë dhe mbajti vesh. E kuptoi menjëherë se diçka po ndodhë. Nuk ishin zëra punëtorësh, as hapat e rëndë nuk ishin të njerëzve të fabrikës.

U ngrit në këmbë. Hodhi sytë përreth. Nuk vuri re asgjë, doli nga cepi i sallës dhe bëri disa hapa. Nga një derë pa dy milicë të veshur me të zeza dhe një oficer me revolver në dorë. Djali shtangu dhe zemra i ndolli të keqe. Pas oficerit doli një punëtor i shkurtër. Minai e njuhu: ishte Maliqi. Kishte biseduar disa herë me të. E njihet si djalë të zgjuar e triu. Nja dy herë Minai kishte bërë rrugën me Maliqin nga fabrika në shtëpi; ai banonte para se të arrije në Stan.

Oficeri thirri me zë të lartë dhe dy milicët e zunë për krahësh Maliqin, që dukej i qetë, sikur nuk po ndodhët asgjë e jashtëzakonshme.

Ata ecën në hapësirën që ishte në mes të sallës së madhe. Maliqi i kishte duart të lidhura. Milicët imbanin gati pushkët e tyre të shiurtra. Pas makinave, arkat e thasëve

me duhan dukeshin koka grash, fëmijësh dhe punëtorësh të tjerë. Usta Miti kishte shtangur në vend dhe shtrëngonte me duar kasketën e bërë shuk.

Vetëm Minai bëri dy hapa para. Vuri re milicët, që kaluan para tij me këpucët e rënda, që rrithnin dyshemënë, dhe me pushkët e shtrënguara në duar. Pastaj pa Maliqin që ecte i qetë, madje iu duk se cepat e buzëve ishin të ngritura lart dhe ravijëzonin një buzagaz të lehtë. Ai ktheu kokën. Sytë e tyre u ndeshën. Djali pa sytë e burkur, në formë bajameje, të gjallë e të depërtueshëm të punëtorit. Papritmas ky sikur e ndali një çast hapin, i bëri shenjë me sy Minait, pastaj vazhdoi rrugën, ashtu i lidhur, në mes të milicëve dhe oficerit me revolver në dorë.

— E morën djalin! — tha pranë Minait një grua.

Ai ktheu kokën për të parë kush foli. Ishte shumë i tronditur nga ajo skenë. E donte fort Maliqin dhe në ato pak raste që kishte ndenjur me të ai i kishte hyrë në zemër.

Solli ndër mend fytyrën e tij të rrumbullakët, me ata sy të pastër, të qeshurën e tij të çiltër dhe stërdhëmbin në anën e majtë të gojës, që i jepte lezet.

Djali ndjeu mbi sup një dorë. Ngriti kokën: ishte Peçi, shoku i ngushtë i Maliqit. E shikoi. Punëtori ishte i qetë, megjithëse i ngrysur në fytyrë.

— Dëgjo, Mina... — zuri të fliste Peçi dhe e mori me vete.

U larguan paq. Peçi hodhi sytë përreth dhe i tha më zë të ulët:

— E di shtëpinë e Maliqit?

— E di.

— Duhet të shkosh atje dhe t'i thuash nënës ose motrës që të fshehin ose të zhdukin çdo gjë të dyshimtë që mund të jetë aty.

— Kuptova.

— Fashistët me siguri do të shkojnë në shtëpi për kontroll. Prandaj të zhdukin çdo gjurmë. Pa dëgjo, duhet të fluturosh që t'i lajmërosh sa më parë.

— Po si të largohem? — tha Minai.

Peçi u mendua një çast. Pastaj tha:

— Mos dil nga hyrja, se do të të pengojë roja. Më mirë dil këtej prapa dhe hidhu nga muri. Po të kërkuan, do të disedoj unë me usta Mitin që të thotë se të ka dërguar diku me punë. Nisu tani. Hap sytë rrugës. Po gjete njeri në shtëpi, mos u thuaj para tyre, por merre nënën osë motrën mënjanë.

Peçi u largua. Minai, duke vështruar anash që të mos binte në sy, doli nga salla jashtë. Në oborr kishte njerëz, që shkonin e vinin. Ai u largua pa zhurmë në drejtë murit. Hodhi sytë përreth. Askush nuk e kishte mendjen te ai. Mori vrull dhe u kacavar në mur. I dha trupit dhe u gjend në majë të murit E kapërceu dhe u gjend në tokë.

— Cfarë bën, or çun? — dëgjoi një zë aty afër.


Minai u ngrit në këmbë dhe shkoi andej nga erdhizëri. Ishte karrocieri i plehërave, që mbledhët mbeturinat rreth fabrikës.

E shikoi burrin dhe nuk iu përgjigj.

Rregulloi këmishën, që i kishte dalë jashtë, dhe me vrap u nis drejt shtëpisë së Maliqit.

Rrugës ai nuk shikonte fare as djathtas as majtas. Duhej të arrinte sa më parë në shtëpinë e Maliqit dhe të plotësonte porosinë e Peçit. Iu duk se në atë mënyrë po ndihmonte Maliqin, po shprehte në një farë mënyre dashurinë që kishte për të.

Porsa kaloi qendrën, pa para tij dy milicë me pushkë krahëve. Iu duk sikur njëri e shkoi me inat. Minai nga-



dalësoi hapin. Pse e kishte parë ashtu ai milici? Mos dinte gjë? Apo kishin dyshuar.

Milicët kaluan në punë të tyre dhe ai vazhdoi rrugën. «U trembe? — i tha vetes. — Ama trim i madh je, o Minë!» — shtoi dhe tundi kokën. Ishte hera e parë që kryente një detyrë të tillë dhe se si i vinte.

Tek ecte rrugës, i vinte në mend Maliqi dhe nuk i hiqej nga sytë ajo lëvizje që bëri kur kaloi me duar të lidhura para tij.

Qëndroi para hyrjes së shtëpisë së Maliqit. Kishte ecur gati me vrap dhe i merrej fryma. Rregulloi këmishën cë i dilte përherë sipër pantallonave, se ishte e shkurtër, dhe u shty drejt portës.

Ishte një portë e vjetër, e madhe, me një strehë guri përsipër. Në krahun e djathtë kishte një dorezë hekuri të zi. Ai e zuri dhe trokiti tri herë.

Priti.

Nga brenda nuk ndihej asnjë zhurmë.

Trokiti prapë, Kësaj here më fort.

Në oborr u dëgjua trokitja e nallëneve, që përplase-shin nëpër guraçokët e kaldrëmit.

U hap dera. Pas saj u duk fytyra e bardhë e një vaze.

— Cilin kërkoni? — pyeti ajo duke e shikuar e habitur.

— Ju jeni motra e Maliqit? — e pyeti Minai; ai vuri re se fytyra e saj gjasonte me atë të Maliqit.

— Si është puna? — pyeti ajo me një zë të ëmbël dhe të ulët.

— Unë punoj në Stamles... — zuri të fliste Minai dhe i ngeci fjala në grykë. Si t'ia thoshte?

U bë heshtje. Vajza vazhdonte ta shikonte me sytë e saj të kthjellët.

— Më çoi Peçi... Më tha që të fshihni ose të zhdukni cdo gjë të Malikit që është e dyshimtë... Kshtu më tha...

— Pse? — tha vajza dhe u ngrys në fytyrë. — Ç'i ka ndodhur Maligit?

Po tani? Ç'ti përgjigjej? Nuk kishte kuptim t'ia fshih-te c'kishte ndodhur, se ajo do ta merre yesh.

— Po, ja, Maliqin e morën dy milicë dhe një oficer fashist... Ndoshta e morën vetëm për ta pyetur, ndoshta...

Ajo mbyti një klithmë të shkurtër duke vënë dorën përparrë gojës.

— Uné po iki... — tha pas pak Minai. — T'i them  
gje Pecit?

Vajza nuk foli. Vazhdonte ta mbante dorën para go-  
jës.

Minai u kthyje ngadalë dhe zuri të ecet me hapa të rendë. Zemra i shtrëngohenj dhe ndjeu se iu përlotën cepat e syve. Mblodhi grushtat brenda xhepave.

— Was spoken to little George. — I told him that he had to go to school, because the teacher said so.

**Diese Lieder sind nur Vorschläge für die Verwendung.**

de T. Ortiz que Górriz TS mejoró tanto como el de la mitad de su edad.

Die Gesellschaften müssen nun wissen ob es gelingt die Zulassungen zu erhalten.

— Do it before you do it — Do it before you do it — Do it before you do it —

## KREU I GJASHTE

— Tani shpërndahuni, — tha Iljazi dhe u ngrit në këmbë. Fëmijët nuk lëvizën. Rrinin gjithnjë të mbledhur në gjysmë trethi atje në cep të fushës, që quhej «Fusha e Baltës».

Ishte errur dhe në qielin e kaltër të korrikut ishin ndezur yjet. Ishin yje të mëdhenj, të ndritshëm. Nga deti fryne një erë e vakët, e njelmtë.

— Ngrihuni, — tha prapë Iljazi dhe ndezi një cigarc.

— U morëm vesh për sa thamë, apo jo?

Djemtë pohuan me zë të ulët. Në port u dëgjua sirenë e çjerrë e një vaporë, që po hynte në gjirin e qetë dhe po u afrohej bankinave. Në qytet ishin ndezur dritat.

— Mos shkoni të gjithë grumbull. Largohuni nga dy e nga trc. Jo më shumë.

Disa lëvizën nga vendi dhe u nisën në drejtim të qytetit. Minai ishte pranë Korabit dhe dy shokëve të tjerrë, Tudit dhe Çerrit. Të katër ishin caktuar në grupin që të nesërmën mbrëma do të digje parullën «Vinçeremo» atje te Vila. Bashkë me ta ishin dhe tre të tjerrë.

— E kuptuat planin? — i tha Iljazi duke thithur cigaren. — Do të takohemi në orën tetë para shtëpisë së Çerrit. Mos të vini të gjithë nga një rrugë, por nga anë të ndryshme, pëtë të mos rënë në sy.

Ngriti me dorën e djathtë një tufë flokësh që ia shtynte era e vakët që frynte nga deti.

Katër djemtë bënë një copë rrugë bashkë me Iljazin. Kishte qenë mbledhja e parë që merrnin pjesë dhe tanë e ndienin veten më të rritur dhe të ngarkuar me punë të rëndësishme.

— Nuk është nevojë t'ju porosit më për të ruajtur të fshehtën, — tha Iljazi me zë të qetë dhe prapë Minai vuri re atë difektin që kishte në shqiptim. — Punët e luftës duan fshehtësi të madhe. Asnjë fjalë, asnjeriu.

Minai deshi ta pyeste. Po vëllait, a mund t'i them? Por u pendua dhe nuk e hapi gojën. Sa dëshirë kishte që Sotiri ta binte se ai nuk ishte më i vogël, por bënte pjesë në grupin e pionierëve dhe do të merrte pjesë në një aksion të rëndësishëm.

Në hyrje të qytetit ata u ndanë. Iljazi iku me Tutin, se diku andej nga lagjja e tij e kishte edhe ai shtëpinë. Çerri bëri edhe disa hapa, pastaj mori rrugën e bulevardit pasi u tha shokëve: — Vdekje fashizmit!

Ata e shikuan buzagaz. Ai ishte i pari prej tyre që po përdorte parullën që u kishte mësuar Iljazi në mbledhje.

Dy djemtë vazhduan rrugën. Në fillim ecën të heshtur. Shikonin rrugët me drita, kalimtarët, koka njerëzish që shfaqeshin nëpër dritaret e hapura.

Një makinë ushtarake ishte ndalur para një pijetore. Dy djemtë ngadalësuan hapat.

— Po sikur... — tha Korabi.

— Çfarë? — e pyeti Minai.

— Sikur t'ia shpojmë gomat? Të kujtohet si na tha Iljazi?

— Mirë thua.

Hodhën sytë në tokë. Kërkonin ndonjë gozhdë ose tel. Më në fund Korabi thirri:



— E gjeta një gozhdë. —

Porsa e ngriti nga toka, dera e pijetores u hap dhe dolën dy ushtarë që këndonin. Kapat i kishin hedhur gati mbi zverk.

— Ta hajë dreqi! — shau Korabi. — Dolën pipinot!

Ushtarët hapën derën e kabinës dhe hynë brenda. Teksa pa ndiznin motorin, Korabi u afrua me të shpejtë dhe ia nguli gozhdën gomës së prapme. Makina luajti nga vendi...

Ata vazhduan rrugën. Ishin ngritur shpejt në mëngjes dhe puna e rëndë e ditës i kishte lodhur. Korabi punonë në port dhe atje sfilitej.

Minai e pyeti për babanë. Ai u përgjigj se ishte gjithnjë rëndë. E pyeti edhe për punën. Korabi i tregoi çfarë bënte atje në port. I tha edhe çfarë shikonte, për vaporët që vinin e shkonin pareshtur.

— Sa qejf kam të lundroj me anije! — tha Minai. — Nuk ka gjë më të bukur se të lundrosh në det. Po të kisha mundësi, do të bëhesha marinar...

Vazhduan të ecnin e të flisnin për detin, për udhëtimet. Pastaj folën edhe për barkën e tyre. Ende nuk kishin gjetur lopatat.

— Tuti më tha pas mbledhjes se te ajo parulla e fashistëve janë disa shtylla, që vlejnë për të bërë lopatat e barkës, — tha Korabi. — Siç duket, ai ka menduar ndonjë plan.

— Atij gjithnjë i punon mendja, — u përgjigj Minai, — po ne atje do të shkojmë për të djegure jo për të marrë binarë.

Minain e kishte marrë malli të rrinte me Korabin, pasi shiheshin rrallë. E përcollti deri afër shtëpisë. Para se të arrinin aty, u ulën te gardhi i një barakeje. Aty ishte qetësi dhe dëgjoheshin vetëm bulkthit.

— Edhe në Stan ka shumë bulkthe, — tha Minai.  
— Kudo ka, — tha Korabi.

Heshtën. Mbanin vesh zërin e bulktheve nën kupën e kaltër të qiellit të korrikut. të mbushur me yje të ndritshëm.

Ajo ditë do të mbetej e paharuar për ta. Gjithë jetën do ta kujtonin me tërë hollësitë e saj. Kështu ndodh në jetë. Ka dhjetëra ditë, ndoshta edhe qindra, që kalojnë pa lënë gjurmë dhe është vështirë t'i dallosh nga njëra-tjetra, por ka ditë që mbeten të pashlyeshme, si ajo kur ato ishin pranuar në grupin e pionierëve të qytetit dhe, të udhëhequr nga komunistët, do të nisnin luftën kundër fashistëve.

Zunë prapë të bisedonin. Kalonin nga një temë në tjetrën me lehtësi. Ishin të lodhur, por gjumë atë natë nuk kishin,

Ndenjën aty pothuajse një orë. Ndoshta edhe më shumë.

I pari u ngrit Korabi.

— Tani të ndahemi. Nëna ime bëhet merak. Po nëna jote?

— Edhe ajo. S'ka nënë që të mos shqetësohet. Megjithatë, ajo më shumë metakoset për vëllanë. Natën e mirë, Korab.

— Natën e mirë.

U ndanë dhe secili mori rrugën e shtëpisë.

Tek hynte në oborrin e ngushtë të shtëpisë së vet, Minai dëgjoi prapa tij një hap të rëndë. Qëndroi dhe ktheu kokën. Atë çast një zë i trashë gruaje i tha:

— Si u ngryse, o çuni i Vasilit?

Ishte Athinaja, vejushja e ngjallur. Ajo mbante më dorë një bohçe të madhe.

— Mirë, si u ngryse, nënë Athina?

— Mirë, or çun, mirë duhet thënë...

Ajo pshëretiu, mori frymë thellë dhe tha:

— Isha te shtëpia e Myzafer agait dhe mora plaçka për t'i larë. Nuk më del, or çun, rroga që marr në Stamles. Kam për të ushqyer pesë gojë, që presin nga duart c mia. Po ti nga ishe?

— Hiç, ashtu kot, me disa shokë.

— Mos u sill rrugëve natën. Kanë ardhur kohë të këqija, mor djalë. Futu, futu në shtëpi, se do të jetë bëre merak Ura.

— Po ti? — e pyeti djali.

— Po rri edhe pak të marr frymë. Kam një dhembje këtu në ije, që ma mori frymën. Shko, shko ti, natën e mirë.

Pa hapur mirë derën, ai dëgjoi kollën e babait. Nëna, gati thirri:

— Ku je, mor bir, që humbe fare?

Sa u mat të përgjigjej, iu shkreh i ati:

— Dëgjo ti, të jetë hera e fundit që më vjen kaq vonë, kuptove? Të kam thënë që të vish shpejt. Nga rri e më bredh zotrote? Mirë ai i madhi, por fillove edhe ti? Dëgjo, unë...

Kolla nuk e la të vazhdonte. Gati i dolën lot prej syve. Nëna e shikoi djalin me qërtim dhe atij i erdhë keq për babanë.

— Më fal... — tha Minai me gjysmë zëri dhe nisi të largohej.

Hapi derën e kthinës ku flinte.

— Prit të hash darkë, — tha nëna.

— Pa ngrënë të shkojë, se ashtu e meriton, — tha babai me zemërim. — Ku është parë që një djalë në moshë të tij të bredhë si mace natën.

Në kthinën e vogël ai u shtri në shtratin e fortë. Në dhomën e zjarrit u dëgjua përsëri kolla e babait. Ai e dinte se puna pranë zjarrit dhe ndryshimi i temperaturës kur dilte jashtë, ndikonin keq për astmën. Punë nuk kishte. Bëhej nevrik, se ishte mësuar gjithë jetën të punonte. Edhe shqetësimet që kishte për Sotirin ia shtonin mllfin.

Në dhomën tjetër kishte qetësi. Minai lidhi duart pas zverkut dhe ia nguli sytë tavanit të ulët dhe të nxirë. Kishin disa vjet që thoshin se do ta lyenin dhe prapë e linin ashtu, se nuk gjenin para për bojën. Në pranverë u kishte dhënë fjalën Jorgji që do t'ua lyente falas, por ai tani ishte në burg dhe tavani e dhoma kishin mbetur ashtu të nxirë.

Minai solli ndër mend ngjarjet e asaj dite. Iu kujtua sidomos mbledhja atje te Balta me Iljazin dhe aksioni që do të kryenin të nesërmën mbrëma.

U hap ngadalë dera e dhomës dhe nëna tha me zë të ulët:

— Të solla darkën. Ha dhe mos e mërzit më babanë.

— Po fle? — pyeti ai duke bërë me kokë nga dhoma e zjarrit.

— U shtri. Ti ha dhe fli. Nesër do të zgjohesh shpejt.

— Pastaj ajo shtoi si me vete. — Shumë po lodheni, mor djemtë e nënës!

Sa imbaroi darkën, Minai ndjeu që u hap dera. Hyri Sotiri. Minai gati sa nuk kërceu nga gjëzimi.

— Si je, mor kapetan? — e pyeti i vëllai, që e thërriste me atë emër që kurse kishte marrë vesh që Minait i pëlqente deti dhe donte të bëhej marinar.

— Ku ishe? — e pyeti Minai.

— Me ca shokë. Po ti, pse je vonuar sonte?

— Edhe unë me, ca shokë isha, — tha Minai, duke u përpjekur të imitonë të vëllanë.

Qeshën të dy. Sotiri i bëri me shenjë mos të bënte zhurmë, se shqetësohej babai.

U ul në shtrat. Hodhi kasketën me strehën e rrudhur dhe psherëtiu. Minai rrinte në këmbë dhe e shikonte. Sotiri nuk ishte i gjatë, por kishte trup të ngjeshur. Kishte bërë shumë not kur kishte qenë i vogël dhe thoshte shpesh se trupin e kishte nga noti. Flokët i mbante të kre-hur me kujdes. Minai vuri re vijën e kasketës që i dukej rreth kokës dhe që i kishte lënë një vragë te lëkura e ballit. Thoshin se ngjanin të dy dhe se kuptohej menjëherë që ishin vëllezër.

— Si ju shkoi mbledhja sonte? — e pyeti papritmas Sotiri.

— Çfarë mbledhje? — tha gjoja i shkujdesur Minai. Sotiri e shikoi me buzën në gaz.

— Domethënë konspiracion, hë? Mirë, shumë mirë. Eja këtu, kapedan!

Minai u afroa pranë të vëllait përmbi shtrat. Sotiri i hodhi krahun.

— Më tha Iljazi, — i foli ngadalë pranë veshit Sotiri. Djali u gjëzua. Domethënë Iljazi punonte bashkë me Sotirin.

— Po ti ku ishe sonte? — e pyeti Minai.

— Kisha punë.

— Çfarë pune?

Sotiri heshti një çast. E pa vëllanë buzagaz dhe tha:

— Punë të ndryshme.

Minai u prek. Hoqi krahun e vëllait nga supi dhe, pasi u ngrit në këmbë, tha:

— Ik, mor shok i keq, nuk më tregon. Sa mirë unë të tregova ty.

— Ti nuk më tregove asgjë. Unë e gjeta vetë. Eja tani, mos u zemëro. Të flemë, se nesër kemi punë. Edhe ju, edhe ne!...

## KREU I SHTATË

Ata zunë të ngjitnin kodrën e Vilës. Përpara ecte Iljazi me Minain, së bashku me një djalë flokëqethur, që quhej Sabahudin. Shkurt i thoshin Din.

Pas tyre vinte Korabi, Tuti dhe dy djem të tjerë. Korabi mbante në dorë një shkop, që e kishte gjetur rrugës dhe e kishte marrë duke menduar se kushedi mund t'u duhej.

Ishte errur qëkur. Në rrugën e përpjete lëviznin pak njerëz.

Dy teheqetë me benzinë i kishin lënë në shtëpinë e Çerrit. I kishin çuar aty Tuti me Dinin, duke ardhur nga rruga e kodrave përreth.

Kur arritën pranë shtëpisë së Çerrit, panë shokun e tyre që kishte dalë dhe po i priste.

Iljazi u tha të merrnin teneqetë. Tuti dhe Minai hynë në oborr bashkë me Çerrin.

— Ju shkoni e shikoni mos ka njeri andej nga Vineremoja, — porositi Iljazi Dinin dhe një djalë tjetër.

Nga oborri i shtëpisë u kthyen djemtë me dy teneqe të mëdha ndër duar.

— Ma jep ta mbaj edhe unë pak, — iu lut Çerri Minait.

Tuti pycti Iljazin nësc do të niseshin për te vendi.

— Të presim sa të kthehen zbuluesit, — tha Iljazi dhe vuri buzën në gaz. Edhe fëmijët e tjerë qeshën. Dukeshin të gjithë të qetë, megjithëse përbrenda ishin të shqetësuar, më shumë nga të gjithë Iljazi, por ai nuk e tregonte vreten fare dhe kjo gjë ndikonte te të tjerët.

Minai iu afrua Tutit:

— Dëgjo, më zuri veshi se ia ke vënë syrin nja dy binarëve të parullës.

— Kush të tha?

— Ç'ke ti, Dëgjo, mos bëj marrëzi. Ne jemi mbledhur të djegim parullën dhe asgjë tjetër. Ky është qëlli-mi ynë. As mos të të shkoj ndër mend të marrësh binarët, dëgjon?

— Po kot janë ata binarë, mor Mina. Në vend që të digjen, thashë t'i marr për barkën.

— Jo.

Tuti pëshpëriti diçka në mes të dhëmbëve.

U kthyen Dini me djalin tjetër.

— Aty nuk ka njeri, — njoftuan ata gati njëherësh.

— Atëherë të bëhemë gati.

Iljazi dha udhëzimet e fundit, duke i kujtar edhe një herë secilit detyrën që kishte.

Nisën të ecnin të heshtur dhe 'me kujdes. Tani shqetësimi vinte duke u shtuar. Ishte aksioni i tyre i parë dhe kjo gjë i bënte t'u rrihte zemra. Tek ecnin, Çerri u kollit.

— Mos bëj zhurmë, — tha Tuti që ishte afër tij.

— Nuk po i lë njerëzit as të kolliten! — tha Iljazi me shaka.

Pranë parullës ata qëndruan. Pas pak Minai 'dhc Dini morën teneqetë me benzinë.

— Filloni! — urdhëroi Iljazi.

Dy djemtë u shpërndanë me shkathtësi në të dy anët

e parullës së gjatë dhe e lagën me benzinë.

Korabi me Çerrin bënин roje. Tuti me Iljazin mbanin gati shkrepëset që të jepnin flakë në të dy anët për të shpejtuar djegien.

— Gati? — pyeti Iljazi.

— Unë mbarova, tha Minai dhe shkoi pranë tij.

— Edhe unë, — tha pas pak Dini.

— Eja, Tut, se tanë e kemi radhën ne.

Iljazi mbajti vesh mos dëgjonte gjë sinjalin e rojeve. Prej andej nuk vinte asnjë zhurmë. Rruga e Vilës ishte e qetë.

Tuti shkoi në anën e vet dhe nxori kutinë e shkrepëses. Mori një fije dhe e afroi te kutia. Atë çast u dëgjua fishkëllima e dy rojeve. Gati njëkohësisht ata panë dritat e një makine që ngjitej në kodër.

— Fshihuni, — urdhëroi Iljazi.

Tuti u fut në një kaçube. Ndjeu se ferrat i çorën këmbët. Shau në mes të dhëmbëve dhe ndenji aty,

U dukën dritat e fortë që rrëshqitën në faqën e kodrës në mes të pemëve e të ferrave.

— Prisni edhe pak, — tha Iljazi, — të largohet mirë.

Panë dritat që kaluan në pjesën e sipërme të kodrës.

Dëgjuan gulçimën e motorit.

Iljazi dha urdhër të bëhej djegia. Tuti e nxori dhe një herë kutinë, fërkoi te ajo fijen dhe pasi u ndez flaka e vogël, ia afroi atë parullës së madhe prej dërrase. Po ashtu bëri edhe Iljazi.

Në çast u ndez flaka në të dy anët e parullës.

— Tani të tërhoqemi, — tha Iljazi dhe të gjithë u larguan.

Tuti bëri disa hapa, pastaj qëndroi dhe ktheu kokën. Flaka ishte rritur dhe ndriçonte krejt vendin përreth.

Papritmas u dëgjua fishkëllima e një bilbili. Asaj iu përgjigj një bilbil tjeter nga ana e poshtme e kodrës. Pas kësaj ushtuan disa zëra njerëzish që flisnin së bashku.

— Patrullat fashiste! — tha Iljazi dhe i urdhëroi shpejt djemtë që të zbrisnin në drejtim të shtëpisë së Çerrit.

— Na pri në shtëpinë tënde, — i thà djalit.

Djemtë nisën të ecnin pas Çerrit. Në fund qëndroi Iljazi, që nxori revolverin dhe i hoqi sigurecën.

Zallahia e rojeve fashiste erdhi duke u shtuar. Ata thërrisin, u frynin bilbilavë, madje njëri prej tyre që lloji dy herë në ajër.

Krismat e shqetësuan Iljazin. Ai përgjigjej para shokëve të Partisë për jetën e fëmijëve. Bëri llogari me mend nëse do të arrinin dot deri te shtëpia e Çerrit pa rënë në sy të rojeve. Rruga që do të bënin ishte e shkurtër dhe kjo e ngrohu. Duke ecur pas fëmijëve, i shkrepit një mendim tjetër. Me siguri fashistët do të kontrollonin vendin përreth; patjetër do të hynin edhe në shtëpinë e vogël. Tek ecte, ai kthente kokën për të parë se mos i kishin diktyuar rojet. Atë çast pa edhe flakët që ishin ngritur në qiell. Parulla po bëhej shkrumb e hi dhe aksioni kishte përfunduar me sukses. Përfunduar? Jo ende. Duhej që fëmijët të largoheshin patjetër pa pësuar asgjë. Vetëm atëherë ai do të merrte frymë lirisht.

Ata ecnin nëpër një shteg të ngushtë dhe të thelluar nga ujërat. Kjo gjë i bënte të mos binin në sy, pasi ecnin të përkulur.

— Kujdes, — porositi Iljazi kur mbaroi shtegu dhe për t'u futur në shtëpinë e Çerrit duhej të kalonin rrugën.

Çerri qëndroi. Priti shokët.

— Po dal unë përpara, — tha Minai dhe, pa pritur përgjigje, kaloi tre të tjerët që ishin para tij, kaloi rrugën i përkultur dhe hyri në oborrin e Çerrit duke kapërcyer gardhin. Pas atij dëgjoi disa kërcime dhe pas pak të gjithë fëmijët u ndodhën në oborr. Në fund erdhi Iljazi.

— Jeni të gjithë? — pyeti ai.

— Ta shikoj pak atë revolver, — tha Dini.

Atë çast Iljazi u kujtua se ende po e mbante në dorë armën.

— Më vonë, tani kemi halle të tjera, — tha Iljazi dhe, duke kthyer kokën andej nga flaka, tha: — Na e mori të keqen Vinçeremoja, shokë! Vepruat shumë mirë.

Në rrugë dëgjoheshin zëra dhe në qiellin e natës ushtuan përsëri krisma armësh. Pastaj, nga poshtë kodrës, jehoi uturima e një motori makine, që po ngjitej me shpejtësi.

— A ka ndonjë rrugë për të zbritur kodrën këtë nga ana e bregut? — pyeti Iljazi Çerrin.

— Është një shteg që vjen shumë i pjerrët. Unë kam zbritur disa herë ditën, por jo natën.

— Po nuk u larguan fashistët, andej do, të zbresim, — tha Iljazi. — Ju nuk keni frikë të zbrisni, apo jo, djema?

— Jo, — u përgjigjën njëherësh të gjithë. Atë çast u hap dera e shtëpisë. U duk babai i Çerrit. Pas tij nxori kokën nëna me vajzën e vogël në krah.

— Ti, Serafin, je? — pyeti Spiroja.

— Po, unë jam, u përgjigj Çerri. — Jam me disa shokë.

— Po ç'bëni aty? Atje lart ka zjarr dhe italianët po vijnë rrotull.

— Mos ju kërkojnë ju, mor djema? — pyeti nëna e Çerrit, e cila, ashtu si i shoqi, kishte kuptuar gjithçka.

Në rrugë u dëgjuan zëra. Ishin shumë afër. Disa thë-

rrisinin, të tjerët flisnin me zë të ulët. Ushtuan këmbë njerëzish. Ishin hapa të rënda që lëviznin pareshtur.

Iljazi u bëri me shenjë fëmijëve që të mos flisnin. Nga rruga një zë thirri italisht.

— *Entrate kui. Cerkate dapertuto.*<sup>1)</sup>

— Po vijnë këtu, — tha Iljazi, morën urdhrin të futen këtu dhe të kërkojnë. Nga të shkojmë? — iu drejtua Çerrit dhe babait të tij.

— Ejani pas meje, — tha Çerri.

— Rri ti, Serafin, tha nëna, — se ua tregon babai rrugën.

— Jo, jo, do të shkoj unë, — tha djali dhe kjo i habiti të gjithë, se nuk e prisnin pikërisht nga Çerri i vogël këtë veprim.

Ky eci vetë i pari dhe pas tij shkuan të tjerët. Iljazi shtrëngonte në dorë revolverin.

— Ku po na çon? — pyeti Tuti.

— Do të kalojmë këtej, nga varrezat.

— Nga varrezat? — tha një djalë që vinte pas Çerrit.

— Mos bëni zhurmë, — ndërhyri Minai, — punë e madhe se do të kalojmë andej.

— Shokù Iljaz, ec edhe ti, — tha Korabi, duke u kthyer prapa.

— Shkon ju, se unë ju arrij, — tha Iljazi me revolver në dorë.

Ecnin ngadalë dhe pa zhurmë. Të gjithë ishin pak të drojtur, pasi për varrezat kishin dëgjuar gjithfarë legjendash, duke misur që nga zërat që gjoja dëgjoheshin natën, dhe deri te zjarret që gjoja ndizeshin çdo natë në atë vend.

Brenda në varreza kishte errësirë. Aty binin hijet e

1) — Hyni këtu. Kërkoni gjithandej.

qiparisëve të lartë, ku lëviznin degët nga zogjtë që kalonin natën. Vetëm aty-këtu zbardhte ndonjë rrasë e ftohtë dhe e bardhë. Në këmbët e kodrës dëgjohej mërmëritja e pandërprerë e detit. Në qellin pa hënë ndriçonin yjet e ndritshëm të verës.

— Qëndroni! — tha Iljazi dhe mbajti vesh nga obo-ri i shtëpisë së Çerrit. Dëgjoheshin zëra dhe hapa njerëzish. Dikush fliste me zë të lartë dhe atij iu duk se dëgjoi zërin e babait të Çerrit që përgjigjej qetësisht.

Minai ishte ndalur pas një varri të bardhë, të ndërtuar me mermmer. Pranë tij ishte Korabi. Pa u kujtar, dy djemtë kishin, vënë duart mbi rrasën e ftohtë dhe dëgjonin.

— A të shkoj të shkoj njëherë ç'bëhet andej? — tha Çerri Iljazit, duke shkuar pranë tij.

— Nuk është nevoja, — u përgjigj djaloshi. — Nuk ma merr mendja të vijnë deri këtu fashistët. Nuk do t'u shkojë mendja se jemi fshehur pikërisht këtu.

Tuti tha:

— Thuaj më mirë që nuk ua mban të vijnë këtu, se iu venë shtatë, apo jo, mor shokë?

— Mirë thua!

— Fashistët e kanë lepurin në bark.

Iljazi i la të flisin, se kjo ndihmonte që ata të mposhtnin ndjenjën e frikës, që mund të kishin me që ndodheshin në varreza.

Kaluan disa minuta. Në oborr dëgjoheshin gjithmonë zëra dhe hapa. Në rrugën jashtë shtëpisë erdhën makina të tjera, në mes tyre edhe një makinë me sirenë, që, siç dukej, ishte e zjarrfikësve.

Pak nga pak në oborr u bë qetësi, Zhurma e hapave erdhi duke u shuar. Edhe flaka atje tej tanimë ishte shuar.

— Më duket se ikën, — tha Dini.

— Po shkoj të shikoj një herë, — tha Çerri dhe u nis në drejtëm të oborrit. Të tjerët e panë si ecte i sigurtë, pasi ai e njihte rrugën mirë.

U afroa te oborri pa zhurmë. Aty kishte qëtësi. Ai pa të atin dhe t'ëmën që kishin mbyllur derën dhe nxirrin Kokën te dritarjë.

— Ikën? — pyeti Çerri duke iu afroar dritares.

— Po, — tha i ati.

— Si jeni, mor Serafin? — foli e ëma.

— Mirë. Po shkoj të lajmëroj shokët.

Pas disa çastesh u mblodhën të gjithë në oborr. Iljazi përgëzoi edhe një herë për aksionin dhe u tha që ajo djegie do të bënte përshtypje të madhe në popull dhe do t'i tèrbonte fashistët. I porositi të zbrisnin nga kodra në drejtime të ndryshme. Pas disa ditësh ai do t'i njoftonte ku do të takoheshin përsëri.

— Tani natën e mirë. Vdekje fashizmit! — dhe ngri-  
ti grushtin.

Fëmijët iu përgjigjnë:

— Liri popullit!

Sikur ta kishin bërë me fjalë, katër shokët e barkës qëndruan pas të tjerëve.

— Nesër do të takohemi atje? — pyeti Tuti.

Korabi tha se ndoshta do të mungonte, pasi nuk mund ta linte babanë vetëm. Nëna punonte në shtëpinë e një pasaniku. Aty lante enët, pastronte dhe kthehej vonë.

— Mirë, Korab, ti ke të drejtë, — tha Minai. — Ne  
të tjerët takohemi atje pasdite. Shikoni pak mos gjeni dërrasa për lopatat.

— Ah, kur s'i mora ata binarët! — foli me keq-ardhje Tuti,

## KREU I TETË

Atë ditë në Currilat kishte më shumë njerëz. Ishte e diel. Edhe fëmijë kishte shumë. Ata zbrisnin nga kodrat, duke u ulur nga shtegu i quajtur Dymbëdhjetë Shkallët. Vinin të zbatbur, me këmishat hedhur krahëve. Një pjesë e djemve të Stanit shkonin të laheshin te «donamet», afër depove me karburant të Agipit, atje pranë Urës së Dajlanit. Aty ishin skafat e ndryshkura të dy luftanijeve të vjetra italiane apo austriake — nuk dihej me siguri — dhe fëmijëve u pëlqente ai vend i qetë, ku nuk vinin kurrë të rriturit as të huajt. Në plazh rrallë shihje fëmijë të Durçesit. Këta pëlqenin më shumë Currilat ose «donamet». Kishte nga ata që shkonin deri në Porto-Romano, në veri të qytetit, se atje ishte vend i bukur dhe zihej peshk më shumë.

Edhe Minai me shokët zakonisht shkonin në «donamet», por këtë verë kishin ardhur në Currilat për shkak të barkës.

Atë të diel të fillimit të korrikut ata ishin të katër të lirë dhe erdhën në Currilat që në mëngjes shpejt.

I fundit mbërriti Tuti. Ai mbante në krah një binar të vjetër.

— E solla për lopatën e barkës.

Të tjerët nuk folën. Ai vuri re shikimet e tyre dhe tha:

— Ma dha babai. E kishte lënë mënjanë, se mund t'i duhej. Ia kërkova, dhe ai nuk ma prishi.

— Domethënë, e more në shtëpinë tënde, — tha Korabi.

— Për nder të familjes! — u betua Tuti.

— Edhe unë kam një binar në shtëpi dhe iu luta baba të ma japë, por ai më tha se do më gjejë një tjetër, — tha Çerri.

— E shikoni? — tha Tuti. — Në shumë shtëpi ka binarë, prandaj nuk është për t'u habitur. Qafsha nënën që e mora në shtëpi!

— Mirë, mirë, të besojmë, — tha Minai. — Por ky binar duhet punuar, mor Tuti. Kështu nuk bën.

— E di, por thashë ta sjell një herë.

Fëmijët e vështruan me radhë. Ai ishte i vjetër dhe kishte nyje të trasha aty-këtu.

— Të shkojmë te Tryeza, — tha Minai dhe i pari u hodh me not.

Tek notonin të katër, vunë re një grup fëmijësh që po notonte drejt tyre. Minai qëndroi dhe i shikoi: ishin pesë djem. I njuhur: i pari notonte Firdusiu, djali i një avokati, pas tij vinin Pjerini i gjatë, që fëmijët me tallje i thoshin Piruni. Ai ishte djali i një tregtar manifature, Manoli, që përmendej si djalë i fuqishëm, dhe nja dy të tjerë. Ata pothuajse të gjithë banonin në lagjen Varosh dhe nja dy-tri herë ishin përlleshur me grupin e Minait dhe të djemve të tjerë të Stanit.

— Po vijnë ata të Varoshit, — tha Korabi duke notuar pranë Minait.

— I shikoj.

— Më duket se janë nisur te Tryeza, — tha Tuti.

— Ashtu më duket edhe mua, — tha Minai dhe no-

toi me forcë përpara. Qëndroi te një sop i vogël dheu nga ata që gjenden me shumicë në fundin e Currilave, dhe priti me duart në ije.

Kur pa që një grup tjeter notonte drejt «Tryezës», u thirri:

— Ku shkoni?

— C'të duhet ty? — u përgjigj Firdusiu dhe vazhdoi të notonte.

— Te Tryeza nuk keni punë, — foli Korabi, i ngrysur në fytyrë.

— Jo po do të të marrim leje ty, — ia ktheu Manoli.

Nja dy të grupit të tij qeshën. Ata vazhduan të notonin,

— Ore pyka, mos bëni shaka, se janë shaka me zarar këto, — foli Tuti dhe ngriti binarin që e mbante në duar.

— Shumë mend shesin këta të Varoshit, — tha Çerri dhe iu afrua shokëve.

— Mos u afroni te Tryeza! — tha edhe një herë Minai dhe kësaj here zëri tij ishte körcënues.

— Do të shkojmë! — tha Pjerini.

— Nuk do të shkoni, se e kemi zënë ne! — thirri Korabi.

— Qëndroni aty, se, për ndër të familjes... — u kanos Tuti dhe lëvizi binarin.

Grupi i djemve të Varoshit qëndroi. U mblodhën pranë njëri-tjerit me në krye Firdusium dhe Manolin e fuqishëm.

Dy grupet e djemve u shikuani gjatë. Tuti u afrua te veshi i Minait dhe i tha me zë të ulët:

— Sikur ta zbulojnë barkën, u fikëm. Ata me siguri do të shkojnë të spiunojnë.

— E di, — tha Minai mendueshëm.

— Janë të gjithë fytyra të ndyta, — tha Tuti. —

Edhe Firifiu (kështu e thërriste Firdusiu ai), edhe ai Piruni i gjatë.

— Më shumë mend shet ai Manoli, — tha Çerri.

Edhe ata të lagjes Varosh vazhdonin të flisnin njëri me tjetrin. Manoli bënte me duar dhe i nxiste shokët. Firdusiu e dëgjonte. Edhe të tjerët flisnin në të rallë.

— Ne do të shkojmë te Tryza, — thirri Firdusiu.

— Provojeni, — tha Minai qetë.

— Pse, juaji është ai shkëmb? — tha Pjerini.

— Kush jua kanë lënë, baballarët? — tha Manoli dhe u hodh me not drejt «Tryzës». Pas tij notuan Firdusiu dhe dy djem të tjerë. Në fund vinte Pjerini, që notonte keq me ata krahët e tij të gjatë.

— Mos t'i lëmë! — urdhëroi Minai dhe zuri të notonte përballë tyre.

Pas tij u hodhën edhe të tjerët.

Pas pak Minai edhe Manoli u gjendën ballë për ballë. E vështruan njëri-tjetrin me inat. Minai shikonte fytyrën rrumbullake të Manolit — me buzë të trasha dhe sy të egër që shkëlqenin nga një dritë ligësie.

— Ti, Çerr, prapa! — tha Tuti.

— Pse? — tha djali, i fyter. — Unë do të qëndroj bashkë me ju.

Manoli nuk lëvizte. Edhe Minai po ashtu. Të tjerët ishin rreshtuar për krah shokëve.

— Hap rrugën! — thirri Manoli.

— Këtej nuk kalon! — ia ktheu Minai.

— Ashtu? Ke për të parë! — tha ai dhe u përpoq të notonte. Minai i zuri rrugën. Tani ata gati sa nuk e preknin njëri-tjetrin.

Manoli prapë desh të kalonte. Atëherë Minai e kapi për qafe dhe ia zhyti kokën në ujë. Kështu veproi edhe Korabi me Firdusiu.



Pas pak kërcitën grushtat. Uji i detit plaquritej nga goditjet e këmbëve dhe të duarve. Manoli u shkëput nga duart e Minait dhe e qëlloi me grusht. Këtij për një çast iu errën sytë dhe iu fut në gojë një shkulm uji të njelmtë. Kjo e egërsoi më shumë. Nxori gjysmën e trupit jashtë dhe e goditi Manolin me sa fuqi pati.

Edhe të tjerët ia nisën luftës. Më zor nga të gjithë e kishte Korabi, se atij i ishin përveshur Pjerini dhe një tjetër. Dy djemtë e Varoshit e kishin vënë në mes dhe e kridhnin në ujë. Ai herë shkëputet prej tyre dhe herë u zinte qafat me krahët e tij të fuqishëm. Tuti me binarin e tij mbante larg Firdusiun dhe një tjetër.

Çerri i vogël pa Korabin dhe u drejtua me not te ai. Sa i shkoi pranë, u zhyt në ujë dhe eci duke lëvizur duart me fuqi. Pa këmbët e dy djemve të Varoshit dhe e pik-koi njërin fort, duke e larguar me duar prej Korabit.

— O mome, po mbytem! — thirri Pjerini i gjatë, kur ndjeu pickimet e forta të Çerrit. Ky u largua me të shpejtë.

— Një anije armiku u mbyt! — thirri Tuti, që e quante ndeshjen e tyre si një betejë detare.

Kur Korabi pa afër vetes kokën e Çerrit dhe Pjerinin duke u larguar, e kuptoi ndihmën e shokut të vogël dhe tha:

— Ç’ia bëre mirë, o Çerr! — Dhe i buzëqeshi.

Pas Pjerinit edhe dy të tjerë, që ishin duke u përleshur me Tutan, ia mbathën. Në fund u largua Manoli, duke nxjerrë gjak nga hundët. Prapë deti u llapashit nga këmbët dhe krahët e atyre që iknin.

— Ti po nxjerr gjak, — i tha Çerri Minait.

— Asgjë me rëndësi. Më çori pak Manoli.

Ishin të lodhur, por të kënaqur që i mundën djemtë e Varoshit, djalin e tregtarit, të avokatit dhe të dy pasanikëve të tjerë të qytetit. E merrnin me mend se ata, më

siguri, do t'u tregonin italianëve dhe milicëve për barkën e tyre.

— Kujtuan ata se janë bërë më të fortë, ngaqë kanë ngrënë makaronat e italianëve! — tha Tuti duke e pasur fjalën për shkuarjen e tyre në kampet e balilave në Itali.

— Tani nuk do t'u bjerë më ndër mend të vijnë te Tryeza, — tha Korabi.

— Unë kam një hall, — tha Minai mendueshëm; — ndoshta ata kanë dyshuar se mos ne kemi ndonjë gjë te Tryeza dhe do të vijnë pasi të ikim ne. Nuk i dihet kësaj gjëje,

— Nuk e ke keq, — tha Tuti.

— Atëherë të bëjmë roje, — tha Çerri.

— Jo, jo, nuk është nevoja, — tha prapë Minai.

— Më mirë është të largohemi më vonë dhe ata nuk do të vijnë fare.

Hipën në shkëmb. Minai lau fytyrën me ujin e njel-mët të detit. Buzën e poshtme e kishte pak të çarë dhe ajo nxirrte gjak pareshtur. Edhe Korabi lante e fërkonte nyjen e këmbës së djathtë, se e kishin qëlluar rëndë me shqelm.

— Barkën e paskemi mirë me shëndet, — tha Tuti, që rrinte pranë saj. Ai mbante më dorë binarin. E mati më barkën dhe shtoi: — Si gjatësi është mirë,


— Po duhet punuar, — foli Minai; — pastaj duhet bërë edhe pjesa e gjerë që shtyn ujin.

— Sidoqoftë, këtë javë do të nisim të lundrojmë me të, — tha Tuti dhe shikoi shokët.

— Edhe unë ashtu them, — miratoi Çerri.

— Po emrin? — pyeti Korabi.

U bë heshtje. Kishin ditë që mendonin dhe prapë nuk i kishin rënë në të. Emrat që propozoheshin nuk u pëlqenin.



Më në fund Minai tha:

— Iljazi më tregoi një ditë për një zog, që nuk i trembet stuhisë; bile, edhe kur shpërthen stuhia, ai ngrihet fluturim dhe i del përballë me trimëri. Këtij zogu i thonë zgalem. Mua më duket emër i bukur. Si thoni, a ia vemë emrin Zgalem?

Të tjerët e përsëritën këtë emër. Korabit i pëlqeu. Edhe Çerri e miratoi. Tuti u lëkund, se iu duk si emër i huaj, por megjithatë e pranoi.

— Domethënë e vendosëm. Pra, barkën tonë do ta quajmë Zgalem.

T'ia shkruajmë në të dy anët e përparme, — tha Çerri dhe kërkoi furçën.

— Shkruaje ti, Mina, — tha Çerri dhe i zgjati furçën.

— Jo, Korabi ka shkrim më të mirë se unë.

Të gjithë u grumbulluan rreth Korabit. Ai zuri të shkruante ngadalë. Pas pak, në të dy anët e përparme ishte shkruar emri «Zgalem».

— T'i vëmë edhe një shigjetë, — propozoi Tuti.

Për çudi, pasi shkruan emrin, barka e tyre iu duk ndryshe. Tani ishte thuajse plotësisht e gatshme.

Fëmijët rrinin rreth saj duke e këqyrur me dashuri.

— Po sikur të bëjmë një shëtitje të shkurtër me barkën? — propozoi Tuti.

Të tjerëve u erdhi i papritur ky propozim. Megjithatë, u pëlqeu.

— Si të lundrojmë? Nuk kemi lopata! — tha Minai.

— Punë e madhe, — iu përgjigj Tuti, — do ta shtyjmë me duar.

Të gjithë sikur u gjallëruan menjëherë. Iu afroan barkës dhe ngadalë e shtynë drejt ujit. Zemrat u rrinë me forcë. Ishin të mallëngyer. Pas aq ditë pune, aq netve me ëndrra, ja ku erdhi çasti që ta nxirrin në det barkën dhe të lundronin me të, qoftë edhe për pak kohë.

— Mos të na shohin ata të Varoshit, — tha Minai dhe ktheu kokën andej nga ishin larguar ata.

— Ata ia mbathën me bisht ndër shalë, — tha Tuti dhe vazhdoi të shtynte barkën.

Më në fund barka preku ujin. Ata ishin të mallëngjyer dhe prisnin me padurim që të shihnin se mos ajo fuste ujë ose kishte ndonjë të metë tjetër.

Pas pak u lëshua e tëra në det. Djemtë ia kishin mbërthyer sytë fundit të barkës. Ai ishte i thatë. Nuk ishte futur asnjë pikë ujë.

I pari hipi Minai, duke kërcyer me kujdes që të mos e përbyste. Pas tij Tuti, Çerri dhe në fund Korabi.

— Hip më ngadalë, — Shtyllë, se na e përbysye! — tha Tuti. Ai i tha «shtyllë» për herë të parë në sy, por Korabi nuk ia mori për keq, se ishte i pushtuar nga gjëzimi i barkës.

Tani ata ishin që të katër në barkë, në barkën që e kishin riparuar me duart e tyre.

Në fillim nuk bënë asnjë lëvizje. Vetëm ndienin përkundjen e lehtë të barkës dhe preknin pjesët e saj. I preknin me kujdes, me dashuri, sikur të ishin pjesë të gjalla të një trupi.

Pastaj Tuti futi dorën në ujë; kështu bënë edhe tjetër dhe të gjithë zunë ta shtynin ujin me shuplakat e tyre. Barka nisi të ecte në fillim ngadalë, pastaj pak më shpejt,

— Bobo, ç'të ecur që bën! — thirri Çerri. Ai ishte skuqur në fytyrë jo nga mundimi që bënte duke shtyrë barkën, por nga gjëzimi.

— Ah, sikur të kishim lopata! Për nder të familjes do të bëhej erë, — tha Tuti.

Ata vazhduan të shtynin me shuplakat dhe u larguan nga shkëmbi, duke folur e qeshur, të gjëzuar, të lumtur.

Dielli kishte perënduar, kur ata vendosën të largoheshin nga Currilat. Madje dërguan Tutin të shikonte mos ishin andej djemtë e Varoshit. Ai u kthye duke thë-

në se nuk dukej as hija e tyre. Edhe njerëzit që kishin ardhur për t'u larë ishin larguar dhe vetëm aty-këtu kishte ndonjë.

— Tani mund të ikim edhe ne, — tha Minai.

Ishin lodhur shumë. Kishte qenë një ditë plot të papritura.

E ndjenin se u dhembnin krahët. Megjithatë tregonin llojloj qyfyresh, sidomos Tuti. Edhe Korabi që ishte përgjithësisht më i heshtur, ishte çelur dhe fliste e qeshte bashkë me shokët.

U nisen në drejtëm të qytetit pasi e rregulluan mirë barkën.

Lanë Çerrin në shtëpi dhe zunë të zbrisnin kodrën.

Duke kaluar nga fabrika e cigareve, Minai ktheu kokën dhe shikoi ndërtesën e zymtë.


— Mirëmbërëma, xha Braho! përskëndeti rojen plak, që rrinte në një stol të vogël te hyrja.

— Mirëmbërëma, bir! — ia ktheu ai.

Në bulevard ishin mdezur dritat. Te kafeneja «Lupo» ata panë plot njerëz që hynin e dilnin. Një pjesë ishin ushtarakë, oficera të marinës dhe marinarë italianë. Kishte edhe civila, që mbanin për krahu gra të pispilosura. Nga brenda vinte një muzikë plot zhurmë. Kamerierët lëviznin pareshtur, duke shërbyer brenda dhe jashtë, në tryezat e rreshtuara në trotuar. Reklami me drita «Caffe Lupo» ndizej e shuhej, duke lëshuar mbi asfaltin e zi të rrugës një dritë të kuqe, që dukej sikur zbulonte njolla gjaku.

Tre djemtë mbajtën hapin dhe zunë të shikonin kafenë dhe klientët e saj.

Minai pa Petraqin që kaloi nëpër bulevard. E cte ngadalë, me kokën kthyer nga kafeneja e të huajve. E



ndoqi me sy. Ai qëndroi në një qoshe rruge, u mbështet te muri e nuk lëvizi.

Pas pak, një veturnë ushtarake bojëbari përshkoi bulevardin dhe qëndroi para kafenesë. Shoferi zbriti dhe hapi derën. Djemtë panë një burrë të ngallur që doli nga vetura,

Pas kësaj, gjithçka u zhvillua me një shpejtësi të habitshme. U dëgjuan dy krisma revolveri, që erdhën nga cepi i kafenesë. Djemtë shtangën, aq e papritur ishte ajo që ndodhi; e panë burrin që zbriti nga vetura të shtrirë përtokë sa gjatë-gjerë.

Zallahi e madhe. Njerëzit kërcenin përpjetë nga karriget, disa gra thërrisin, një kamerieri i shpëtoi nga duart tabakaja me gota, të cilat u thyen me zhurmë.

Të gjithë lëviznin, Minai ktheu kokën nga qoshja ku rinte Pétraqi. Ai nuk ishte më aty. Në një rrugicë përballe kafenesë ai vuri re një djalë, që vraponte dhe pas pak humbi në errësirë.

Përreth vendit vraponin pareshtur njerëz që lëviznin duart, flisnin me zë të lartë. Dikush thirri:

— *All' ospedale, all' ospedale!*<sup>1)</sup>

Përmbi të vrarin ishin përkulur disa njerëz. Shumica ishin ushtarakë.

Vërvshuan milicët. U panë njerëz që u nisen me vrap, duke u shpërndarë nëpër rrugica.

— *Korrete, korrete!*<sup>2)</sup> — i nxiste një oficer i gjatë me një mjekër të zezë.

Ndërkaq qarkullimi në bulevard thuajse ishte paralizuar fare. Aty ishin grumbulluar plot qytetarë. Njerëzit komentonin ngjarjen. Ata që sapo vinin, pyesnin ç'ki-

1) Në spital, në spital!

2) Vraponi, vraponi!

shte ngjarë dhe si ngjau, disa dëshmitarë tregonin si u zhvillua atentati.

Një varg milicësh largonte popullin nga vendi i ngjarjes.

Tre djemtë nuk e hapën gojën. Ajo që ndodhi u kishte lënë shumë mbresa.

Pa folur nisën të largoheshin mëpër bulevardin e gjerë. Minai kishte gjithnjë para syve Petraqin, Peçin, që punonte në fabrikë me të. Ai kishte qëlluar, apo rrinte aty për të pritur kur të vinte italiani i dënuar me vdekje. Ishte i bindur se Petraqi me siguri nuk kishte ndenjur kot aty; po nuk dinte a kishte qëlluar, apo rrinte aty për të mbrojtur atentatorin... Ai e dinte se atentatet kurrë nuk bëhe-shin nga një njeri. Po, vërtet njëri qëllonte, por, ama, aty merrnin pjesë disa njerëz.

Në bulevard vazhdonin të gëlonin njerëz. Një auto-ambulancë, duke çarë ajrin me sirenën e saj të imprehtë, shpërndau njerëzit rrugës dhe u drejtua nga kafeneja.

— Po shkojnë ta marrin, — tha Tuti.

Dy të tjerët pohuan me kokë.

— Ama ç'të këputur që i bënë! — tha prapë Tuti. — Pam-pam dhe lëmsh në vend. Ra italiani si thes...

Korabi tha:

— Kush do, të ketë qenë ai që u vra?

— Me siguri ndonjë njeri i rëndësishëm, ndonjë spi-un ose fashist i lartë, — tha Minai.

Pak nga pak biseda e tyre u gjallërua. Të tre nisën të flisnin me zjarr, duke komentuar ngjarjen që sapo-kishin parë. Secili përpiqej t'u kujtonte shokëve ndonjë hollësi, që mund t'u kishte shpëtuar.

— Aksion i madh! — tha Tuti, kurse ne vetëm dogjëm një parullë...

— Të gjitha kanë rëndësi, pasi i dëmtojnë fashistët,

— tha Minai. — Të kujtohet si vlonc qyteti pasi dogjëm parullën atje te Vila.

— Mirë, mirë, po ky atentati ishte një gjë e mrekullueshme. Hajde trimëri, hajde! — tha Tuti dhe fishkëlleu. — Në mes të qytetit, në mes të italianëve e rojeve ia krisi burri i botës pam e pam mu në lule të ballit. Ç'trimtjanë komunistë!

Tërë rrugës ata vazduan të bisedonin me njëri-tjetrin.

Ndenjën gjatë rrugëve. Folën me zjarr dhe orë e çast komentonin atentatin.

Pastaj u ndanë.

Minai ngjiti rrugën e kodrës së Stanit gjithnjë i menduar. Nuk i hiqej nga sytë atentati. Bashkë me të i vinte ndër mend edhe Petraqi që rrinte mbështetur te muri, atje në një cep të rrugës.

Atë natë e zuri gjumi shumë vonë. Lagjja flinte. Dritat kudo ishin shuar.

Minai rrinte në shtrat më sy hapur. Sotiri ende nuk kishte ardhur. Ai mbante vesh për të dëgjuar 'hapin e tij.

Nē tē rrallē, nē rrugē, ndihej hapi i ndonjē banori tē vonuar tē Stanit.

Në dhomën e zjarrit dëgjohej kolla e babait dhe zhurma e lehtë që bënte nëna duke u ngritur herë pas here nga dysheku. Ajo nuk flinte. Piste djalin.

Atë natë Sotiri nuk u kthyesh në shtëpi.

## KREU I NËNTE

Dy ditë pas atentatit, Minai po rrinte në darkë në oborrin e shtëpisë. Bënte vapë dhe ai nuk kishte gjumë. I ati kishte shkuar te xha Kosti. Thuhej se djalin e tij, Jorgjin, fashistët e kishin çuar në kampin e përqëndrimit në Porto-Romano. Babai i Minait shkonte shpesh e bisedonte me të për t'iu gjendur pranë dhe për t'i dhënë zemër.

Sotiri ende nuk kishte ardhur. Natën e atentatit ai nuk ishte dukur fare në shtëpi dhe prindët ishin shqetësuar shumë. Në mëngjes Minai kishte kapërcyer murin e fabrikës dhe kishte shkuar në Shkozet, në oficinën ku punonte i vëllai. Aty e kishte takuar.

— Fjeta te një shok, — i tha Sotiri dhe i futi dorën e madhe në mes të flokëve. Tjetër gjë nuk i tha.

Mbrëmë ai ishte kthyer prapë vonë.

Në oborr kishte qetësi. Lagjja e vjetër me dritat e saj të vogla rrinte e heshtur aty në faqe të kodrës. Diku lehte një qen. Bulkthit e padukshëm kurdisnin zembërekët e tyre.

Minai mendonte. Ishin ditë të mbushura me ngjarje. Thuhej se fashistët e kishin zbuluar me anën e një spiuni të tyre se kush e kishte bërë atentatin kundër spiunit të Simit dhe tani po e kërkonin në tërë qytetin. Bënin kontroll ngado, por nuk e kishin gjetur.

Minait iu kujtua përsëri Petraqi i mbështetur te muri atë natë, para atentatit. Të hënën në mëngjes ai e kishte takuar në fabrikë, të qetë e të shkujdesur si gjithnjë. Po të vëreje me kujdes, kuptohej se ai diçka kishte, se nuk ishte i çelur dhe nuk queshte si ngahera.

Minai u ngrit dhe iu afrua gardhit të ulët të oborrit. Vështroi burgun. Ishte i ndriçuar. Para oborrit të tij pa disa lëvizje. Ato ditë aty ishin shtuar rojet. Ndoshta edhe deni që lehte ishte i rojeve të burgut.

Nëna i kishte thënë se ato dy ditë në burg kishin sjellë shumë të rinj, të shoqëruar me roje, të armatosura deri në dhëmbë.

Pas pak u dëgjua një hap i lehtë.

— Ti je, Mina? — pyeti një zë i lehtë vajze.

Ai e njoju. Ishte Dafina, vajza e vogël e shoferit, njëra nga katër motrat e bukura të Stanit. Ajo ishte thuhajse moshatare me Minain.

— Si je, Dafinë? — e pyeti djali.

— Mirë.

Heshtën një copë herë. Minai vuri re se ajo mbante, ndër duar një enë prej balte.

— Aty është nënë Urania? — e pyeti.

— Brenda është.

— Më dërgoi mamaja të marr pak kripë.

Me dorën e lirë ajo nisi të ndukte gërshetin që i varëj në kraharor. E kishte zakon këtë gjë. Minai gjithnjë e mbante mend duke ndukur gërshetin. Vuri buzën, në gaz. Dafina ishte vajzë e mirë, pak e drojtur, por e zgjavar.

— Po ti ç'bën këtu? — e pyeti ajo pas pak.

— Kot, po rri...

Prapë heshtën. Ajo vazhdonte të ndukte gërshetin,

Minai e shikonte. Vuri re se ajo diçka matej t'i thoshte. E kuptoi dhe po priste.

— O Mina, — tha vajza, duke bërë një përpjekje të madhe, — a të vij edhe unë me ju?

Ai e shikoi i habitur. I tha:

— Ku, moj Dafinë?

— Në ato mbledhjet që bëni... kam dëshirë që edhe unë...

— Çfarë mbledhjesh, moj? Kush të ka thënë ty?

— Ç'ke ti, e kam marrë vesh unë atë. Hë, të vij, apo jo?

Minai e vështroi gjatë. Nuk dinte ç't'i thoshte. Kishte vënë re se në mbledhjet e tyre merrnin pjesë edhe dy vajza. Dëshironte që ajo të vinte, por a kishte të drejtë ai ta ftonte? Duhej folur me Iljazin; ai ishte njeriu i Partisë, që përgjigjej për pionierët.

— Të shohim... — tha djali ngadalë me një hije pak të rëndë. — Të shohim... Do të të them unë...

Vajza u gëzua. Bëri dy hapa drejt tij; sytë i shkëlqenin. Dora e djathhtë nduku me shpejtësi gërshetin.

— Lëre atë gërshet, se po e këput, — i tha Minai duke qeshur.

Dafina hyri në oborr dhe u fut në shtëpi.

Në rrugë u dëgjuan hapa të rëndë. Ishin disa njerëz. Minai ktheu kokën; pa tre vetë që po ngjitnin kodrën. Në mes dalloi Sotirin. Ata ecnin shpejt.

— Ja dhe kapetani, këtu qenka, — tha Sotiri që nga rruga.

Bashkë me të ishte Iljazi dhe Peçi. Minai u doli përpara i gëzuar. Ata i dhanë dorën. Kthyen kokat dhe shikuani rrugën nga erdhën, pastaj u futën brenda. Minai u shkoi pas. Te dera takoi Dafinën, që kishte mbushur me kripë tasin prej balte dhe po dilte.

— Natën e mirë, Mina! — tha ajo buzagaz.

— Natën e mirë, — ia ktheu djali dhe i lroi rrugën. Ai ndenji disa çaste te dera dhe e pa duke u larguar me hapin e saj të lehtë.

Hyri në kthinën e vogël, ku flinte me të vëllanë. Të tre djemtë qëndronin në këmbë. Dukej menjëherë se diçka i shqetësonte.

— Ç'kemi, kapedan? Ku është babai? — pyeti Sotiri.

— Te xha Kosti.  
Petraqi tha:

— Ore Sotir, pse i thua kapedan Minait?

— Ky ka shumë qejf të bëhet detar.

Dy djemtë vunë buzën në gaz. Iljazi e shikoi ngulatas dhe u tha shokëve se natën e aksionit për djegien e parullës te Vila, Minai ishte treguar trim.

Pastaj heshtën. Minai e kuptoi se ata me siguri kishin ndonjë punë të rëndësishme e të fshehtë dhe prania e tij i pengonte. Por dëshironte të rrinte dhe të mësonte gjëra të reja prej tyre. Tani edhe ai ishte përfshirë në valën e luftës dhe nuk i vinte mirë ta ndiente veten jashtë saj atë çast.

— Dëgjo, Mina, — i tha Sotiri, — ne kemi punë. Po të duash, dil jashtë në oborr dhe shiko nga rruga se mos vij njeri i dyshimtë. Po vure re gjë, na njofto menjëherë. Hapi sytë mirë.

— Është i kujdeshshëm ai, — tha Iljazi.

— Ashtu them edhe unë, — shtoi Petraqi dhe i shkeli syrin djalit.

Minai doli në oborr. Hodhi sytë përreth. Nuk dëgjohej asnje zhurmë.

Ndenji pak ashtu, pastaj kaloi në rrugë. Ktheu ko-

kën dhe shikoi shtëpizat e vogla të Stanit. Iu kujtua Dafina, fjalët e saj dhe mënyra si e ndukte gërshtetin.

Pas një dritareje me dritë pa hije e muratorit me një krah, Kristos. Si zakonisht, ai bënte ecejaken e tij të pandërprerë. Diçka mërmëriste nëpër dhëmbë dhe ekte e ekte pa pushim. Muratori i vjetër, që jetonte me lëmoshat e lagjes, ishte njeri i mbyllur; pothuajse nuk dilte kurrë. Minai ishte matur disa herë të shkonte të bisedonte me të, po prapë ishte përbajtur, duke menduar se ai nuk do të pranonte.

Pranë shtëpisë së tyre, edhe nënë Athinaja kishte ndezur dritën. Ajo punonte, ndoshta lante rrobat e efen diut për të rritur jetimët.

Nga fundi i rrugës ai pa një hije që ngjitej. U mundua ta dallonte. Nuk e njoju. Kush ishte vallë?

Hija vazhdonte të ekte drejt rrugës me kalldrëm. Djali bëri sikur u kthyë për të mos i rënë në sy. Me bisht të syrit vazhdoi ta përgjonte atë që vinte.

Kur i kaloi pranë, njoju Mitron, një marangoz që banone në breg të detit. Ai vine shpesh në shtëpinë e shofërit, se thuhej që do të fejohej me vajzën e tij të madhe, Marigonë.

Marangozi nuk e njihte Minain, prandaj kaloi në punë të vet.

Minait iu kujtua puna e lopatave të barkës. Ato duheshin punuar nga ndonjë marangoz. Po sikur t'i thoshte Mitros për këtë?

— O Mitro, — i tha atij që ekte përpara.

Ky qëndroi i habitur.

Minai vazhdoi:

— Jam djali i Vasilit, më quajnë Mina.

— Ah, po, — tha i riu dhe priti.

— Kemi hevojë të bëjmë dy lopatë barke. A mund të na ndihmosh?

Tjetri heshti.

— Kemi dy binarë, vetëm sa të ma i punoni pak.  
— A, kështu ndryshon puna. Mirë, sillite unë në sërt.

Minai i tha se ishte në punë, por do të dërgonte të ai dy shokët e tij. Pastaj e pyeti për vendin ku është dyqanin.

Mitroja ia tregoi dhe u largua drejt shtëpisë së shoferit.

Minai u kthye menjëherë për të vazhduar rrugën. Ajo ishte gjithmonë e heshtur. Minai i erdhë rrotull shtëpisë së vogël për t'u siguruar nga të gjitha anët.

Kalojnë gardh dhë shkoi prapa. Prej andej hapejnë pamje tjetër e Stanit. Aty dukeshin shtëpiza të tjera dhe përtëj, më shkoqur, rruga automobilistike. Në fund, pa Urën e Dajlanit, që ishte e ndriçuar. Ato ditë fashistët kishin vënë roje të shumta te ai yend, që shërbente si e vërmja rrugë për të hyrë e për të dalë nga qyteti. Ura e Dajlanit ishte një pengesë e madhe, që u krijonte shumë vështirësi ilegalëve dhe njerëzve të tjerë të luftës në levizjet e tyre.

Prapë u dëgjuat qeni që lehte egërsisht. Në qillin e kaltër ndriçonin të qetë yjet e mëdhenj të verës. Nga deti frynte një erë e bujë, që bënte të dridheshin lehta majat e pemëve.

Nata ishte shtrire anekënd. Nga porti vinte herë pas herë një zhurmë e mbetur.

«Sa do të jetë ora vallë?» — tha më vete Minai. Pyetja e tij imbeti pa përgjigje.

Lëvizi nga vëndi dhe iu afroa shtëpisë nga përparrë. Pas dritares së ndezur të kthinës pa hijet e tre të rinjve

që bisedonin me gjallëri, të afruar kokë më kokë.

Minai ndjeu uri. U afraua pa zhurmë te shtëpia. Në oborr, nëpërmjet dritares gjysmë të hapur dhe në qetësinë e natës, dëgjoi zërat e djemve që flisnin ngadalë.

— Kjo punë duhet menduar mirë, — thoshte Iljazi.

— Sido që ta mendojmë, kryesore është që të nxjerrim jashtë qytetit Prokopin, — fliste Petraqi.

— Mirë thotë Peçi, — shtonte Sotiri, — fashistët po e kërkojnë. Nuk duhet të bjerë në asnje mënyrë në dorën e tyre.

— Nuk do ta lëmë, jo.

— Bazat ku po e lëvizim janë të sigurta. Po ato duhen ndërruar.

— Po si do ta nxjerrim?

— Minait i erdhì turp që po dëgjonte ashtu i fshehur në oborr. Lëvizi nga vendi dhe hyri në shtëpi.

du përshtojnun e qytetit te qytetit te qytetit te qytetit  
Minja uqeban nji. U qytet te qytet te qytet te qytet  
qytet uqeban qytet qytet qytet qytet qytet  
te qytet qytet qytet qytet qytet qytet  
Kto bune shpet ushqenec mire. — Isqepje tijesi  
Sido de te mundohim tijesi te qytet te qytet  
e vërokujtje. Një qytet qytet te qytet te qytet te qytet  
KREU I DHJETË

Ata ecnin me hap të shpejtë. Në duar mbanin dy binarët. Në rrugicat me kaldrëm, hapat e tyre ushtonin fort dhe muret ia përcillnin njëri-tjetrit jehonën.

Ishte mëngjes. Ora nuk kishte vajtur ende tetë. Dilelli atë ditë ishte i zënë. Në quell lëviznin pa pushim re të zeza të ngarkuara me shi. Nga deti frynte erë.

— Shirok! — tha Tuti duke ngritur kokën.

— Do të bjerë shi, — ia priti Çerri shkurt.

Në një cop të rrugicës ata dëgjuan zërin e një sharre. Në hundët e tyre erdhi një erë e lehtë rrëshire. Para një dere të vogël panë disa dërrasa të mbështetura në mur dhe pranë tyre dy trungje peme.

Iu afroan dyqanit. Zëri i sharrës u bë më i fortë dhe rrëshire ndihej më shumë. Nga dera gjysmë e hapur panë një djalë pa këmishë, që mbante një përparëse të lidhur në zverk.


— Ju jeni Mitroja? — tha Tuti.

Djali që i kishte kthyer shpinën nuk u përgjigj. Vazhdoi të sharronte një dërrasë, që e mbante me gju mbi një stol.

— Thirr më shumë, — tha Çerri.

— Ju jeni Mitroja?

Djaloshi ktheu kokën. Fytyrën e kishte plot pah dë-



rrase, që gati ia kishte zbardhur vetullat kaleshe dhe pjesën e përparme të flokëve që i dilnin nën një beretë.

— Unë jam, — tha ai me një zë të trashë.

— Jemi shokët e Minait, — tha Tuti. Po kur vuri re se marangozit nuk i bëri përshtypje ai emër, shtoi. — Ai ka folur me ju për punën e dy lopatave të një barke.

— Ah, po, — tha marangozi, që u kujtua për bisedën që kishte zhvilluar para dy netësh me djalin stanor.

U bëri me shenjë dy djemve të hynin brenda. Pastaj mori me duart e tij të bymyera e plot nyje binarët që i afroan ata.

— Ky nuk qenka i mirë, — tha duke treguar me gisht

binarin e Tudit; — éshtë i vjetër dhe pjesërisht i kalbur. Këtij, or çuna, i ka vdekur nëna...

— Po ne na duhen dy lopata, — tha Tuti.

— E di, barka éshtë si njeriu, ecën me dy këmbë. Prisni ta mendojmë një herë këtë punë...

I pështyu lehtë gishtit dëftues, e fërkoi me gishtin e mesit dhe i fërkoi të dy disa herë.

Fëmijët vunë re se Mitroja ishte i shkurtër, me një fytyrë të mprehtë dhe dy sy të vegjël, që i lëvizte parashëturi. Vetëm zërin e kishte si të një burri të moshuar, gjë që ishte në kundërshtim me tërë paraqitjen e tij.

— Na jep hua një binar, — tha Tuti. — Kur të gjemë ndonjë tjetër, ta kthejmë përsëri.

— Mos u ngut, se duhet menduar mirë kjo punë, — tha prapë marangozi dhe fërkoi dy gishterinjtë pasi i bëri me pështhymë. Ndenji një çast i menduar dhe tha duke tundur kokën. — Do t'ju ndihmoj. Do t'ju jap një binar tjetër. Por këtë të vjetrin ma lini mua.

Ai largoi dërrasën që po sharronte, dhe nisi të merrje me lopatat e dy djemve. Këta shikuan njëri-tjetrin të gëzuar.

Minai u afroa pa zhurmë dhe trokiti në xham. Në shtëpi ishte qetësi e plotë. Vetëm thellë, andej nga kuzhina, vinte një zukatje e lehtë zérash.

Ai e dinte se aty rrinte zakonisht Dafina.

U ngrit në majë të gishterinje dhe hodhi sytë brenda dhomës. Nuk kishte njeri. Trokiti edhe një herë në xham; kësaj here më fort.

Sa u mat të trokiste edhe një herë, në dritare u duk Maja, motra e madhe e Dafinës.

— Ti qenke? — pyeti ajo dhe i qeshi fytyra, duke

zbuluar dy vargje dhëmbësh të bardhë. — Të çoi teta Ura për ndonjë gjë?

— Desha pak Dafinën, — tha Minai.

— Dafinën? — u habit vajza dhe, pasi shkoi brenda, thirri: — Dafne, o Dafnë, dil se të kërkojnë.

Dafina erdhi pas pak. Shikoi Minain dhe u afroa te parvazi.

— Eja pak, — i tha Minai.

Ajo nuk pyeti për se, por u largua nga dritarja dhe shkoi në dhomën tjetër të mbathte sandalet.

— Keni punë? — e pyeti Maja si me gjithë mend e si menshaka.

— Do të dalim pak?

Mos u vononi, — e porositi të motrën dhe, duke i buzëqeshur Minait, u largua nga dritarja.

Tek zbrisnin kodrën, Minai vuri re se vajza matej ta pyeste, por nuk e hapte gojën.

— Do të vish në mbledhje me ne, — tha Minai. —

Që atë natë që më the, fola me një shok dhe ai më pyeti për ty, për familjen dhe pranoi, që, kur të kemi mbledhje, të vish edhe ti.

— Që atë natë — u habit Dafina. — Po ku e takove ti atë shokun?

Minai nuk donte të tregonte që Iljazi kishte qenë në shtëpinë e tyre, dhe ia preu shkurt:

— E takova në një vend. Po ti, i the mamasë që mund të vonohesh? — e pyeti ai dhe, pasi vajza nuk foli, shtoi: — Gabim ke bërë. Do të bëhet merak ajo. Pastaj ti e di, imbrëmë bënë tërë atë kontroll në shtëpitë e Stanit.

— Do t'i thotë Maja që dola me ty, — tha Dafina dhe i qeshi fytyra që gjeti atë zgjidhje. U mat të ndukte gërshtetin, por atë çast Minai po e shikonte dhe ajo e larroi dorën.

Petraqi tha:

— Ti prit këtu, Prokop. Unë do të shikoj një herë rrugën.

Dy djemtë qëndruan në vend. Aty, nga maja e kodrës fillonte lagjja Stan. Ata kishin zbritur prej andej duke kaluar nga Çesmja e Ferrës.

Petraqi u kthyte pas pak:

— Nuk ka njeri.

Zunë të zbrisnin kodrën. Ecnin nëpër një rrugë të ngushtë. Era ishte shtuar dhe në qìell prapë silleshin re plot me shi.

Ecën disa çaste në heshtje. Në kalldrëm trokisin këmbët e tyre. Para shtepisë së Sotirit ata qëndruan. Petraqi fishkëlleu dhe me njëherë doli djaloshi që, siç dukej, i priste.

— Ejani brenda, — tha ai dhe i futi në shtëpi.

Në një cep të dhomës rrinte Vasili me një xhaketë të vjetër hedhur supevc; pas djalit rrinte nënë Urania.

— Ju kam sjellë një mysafir sonte, — tha Petraqi,

— Mirë se vini! — iu përgjigj nënë Urania.

Teneqexhiu plak u ngrit nga vendi. Petraqin e njihete, kurse Prokopin e shikonte për herë të parë. I bëri përshtypje ai djalë thuajse moshatar me të birin, që shikonte ngultas me një palë sy që dukej sikur nxirrin shkëndija.

— Uluni, — tha Vasili dhe vazhdonte të shikonte mikun.

Petraqi dhe Prokopi u ulën në dy stola të vegjël që u vuri përpëra Urania.

— Po si jeni, mor djem? — hapi bisedën Vasili.

Djemtë iu përgjigjën me fjalë të shkurtra. Prokopi u ngrit dhe i zgjati një cigare.

— E pikérke shumë, — tha Vasili, duke parë gishtat e tij të zverdhur nga nikotina.

— Çka.

Vasili e pyeti dhe ai tregoi për veten, se ishte tipograf dhe kishte në shtëpi vetëm nënën e babanë. Këto i tha shkurt e shpejt. Plaku vuri re se ai fliste shpejt dhe sytë i shkëlqenin. I bënte përshtypje ai djalë me temperament të zjarrtë që fliste prerë, pa i stërholluar fjalët.

— Ku është Minai? — pyeti Sotiri duke shikuar përreth.

— Nuk ka ardhur ende, — tha nëna.

Babai thithi cigaren dhe shtoi:

— Ka nisur të vonohet edhe ai... — u mat të thoshtë një fjalë, por ndërroi mendje; — ia rregulloj unë qejfin, sa të vijë, ia kam bërë benë.

Të tre djemtë shikuau njëri-tjetrin.

— Nuk është mirë, xha Vasil, — tha Petraqi me zë të ulët. — Ka edhe ai punë. Është djalë i mirë dhe i mbarë. Mos të të shkojë mendja kurrë se bën ndonjë gjë të pahijshme. Ti e di, unë punoj në një vend me të. Ai është i papërtuar dhe shumë i sjellshëm.

Vasilit iu bë qeifi që dëgjoi ato fjalë, por prapë zemërimi nuk i kaloi.

— Sot kanë punë të rriturit dhe të vegjlit, or xha Vasil. Është luftë kjo dhe luftë e madhe, — tha Prokopi me një frymë.

— E, mor djalë, se nuk ka mbetur lufta ta bëjë Minai, jo. Ju mirë, por ai...

Jashtë u dëgjua një zhurmë. Sotiri u ngrit dhe shkoi te dera. Vasili vuri re se Prokopi futi dorën në xhepin e djathtë.

Zhurma erdhi duke u larguar. Sotiri e hapi derën me kujdes dhe pa një burrë që tèrhiqte një karrocë dore.

— Eshtë Rama që kthehet nga pazari, — tha Vasili.

— Ai vetë, — tha Sotiri që mbylli derën dhe, duke iu drejtar Prokopit, shtoi: — Eshtë një hamall, që rri më një bodrum këtu në majë të kodrës.

— The se të vegilit nuk e bëjnë luftën, — iu kthyë bisedës së parë Prokopi. — E bëjnë që ç'ke me të. Lufta nuk bëhet vetëm me armë, po edhe me çdo mjet tjetër të përshtatshëm edhe për të vegilit.

Vasili e kuptoi ku rrihte djali dhe i pëlqeu shpjegimi. Tundi kokën dhe thithi cigaren.

Pas pak nënë Urania u shtroi të hanin. I pa djemtë që shijonin bukën me gjizë e me domate.

Kur po mbaronin darkën, u hap dera dhe hyri Minai. Ai hodhi sytë përreth. Druhej nga i ati. Kur pa Sotirin dhe dy shokët e tij, ftyra i qeshi. E dinte se kjo do ta shpëtonte nga ndonjë shuplakë e babait.

— Ky eshtë ai trimi jonë, kapetani, — tha Sotiri duke ia paraqitur Prokopit.

— Domethënë ky eshtë fajtori, — tha Prokopi dhe qeshi duke parë nga Vasili.

Plaku vuri re se djali kishte një të qeshur të çiltër dhe të veçantë.

— Pe njeri rrugës? — e pyeti Sotiri Minain.

— Jo. Nuk lëviz asgjë.

Pastaj tre të rinjtë shkuan në kthinën e vogël. Minait i erdhi inat që nuk e morën me vete, megjithëse e dinte se ata kishin punët e tyre. Ai digjej nga kureshtja të dinte kush ishte ai i panjohuri, që ishte me të vëllanë e Petraqin. I dukej sikur e kishte parë një herë në qytet, por nuk ishte i sigurtë.

— Si quhej ai djali? — pyeti nënë Uraninë.

— Prokop, më duket se e quanin, — tha e ëma.

Minait iu kujtua që e kishte dëgjuar atë emër kur e kishin përmendur atë natë Sotiri me Iljazin e Petraqin tek bisedonin për ta nxjerrë jashtë qytetit. Ishte atentator! Ai që e shtriu për tokë fashistin para kafesë «Lupo». Sa dëshirë kishte pasur ta njihte. Ja, ai ishte te ata, Minai i kishte dhënë dorën.

Hante pa u ngutur, se mendjen e kishte te Prokopi. I ishte dukur njeri i zakonshëm, i qetë, sikur të kishte ardhur thjesht për darkë dhe jo i kërkuar me ngulim nga fashistët. Sytë e tij i kishin lënë mbresë Minait; ata ishin si dy thëngjij që lëshonin shkëndija, dhe të bënин për vete.

Iu kujtua kontrolli që bënë fashistët para një nate në Stan. Ata ishin si një llavë ujqish, kishin trokitur në-për dyert e shtepizave të Stanit, kishin vërvhuar brenda duke kontrolluar me sytë e tyre të egër çdo skutë të fsheetë, çdo cep të shtëpive. Edhe te muratori plak me një krah ishin futur. Ky nuk kishte dashur t'ua hapte derën por ata e kishin shpërthyer: Kriston e kishin qëlluar me kondakët e pushkëve dhe ai tanë e mbante kokën të lidhur me një shami të vjetër.

U hap dera e kthinës. Sotiri e thirri:

— Mina, eja pak.

Kthina ishte e mbushur plot me tym duhani. Prokopi rrinte mbi shtratin e vogël të Minait dhe pinte cigarette. Petraqi qëndronte në këmbë, mbështetur në faqen e murit.

— C'janë këto këtu? — e pyeti i vëllai, duke i treguar dy lopatat që ishin pas murit.

— Lopata... — tha djali i hutuar.

— More, — tha Petraqi, — a e dini se rruga e detit është më e sigurta për të dalë nga qyteti!

— Prandaj po e 'pyes Minain, — tha Sotiri duke iu kthyer tē vällait.

— Mos keni gjë ndonjë barkë, or kapcedan?

Djali nuk foli. Uli sytë. I erdhi zor që deri atë çast ia kishte mbajtur tē fshehtë edhe tē vällait punën e barkës. Pastaj ngriti kokën dhe, i ndriçuar nga një mendim i papritur, tha:

— Shokun... Prokopin e nxjerrim ne me barkë...

Në dhomë u bë heshtje. Ato fjalë e ndryshuan krejt gjendjen. Të rintjtë u vështruan në sy.

— Ore, po kjo është... është... — tha Petraqi me entuziazëm dhe fjala i mbeti në gojë. — Si, mor Mina, paskeni barkë!

Djali u tregoi me pak fjalë se si e kishin gjetur barkën e dëmtuar, si kishin bërë riparimin e saj, si kishin siguruar lopatat dhe foli për shokët me tē cilët kishte punuar që prej dy muajsh aty te shkëmbi i Currlave.

— Po unë me tē drejtë tē quajtkam kapcedan, — tha Sotiri dhe, duke iu kthyer shokëve, shtoi: — As mua nuk më ka thënë gjë. Ah, shejtan, shejtan... — iu afrua tē vëllait dhe e përqafoi.

Ata nisen tē mendonin me hollësi përdorimin e barkës.

— Kjo punë nuk do zgjatur, — tha Sotiri; — po e vendosëm, unë them që nesër mbrëma ta nxjerrim përtetj Urës së Dajlanit.

— Kush do ta çojë? — tha Petraqi.

— Unë, ti...

— Po ne? — ndërhyri Minai i prekur...

— Të pyeta, — tha Petraqi, — pasi ka më pak rrezik ta çojnë fëmijët. Tek ata nuk dyshon njeri, ndërsa, po tē jemi ne tē rriturit...

Sotiri u mendua. E kuptoi që Petraqi kishte të drejtë.  
Minai tha:

— Mos u bëni merak nc do ta çojmë në vend pa na  
ndodhur asgjë.

— A dini të vozitni? — pyeti Sotiri.

— Si nuk dimë? — tha Minai. — Kemi vozitur sa e  
sa herë me barkë. Pastaj nuk është ndonjë gjë e vështirë.  
Mos harroni se jemi katër shokë dhe të gjithë të fuqishëm:  
Korabi, Tuti, unë dhe Çerri.

— Edhe unë mund të vozis, — tha Prokopi.  
Në fund Sotiri tha:

— Kjo është zgjidhje e mirë. Megjithatë do të marrim  
edhe mendimin e Qarkorit të Partisë. Ti, Mina, me  
shokët të jeni gati. Kuptove?

## KREU I NJËMBËDHJETË

I pari erdhi Çerri. Atij i kishin dhënë me vete një pako, ku kishte një këmishë të trashë për të fjetur. I ati, kishte ngulur këmbë që ta merrte.

Me vështirësi Çerri kishte arritur t'ia mbushte mendjen që atë natë do të shkonte të flinte te Minai.

— Pse? — e kishte pyetur i ati.

— Më ka thirrur. Ka datëlindjen, — kishte gënjer gjali për herë të parë.

Në shtëpinë e Minait gjeti, përveç shokut tij, edhe të vellanë me një shok tjetër, që ai nuk e njihte.

Ai nuk e dinte çfarë do të bënin me përpikmëri. Minai kishte ardhur në shtëpi dhe i kishte thënë: «Sonte kemi një punë të rëndësishme. Do të lundrojmë me barkën tonë larg». Ai e kishte pyetur për të marrë vesh më shumë, por Minai nuk i kishte treguar gjë.

— Futu brenda, — i tha Minai. Çerri u ul në një cep të dhomës së zjarrit, ku ishte edhe babai i shokut, që kollitej pareshtur dhe merrte frymë me vështirësi.

I dyti erdhi Tuti. U fut në dhomë pa trokitur. Kur pa Çerrin, i qeshi fytyra dhe shkoi u ul pranë tij pa folur.

Ishte vonë. Ora kishte kaluar nëntë dhe jashtë frynte erë. Kishte dy-tri ditë që matej të binte shi, por re-të endeshin në qiell, shkonin e vinin e nuk lëshonin asnjë

pikë. Larg, në det, vetëtinte. Ishte një zagushi e keqe që të merrte frymën. Mizat fluturonin si të çakërdisura dhe të pickonin fort.

Pastaj erdhi Petraqi. Minai e pa se u bënë shumë dhe i mori shokët e dolën në oborr.

— Mos të të bjerë era, — tha Urania.

— Jo, moj nënë, bën vapë, — tha Minai dhe mbylli derën.

U ulën të tre. Frynte erë, që vinte nga deti, duke sjellë re të dendura të ngarkuara me shi. Rrallë davariteshin retë dhe dukej ndonjë yll që ndriste në quell.

— Po Korabi, pse nuk ka ardhur? — pyeti Minai.

Dy të tjerët nuk dinin ç'të thoshin. Të treve u shkoi mendja te babai i tij, që gjithnjë ishte i sëmurë dhe nxirrte gjak nga goja. Ai kishte thënë që do të vinte, po ndoshta...

Ata flishin pak, por mégjithatë dukej që ishin në tension. Detyra e asaj nate, jo vetëm i joshte, por edhe i shqetësonë, pasi ndienin përgjegjësinë e atij aksioni shumë të rëndësishëm. Minai u kishte thënë shokëve se 'do të bënин një udhëtim të gjatë. Po se ku do të shkonin dhe ç'do të bënин nuk dinin, asgjë. Prandaj të tjerët digjeshin nga dëshira që ta merrnin vesh, por Minai nuk u fliste. «Do ta merrni vesh pas pak» — iu përgjigj atyre, kur e pyetën përsëri aty në oborr.

U hap dera dhe Sotiri e thirri brenda Minain. Aty i tha:

— Qarkori i Partisë s'ka asnje kundërshtim që ta nxirri jashtë qytetit Prokopin me barkën tuaj. Hapni sytë, se keni në dorë një shok të luftës. Veproni me kujdes. Tani shkonin pérpara, merrni barkën e nxirri në breg dhe prissni atje. Edhe një gjë: do të keni me vete grepa, karrema, që, po t'ju ndalojë njeri, të thoni se keni, dalë për të zënë peshk, kuptuat? Keni ardhur të gjithë?

— Mungon vetëm Korabi.

— Nuk kemi ç'ti bëjmë. Duhet të nisemi. Ora kaloi dhjetë. Merrni lopatat dhe shkoni te Currilat. Hapni sytë rrugës se mos ndesheni me ndonjë patrullë italiane. Edhe në breg tregoni kujdes. Andej lëvizin patrulla.

Minai mori lopatat.

— Na xhaketën, — i tha Urania duke i hedhur krahevë një xhaketë të arnuar të Sotirit. — Sonte është mot i keq. Edhe shiu nuk do të vonojë. Kujdes të keqen nëna.

Vasili e shikoi ngultas dhe ia bëri më dorë. Edhe ai ishte i shqetësuar, por nuk e shfaqte. Pinte cigare i menduar dhe kollitej.

Kur ata dolën në oborr, Çerri me Tutin u ngritën në këmbë.

— Do të nisemi, — tha Minai. — Lopatat po i marr unë. Ti, Çerr, hidh një sy në rrugë dhe rreth shtëpisë se mos shikon ndonjë gjë të dyshimtë.

Çerri doli jashtë oborrit. Tuti tha:

— Ku do të shkojmë?

Minai e shikoi.

Tuti e humbi durimin.

— Fol, mor Mina, se më plase. Ku do të shkojmë dhe pse?

U kthye Çerri. Ai nuk kishte vënë re asgjë të dyshimtë.

Tre djemtë rrëshqitën nga shtëpia të heshtur. Morën përpjjetë kodrën e Stanit pér t'i rënë nga Dymbëdhjetë Shkallët.

— C'doje të thoshe ti, Mina? — e nxiti Tuti shokun pér të marrë vesh qëllimin e lundrimit të asaj nate.

Minai qëndroi. Dy shokët u afroan. Ai tha me zë të ulët:

— Do tē çojmë te Shkëmbi i Kavajës një shok tē luftës.

Tuti fishkëlleu nga gëzimi. Çerri tha:

— Kush është ai?

— Është ai që bëri atentatin kundër agjentit tē Simit atë natë te kafeneja «Lupo.»

Vazhduan tē ecnin. Shtëpitë e vogla tē Stanit pothuajse flinin. Dritat ishin shuar. Ndihej era që frynte herë e lehtë e herë e rrëmbyer. Gjethet e pemëve fëshfërinin duke u dridhur. Dëgjohej vetëm çesmja që rriddhe afër majës së kodrës.

— Bobo, nuk morëm ndonjë shishe me ujë! — tha Tuti. — Është rrugë e gjatë dhe ndoshta do tē na marrë etja.

— Kam unë një pagure me ujë, — tha Minai dhe preku pjesën e pasme tē pantallonave.

Rrugës ecën me kujdes, por nuk takuan njeri. Vetëm kur zbritën Dymbëdhjetë Shkallët dhe morën rrugën e Currilave, ata panë disa hije që lëviznin në breg.

— Patrulla! — tha Minai dhe tē tre qëndruan e u përkulën.

Nga vendi ku ndodheshin ata me zor dalluan se ishin tre ushtarë me pushkë në krah që ecnin gjatë bregut.

Pritën disa minuta. Kur panë se italianët shkuan tej bregut dhe humbën nga sytë e tyre, Minai u ngrit i pari në këmbë.

Po atë çast u dëgjuat një zhurmë që vinte prapa tij. I trembur, ai ktheu kokën. Nga Dymbëdhjetë Shkallët po zbriste një njeri. Ai u përpoq ta shquante. Mendoi se mos i kishin ndjekur.

Pas pak thirri gjithë gaz:

— Korabi!

— Unë jam, — u përgjigj ai.



Djemtë u përqafuan me shokun e tyre sikur të kishin kushedi sa kohë pa t'u parë.

— Mezi munde të vish, apo jo? — i tha Tuti.

— Po... babai... — djali bëri një shenjë me dorë dhe shtroi flokët që ia merrte era e detit

Në breg kishte errësirë. Valët e shtyra nga era e frih-nin rërën pa pushim dhe uturima e détëndihej e fuqishme.

— Unë me Korabin po shkojmë të sjellim barkën në breg, — tha Minai. — Ju të dy rrini këtu, hapni systë se mos vjen njeri.

Ata u zhveshën pa bërë fjalë. Në breg lanë pantallo-nat e shkurtra e këmishët. Minai bashkë me to vuri edhe xhaketën e vjetër të Sotirit, që i vinte e madhe. Morën lopatat, hynë në det dhe nisën të notojnë me kokën lart që të mos u futej në gojë ujë.

Uji nuk ishte i ftohtë. Larg ata shihnin shigjetat e përthyera të rrufeve që binin mbi det.

— A mërdhin? — e pyeti Tuti Çerrin.

— Jo, po ti?

— As unë. Nuk është çudi që të na zërë shiu. Por sidoqoftë, shi vere është. Shiu, në verë një vesh të lag e një vesh jo, thotë xhaxhai im.

Pas këtyre fjalëve heshtën. Era vazhdonte. Ajo ishte e njelmët dhe, kur frynte, në fytyrë të linte një kundërmim kripe. Në breg dukej vetëm bardhësia e kre-shtave të valëve, që përplaseshin me zhurmë.

Ata shikonin nga deti, duke u munduar të çanin terrin për të parë shokët që do të sillnin barkën. Pas pak dëgjuan zhurmën e lopatave dhe zérin e Minait që diç i thoshte shokut.

— Po vijnë, — tha Çerri.

Kur ata iu afruan bregut, Minai kérceu në ujë. Ashtu béri dhe Korabi dhe të dy e têrroqën barkën,

— Me kujdes! — tha Minai.

Dy djemtë që rrin në breg, shkuan te shokët, e kapën barkën dhe e afroan ngadalë. Ajo nuk qëndronte në vend nga valët.

Porsa e rregulluan më vështirësi, nga kodra panë që zbritën tre njerëz. I njohën: ishte Sotiri, Prokopi dhe Petraqi.

— Gati, çuna? — pyeti Sotiri pa u afroar mirë.

— Gati, — u përgjigjën fëmijët.

— A patë ndonjë lëvizje këtej nga bregu?

— Një patrullë ushtarësh, — tha Minai.

— Po u larguan tutje, — shtoi Çerri.

— Megjithatë nuk duhet të vonohemi. Ata mund të kthehen.

Të rinjtë nisën të flisnin me zë të ulët. Djemtë mbanin barkën që mos t'ua përlanin valët.

— Ju solla edhe grepat, një kuti me karrema dhe dy kallama që ju i harruat, — tha Sotiri; — siç e thamë; sidiqë të vijë puna, të thoni se keni dalë në det për të zënë peshk, kuptuat? Të jeni të gjithë në një fjalë.

Në breg dëgjohej era që frynte me furi. Retë plot shi vërtiteshin në qiellin pa yje. Uturima e valëve vinte e pandërprerë dhe ajo përfshinte tërë bregun. Currilat zakonisht nuk kishin shumë valë dhe erë, pasi i mbronin kodrat, por atë natë era frynte në drejtime të tjera, prandaj kishte zhurmë dhe uturimë.

— Atëherë të ndahemi, — tha Petraqi.

Tre të rinjtë u përqafuan. Fëmijët vunë re se ata ishin të mallengjyer dhe u vinte keq që ndaheshin nga njëri-tjetri.

— Ruga e mbarë! — tha Sotiri.

— Të fala shokëve! — shtoi Petraqi.

— Mirupafshim! — iu përgjigj Prokopi. — Me fitore të reja!

Ilegali hyri në ujë. Në dorë mbante një trastës. Hipi në barkën që lëkundëj nga lëvizja e pandërprerë e valëve.

Sotiri iu afroa Minait. I dha grepat dhe pajisjet e tjetra të peshkimit, e zuri për qafe dhe, duke i përkëdhelur flokët e shpupurishur nga era, i tha me zë të ulët:

— Rruga e mbarë, kapedani im i vogël!

Kur Minai u kthyte në barkë, të gjithë ishin aty. Dy të rintjtë iu afroan barkës dhe e shtynë atë. Ajo, duke u lëkundur, mori rrugën e detit të gjerë.

Kishin më se tri orë që lundronin nëpër detin plot dallgë dhe erë. Në fillim e kishin pasur të vështirë. Ishin larguar nga bregu shumë që mos të binin në sy të patrullave dhe t'i largohej rrezikut për t'u përplasur te Gurët e Currilave. Era i shtynte nga bregu, por ata me mundim, metër për metër, ishin larguar duke vozitur skicë. Lopatat i punonin Korabi me Prokopin dhe ata, si më të fuqishëm se të tjerët, kishin bërë që barka pak nga pak t'i largohej bregut dhe të merrte kthesën që i largonte nga Currilat.

Tani e kishin pak më lehtë. Erën e kishin prapa dhe ajo i shtynte. Valët ishin të mëdha dhe barka, si një kuzitë e vogël, herë ngrihej në majë të kreshtës dhe herë kridhej në humbëtirën e errët të detit. Fëmijët u trembën në fillim, por pak nga pak u mësuan dhe tani u bënte më pak përshtypje ajo kalamendje në shpinë të valëve.

Fëmijët u gëzuan kur panë dritat e qytetit. Kjo gjë e bënte më të lehtë vetminë e madhe në detin e gjerë.

— Nuk do t'i afrohemë portit, — tha Prokopi — përkundrazi, do të shkojmë më thellë që mos të biem në sy.

Çerri rrinte në kic dhe shikonte qytetin. Ai përpiquej tē shquante dritën e shtepizës së tij atje në majë tē kodrës. Ishte vonë dhe prindët me siguri flinin.

Tani ai po e ndjente më mirë se, duke ndenjur me ata shokë tē mirë e tē fortë, duke marrë pjesë në grupin e pionierëve që bënin aksione, kishte ndryshuar dhe nuk ishte ai Çerri i disa muajve më parë. Ndërtimi i barkës, djegia e parullës fashiste pranë shtëpisë së tij, tē gjitha kishin ndikuar te ai dhe tani shumë gjëra i shikonte me tjetër sy, i vlerësonte ndryshe, madje dhe kujdesi i prindërvë i dukej i tepërt dhe i papërshtatshëm për tē. Udhëtimi i asaj nate në detin e trazuar ishte një provë tjetër. Para disa muajve do tē ishte trembur së tepërmë, kurse tani ndihej i fortë dhe e zotëronte veten.

— Po sikur tē na dalë ndonjë anije italiane? — pyeti si me shaka.

— Le tē dalë, — ia ktheu Prokopi po me tē qeshur, — se fundi i fundit, ne peshkatarë jemi...

Tuti qeshi. Atij i erdhi mirë që Prokopi u çel disi. I ishte dukur njeri pak i mbyllur, por e kishte përligjur qëndrimin e tij me rëndësinë e punëve që ai kryente dhe shqetësimin e tërë atyre ditëve tek gjurmohoj nga fashi-stët. E shihte nga afër se Prokopi ishte trim dhe nuk tre-mbej nga asgjë, se udhëtimi i asaj nate me barkë nuk ishte një gjë e zakonshme as për atë.

Në mes tē zallahisë së valëve, që ngriheshin e uleshin pareshtur dhe përplaseshin me furi në faqet e barkës së vogël, u dëgjuai një sirenë vaporë, në fillim e zgjatur pastaj me intervale.

Të gjithë mbajtën vesh.

— Kushedi ç'i ka ngjarë, — tha Prokopi duke e pasur fjalën për anijen, — zakonisht me ato thirrjet e shkurtra, tri herë radhas, ato kërkojnë ndihmë.

Korabi u ngrit nga vendi.

— Më lër të vozis unë, — i tha Prokopit.

— Nuk jam lodjur, — tha i riu, — ti shko e zër vendin e Minait.

Minai i dha lopatën pa bërë fjalë. E ndiente veten të lodjur, krahët i dhembnin. Të vozitësh në mot të mirë dhe është vështirë, jo kur ka dallgë, që këputesh fare. Shkoi e zuri vend afër Çerrit.

— Je mirë, Çerr?

— Shumë mirë. Më vonë më lini edhe mua të vozis. Nuk dua të më mbani me hatër.

— Ka kohë. Do të vozisësh, mos u bëj merak.

Ajo verë kishte qenë e jashtëzakonshme për Minain. Jo vetëm puna e riparimit të barkës, por sidomos futja në punë dhe pastaj aktivizimi në organizatën e pionierit kishin ndikuar shumë te ai. I dukej vetja më i rritur, më i fortë, më i vendosur. Minai e dinte se e kishte ndihmuar shumë i vëllai dhe shokët e tij, Petraqi, Iljazi. Ai kishte mësuar shumë prej atyre të rinjve aq të vendosur, të thjeshtë, të pjekur, I kujohej Maliqi, që dergjej në burg dhe, siç thoshin shokët e tij, nuk u ishte përulur fare fashistëve. Minai nuk e kishte harruar ditën kur e arrestuan në fabrikë, qetësinë që rridhte nga vendosmëria e tij dhe atë lëvizjen e lehtë me sy, që i kishte bërë tek e merrnin ushtarët fashistë.

Para vetes kishte Tütin. Ai ishte djali i gjallë, i shkathët plot humor. Ishte pak çapkën dhe më parë bënte edhe ndonjë veprim të pamënduar, por Minai kishte vënë re se edhe ai nuk ishte më i pari. Tani mendohej, nuk bënte në kokë të vet, dëgjonte më shumë dhe bindej.

— Sa do të jetë ora? — pyeti Korabi duke vazhduar të voziste me forcë.

— Një e gjysmë, — tha Prokopi dhe shtoi: — Era

po shtohet, por barka juaj nuk do t'ia dijë. E paskeni bërë të fortë.

Djemve iu bë qejfi nga ato fjalë. Të gjithë kishin pasur frikë nëse do t'i bënte ballë barka e tyre atij moti të keq, por deri tani ajo nuk kishte pësuar gjë. Ujë nuk fuste dhe lundron me lehtësi në detin e trazuar.

— A të vozis edhe unë pak? — u lut Çerri.

— Sa të kalojmë portin dhe të drejtohem nga Golemi, merre ti lopatën, — tha Korabi dhe Minai pa supet e tij të fuqishme që tërhiqnin me forcë lopatën me dy durar. Atij gjithnjë i kishte pëlqyer ai djalë fjalëpak, që kishte aq halle në shtëpi dhe që nuk ankohej kurrë.

Papritmas ata ndjenë pikat e para të shiut që ranë mbi kokat e tyre dhe trokitën në dërrasat e barkës.

— Filloi, — tha Prokopi dhe ata e kuptuan se e kishte fjalën pér shiun. — Ndoshta do të na lagë pak, por mund ta qetësojë erën dhe do të lundrojmë më lehtë.

Pikat e mëdha të shiut iu dukën fémijëve të vakëta. Ata ishin mësuar me ujin dhe nuk u bëri shumë pérshotypje.

— Ore çuna, desha t'ju pyes, a i keni vënë emër barkës suaj? — tha Prokopi.

— Po, — u përgjigj Korabi.

— Si e keni quajtur?

— Zgalem, — thanë ata gati njëherësh.

— Emër i bukur. — tha Prokopi dhe e ngriti zërin.

— A e dini ç'është zgalemi? Zogu i stuhisë. Sa herë nis stuhia, ai ngrihet fluturim, i del përballë furtunës, lufton me të dhe fiton. Zgalem, — foli përsëri pas një pushtimi të shkurtër, — bukur e keni menduar. Domethënë, ju jeni djemtë e Zgalemit, apo jo?

Si tha këto fjalë, ai la lopatën, u kthyte dhe i shikoi me radhë djemtë e barkës. Fytyra e tij e lagur nga shiu

ishte e çelët dhe sytë, si zakonisht, i shkëlqenin nën vetullat kaleshe. Që në fillim të atij lundrimi nëpër natën plot gjëmime dhe stuhi, atij i kishin lënë mbresë të thellë ata fëmijë. Asnjëherë nuk i ishin ankuar, asnjëherë nuk kishin shfaqur ndonjë shenjë dobësie, përkundrazi, vepronin thjesht dhe me trimëri të vërtetë.

— Po shtohet shiu, — tha Prokopi; — mbështilluni mirë, djema.

— Babait tim do t'i bëhet qejfi për këtë shi, se u bën mirë zarzavateve, — tha Tuti dhe zuri të qeshë. Pas tij edhe të tjerët qeshën.

Kishin kaluar përtin. Panë dritat e tij që erdhën duke u zvogëluar. Tani ata po lundronin drejt Golemit. Ishin thuajse përballë plazhit dhe aty-këtu shquanin disa drita të vogëla, që shkëlqenin në breg. U duhesin edhe dy-tri orë që të arrinin atje ku do të linin Prokopin, i cili do të shkonte në çetë. Ai ua kishte thënë vetë këtë gjë dhe ata mendonin me zili për shokun e tyre të rritur që do të bëhej partizan, do të hidhte armën krahëve dhe do të luftonte arëmikun maleve.

— Ma lër mua lopatën, — tha Minai dhe ia mori atë nga dora Tutit. Minai shkoi pranë Prokopit dhe zuri vendin e tij.

Shiu nuk pushonte. Ai herë shtohej, herë pakësohej, por nuk reshtte. Ata ishin lagur dhe herë pas here fshinin fytyrat. Megjithatë, ata e dinin se ai mot i keq i kishte ndihmuar që mos t'u binin në sy fashistëve, se anijet e tyre, motoskafët e rojeve, nuk lëviznin në atë kohë të keqe.

— Mbani drejtimin, — i porositi Prokopi.

Minai shkoi me kujdes prapa dhe vuri re se porosia e Prokopit kishte ardhur në çastin e duhur. Ata, si pa e kuptuar, kishin devijuar pak dhe po shkonin më thellë, përtej Golemit. Natyrisht, ata orientoheshin me hamendje,

pasi nuk kishte shumë rëndësi pika ku do të dilnin, njaf-ton të ishin larg plazhit dhe afër pishave të Golemit.

Papritmas shiu u rrallua dhe pas pak pushoi.

Era sikur u qetësua pak. Ajo shtynte retë dhe qielli po pastrohej. Kishte më pak errësirë. Tani ata e shikonin më mirë njëri-tjetrin dhe kjo i gëzonte. Duke shikuar nga bre-gu, vunë re se gjendeshin më afër nga sa pandehnin. Atje tej dalluan masën e murme të pishave të Golemit. Pas tyre u zbuluan edhe masivet e rënda të maleve. Mbi to u duk një brez i zbetë drite. Kjo tregonte se kishte nisur të agonte.

Minai me Tutin që vozitnin, ndienin lodhje, por mendimi se po i afroheshin bregut, si dhe agu i drithës që po zbardhë, i shtyu të vozitnin më me fuqi.

Të gjithë, përvëç vozitësve që kishin kthyer shpinën, ia kishin ngulur sytë bregut, maleve dhe atij brezi të zbetë drite, që kishte çelur si një lule e bukur atje sipër maleve.


Tani bënte më ftohtë. Era vazhdonte të frynte dhe ftyrat e tyre të lagura ishin skuqur nga fryma e saj e akullt.

— Eja këtu, Çerr, — tha Minai, që i kishte dhënë fjalën djalit të vogël të voziste. Kjo gjë do ta gëzonte shokun e tyre.

Cerri u ul pranë Tudit, zuri lopatën dhe e tërhoqi me forcë. Nuk ishte lehtë ta tërhiqje, por ai tendosi muskujt dhe ia doli mbanë.

— Po arrijmë, çuna, — tha Prokopi dhe nxori nga poshtë një torbë që kishte marrë me vete. — Tani duhet të kemi kujdes. Kur t'i afrohemë bregut, të hapim sytë mirë, se mos lëviz ndonjë patrullë fashiste.

Ata vinin re se bregu po afrohej gjithnjë më shumë. Shikonin me vëmendje. Atje nuk lëvizte asgjë. Qielli largonte retë dhe brezi i drithës mbi male sa vinte bëhej më i madh dhe më i ndritshëm.



Në barkë u bë heshtje. Tani ata filluan të ndienin një emocion të brendshëm që po ndaheshin nga Prokopi, nga atentatori trim, që po shkonte të bashkohej me partizanët. Megjithatë ishin të gëzuar që mundën në atë natë të vështirë ta nxirrin përtjeq qytetit me barkën e tyre, me «Zgalemin» që kishte çarë stuhinë.

— Afrohuni ngadalë, — tha Prokopi, që ishte ngritur në këmbë dhe nuk ia ndante sytë bregut.

Barka, e përkundur nga valët, iu afrua tokës. Lopatat zunë dhe.

— Kujdes loPatat! — tha Minai dhe, bashkë me Korabin, kërcyen në Ujë. Ky u arrine mbi gjunjë. Ata ndenjën në të dy anët e barkës dhe e shtynë përpëra. Pas pak ajo preku tokën dhe nuk lëvizi më.

— Arritëm! — tha Prokopi dhe rregulloi këmishën e lagur nga shiu. Shëtroi me dorë flokët dhe sytë nuk ia ndante bregut. Agimi ishte shtrirë kudo dhe në qiel pothuajse s'kishte më re të Zeza. Majat e maleve ishin skuqur. Pas pak do të dilte dielli.

Prokopi, duke mbajtur në dorë trastën, zbriti në ujë. Eci me kujdes drëjt bregut. Pas tij zbritën edhe Tuti me Corrin. Të gjithë e shtynë barkën në breg, e siguruan që mos të lëvizte dhe dolën në tokë.

Bregu ishte i qetë, i lagur, plot erë, Fëshfërima e pishave përzihej me zhurmën e valëve që rrini ranishten.

— Kështu pra, djema, tanë do të ndahemi, — tha Prokopi.

Ata vunë re se edhe ai ishte i mallëngjyer si ata. I shikoi me radhë dhe nuk foli. Sytë i shkrepëtinin.

— Ju faleminderit. U treguat trima dhe të vendosur. Nuk do t'ju harroj kurrë.

Ata rrini të gjithë atje në breg, të lagur, por shumë të gëzuar.

— Mirupafshim! — tha Prokopi dhe u hodhi duart në qafë, duke i bashkuar të gjithë rrëth vetes. Ndjeu frymëmarrjen e tyre, kundërmimin e rrobave të lagura, madje iu duk se ndjeu edhe trokitjet e zemrave të tyre të vogla.

Ata ngritën kokat dhe e shikuani Prokopin. Ai përshtëndeti me grushtin lart.

— Vdekje fashizmit, shokë pionierë!

— Liri popullit! — iu përgjigjën ata njëzëri.

Në majë të maleve kishte dalë tashmë dielli i ndritshëm, i ngrohtë.